© TOGETHER FOR LIFE - TIRANË 2017

Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret apo kopjohet lirisht prej përdoruesve, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e “Together for Life” si burim. Këndvështrime të autorëve të këtij botimi jo domosdoshmërish pasqyrojnë pikëpamjet e “Together for life” dhe “LëvizAlbania”.

TOGETHER FOR LIFE

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

# MONITORIMI I STANDARDEVE TË INFRASTUKTURËS FIZIKE TË KOPSHTEVE TË TIRANËS

2017

# Monitorimi i standardeve të infrastukturës fizike të kopshteve të Tiranës

Mars 2017

*Ky projekt u mbështet nga Lëviz Albania*

*Ky dokument është një raport i përgatitur për projektin "Lëviz për Kopshtin Tim". Opinionet ose pikëpamjet e shprehura jo detyrimisht shprehin opinionet e "Lëviz Albania"***.**

**Grupi i monitoruesve:**

Pranvera Kola
Gridi Shehu
Ermelinda Hoxha
Blertina Koka
Denisa Canameti
Elena Beta
Donjeta Zeqa
Erjon Halili

**Grupi i anketuesve:**

Elona Tereziu
Edison Koka
Marsela Aliaj
Antigona Koka
Fize Smailaj

TOGETHER FOR LIFE

LEVIZ Albania
Local Democracy in Action

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

# FALËNDERIME

Raporti i monitorimit të standardeve fizike të kopshteve të Tiranës u realizua në kuadër të projektit “Lëviz për Kopshtin tim”, i cili u zbatua nga shoqata “Together for Life”. Ky projekt mori shkas nga nevojat e ngutshme të qytetarëve të Tiranës për më tepër kopshte dhe respektim të standardeve në kopshtet ekzistuese.

Monitorimi i kryer nga shoqata “Together for Life” bazohet në “Standardet e Projektimit të Kopshteve”, të hartuara nga Ministria e Zhvillimit Urban[01], si dhe në standardet aktuale mbi të cilat vepron Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar.

Shoqata “Together for Life” dëshiron të falënderojë gjithë stafet e kopshteve të Tiranës lidhur me dashamirësinë e shprehur dhe gatishmërinë e treguar në kohën e monitorimit të kopshteve.

Gjithashtu, një falënderim i madh shkon për Ministrinë e Arsimit dhe Bashkinë e Tiranës, për gatishmërinë e treguar në kryerjen e këtij studimi, i cili synon që të shërbejë si një pasqyrë e situatës aktuale të kopshteve në Tiranë, në mënyrë që si instancat shtetërore, ashtu edhe donatorët privatë, të mund të kontribuojnë së bashku në një përmirësim të gjendjes së kopshteve për të gjithë fëmijët e Tiranës.

Shoqata “Together for Life” shpreh falënderime për të gjithë pjesëmarrësit në këtë monitorim, për përkushtimin dhe seriozitetin e treguar prej tyre në çdo fazë të monitorimit.

---

01 Projekt-aktet për vitin 2016 sipas Ministrisë së Zhvillimit Urban: http://www.zhvillimiurban.gov.al/files/news_files/Standartet__e_projektimit_te_kopshteve.pdf

# PËRMBAJTJA

HYRJE

MONITORIMI FIZIK I KOPSHTEVE TË QYTETIT TË TIRANËS....8

1.1 Metodologjia e monitorimit fizik të kopshteve të qytetit të Tiranës....9
1.1.1 Seksioni 1: Gjeneralitete....13
1.1.2 Seksioni 2: Hapësirat e brendshme....18
1.1.3 Seksioni 3: Lehtësira....26
1.1.4 Seksioni 4: Hapësirat e jashtme....28
1..1 5 Seksioni 5: Siguria....33
1.2 Konkluzione dhe Rekomandime....37
Anekse të monitorimit fizik....38
ANKETIMI I PRINDËRVE....50
2.1 Qëllimi i përgjithshëm:....51
2.2 Objektivat specifikë:....51
2.3 Metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave nga anketimi....52
2.3.1 Periudha kohore e studimit....52
2.3.2 Karakteristikat e popullatës së marrë në studim....52
2.3.3 Përzgjedhja e mostrës së marrë në studim....53
2.3.4 Rezultatet....55
2.3.5 Diskutim mbi rezultatet....84
2.3.6 Konkluzione....86
Aneks: Pyetësori....88
FORUMET KOMUNITARE....94
3.1 Forumi i parë komunitar....96
3.2 Forumi i dytë komunitar....102
3.3 Forumi i tretë komunitar....108
3.4 Forumi i katërt komunitar....116

# HYRJE

Në përputhje me misionin e shoqatës "Together for Life", ky monitorim u krye për të kuptuar situatën në të cilën ndodhen kopshtet e fëmijëve në qytetin e Tiranës. Ky është një monitorim i shoqërisë civile, i pavarur dhe me qëllim përmirësimin e kushteve aktuale, duke bërë një prezantim të drejtë të gjendjes reale. Produkti final i këtij studimi është një vlerë e shtuar për të gjithë grupet e interesit.

Materiali është konceptuar në tri etapa:

Në etapën e parë është kryer monitorimi fizik i ambienteve të kopshteve të qytetit të Tiranës, prej të cilit janë nxjerrë konkluzionet dhe rekomandime të cilat synojnë përmirësimin e gjendjes së evidentuar.

Etapa e dytë e studimit vijon me anketimin e prindërve që përcjellin çdo ditë fëmijët e tyre në këto kopshte. Kjo etapë kryqëson informacionet e grumbulluara nga vëzhguesit e pavarur në etapën e parë, monitorimin fizik me perceptimet e prindërve, si një nga grupet më të rëndësishme të interesit.

Etapa e tretë konsiston në organizmin e katër forumeve komunitare. Thënë ndryshe, në këtë etapë ballafaqohen faktet e dy etapave të mësipërme me disa palë interesi, siç janë: drejtuesit e kopshteve të monitoruara, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, prindër, shoqëria civile të përfaqësuar nga moderatorët e këtyre forumeve komunitare nga shoqata "Together for Life" dhe organizata "Lëviz Albania".

Përgjatë materialit lexuesit do të njihen me metodologjinë dhe kriteret e përdorura nga shoqata për vlerësimin e kushteve fizike të kopshteve të qytetit të Tiranës. Detajohen katër hapat në të cilat ka kaluar procesi i monitorimit dhe mënyra e mbledhjes së informacionit.

Për çdo të dhënë të përpunuar, prej të cilave janë nxjerrë konkluzionet e studimit, grupi monitorues ka mbajtur evidencat përkatëse. Përgjatë materialit prezantohen 5 fushat e kushteve fizike të cilat i janë nënshtruar monitorimit në të gjitha kopshtet e kryeqytetit.

Këtij monitorimi fizik i është shtuar edhe analiza e anketimit të prindërve, si një pjesë e dytë e studimit. Në material prezantohen analiza të përgjigjeve të prindërve lidhur me perceptimet e tyre mbi situatën aktuale të kopshteve.

Në fund jepen në formë aneksesh të dhënat tabelare mbi të cilat janë nxjerrë rezultatet dhe konkluzionet e monitorimit fizik dhe pyetësori drejtuar prindërve.

KAPITULLI 1

# MONITORIMI FIZIK I KOPSHTEVE TË QYTETIT TË TIRANËS



Grupi i monitoruesve

# 1. *MONITORIMI FIZIK I KOPSHTEVE TË QYTETIT TË TIRANËS*

Procesi i monitorimit fizik ka synuar të hedhë dritë mbi kushtet në të cilat fëmijët parashkollorë kalojnë kohën e tyre gjatë ditës. Monitorimi ka marrë në shqyrtim 43 kopshte të qytetit të Tiranës, mes tyre edhe kopshtet e rikonstruktuara sipas nismës "Adopto një kopsht", i cili është 25, afërsisht 60% e kopshteve të qytetit të Tiranës.

Tabela e mëposhtme prezanton listën e atyre kopshteve të rikonstruktuara nga Bashkia e Tiranës në kuadër të nismës "Adopto një kopsht", e siguruar me bashkëpunimin e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHEF).

## *2.1 Metodologjia e monitorimit fizik të kopshteve të qytetit të Tiranës*

Gjithsej janë marrë në shqyrtim 43 kopshte të qytetit të Tiranës. Prej këtyre 43 kopshteve, në kohën e realizimit të monitorimit dy figurojnë në rikonstruksion. Bëhet fjalë për kopshtin nr. 17 dhe atë nr. 18. Fëmijët e këtyre dy kopshteve janë shpërndarë respektivisht në kopshtin nr. 43, nr. 41 dhe nr. 40.

Për këtë arsye, të dhënat e grumbulluara nga monitorimi fizik janë për 41 kopshte.

Kopshti nr. 17 figuron në konstruksion që prej vitit 2013. Duhet theksuar se, të dhënat mbi numrin e fëmijëve të regjistruar, numrin e edukatoreve, numrin e fëmijëve sipas grupmoshave, janë marrë në konsideratë për këto dy kopshte, pasi puna e edukatoreve me fëmijët e kopshteve në rikonstruksion vijon normalisht në ambientet e kopshteve nr. 43, nr. 41 dhe nr. 40.

Kategorizimi i seksioneve të monitorimit fizik të kopshteve është marrë nga standardet aktuale mbi të cilat vepron Inspektorati Kombëtar i Arsimit Parauniversitar, si dhe Standardet e Projektimit të Kopshteve, të hartuara nga Ministria e Zhvillimit Urban, të *cilat kanë për qëllim që të shërbejnë si referencë për të gjithë ata që janë të përfshirë në procesin e planifikimit, programimit, projektimit/dizajnit dhe ndërtimit të ndërtesave/hapësirave të reja të kopshteve apo në rehabilitimin e ndërtesave ekzistuese. Këto standarde janë parashikuar si për kopshtet e sektorit publik, ashtu edhe për kopshtet e sektorit privat.*[02]

Në këtë formë, edhe monitorimi fizik i kopshteve ka një emërues të përbashkët me normat që duhet të plotësojnë kopshtet e marra në shqyrtim.

## Hapi i parë: Faza studimore

1. *Identifikimi i treguesve kryesorë* mbi të cilët do të grumbullohen të dhënat nga faza e terrenit. Për këtë janë përdorur standardet e projektimit të kopshteve, të hartuara nga Ministria e Zhvillimit Urban, të aplikueshme për të gjitha kopshtet në territorin e Shqipërisë, qofshin këto publike ose private.

2. *Përzgjedhja e treguesve sasiorë* më kyç për sigurinë dhe mirërritjen e fëmijëve në këto ambiente, që do të përdoren për monitorimin fizik. Treguesit e përzgjedhur janë filtruar nga Standardet e Projektimit të Kopshteve, duke marrë po ashtu për secilin indikator edhe vlerat e detyrueshme sipas këtyre standardeve.

3. *Përpilimi i pyetësorit* që do të plotësohet nga grupet e monitoruesve.

*4. Trajnimi i monitoruesve fizikë,* duke i familjarizuar me terminologjinë, treguesit sasiorë që do të kujdesen të masin, evidentimin e secilit tregues me anë të fotove, për të mbështetur me evidenca matjet e tyre, vlerat optimale që përcaktohen nga standardet për secilin tregues të marrë në shqyrtim.

## Hapi i dytë: Faza e terrenit

Për t'u realizuar monitorimi punuan 5 grupe me nga dy persona secili, përgjatë një periudhe njëmujore (përkatësisht periudha janar - shkurt).

Secili monitorim zgjati rreth dy orë dhe përfshiu bisedën me drejtuesit, përballjen me dokumentacionin, fotografimin e ambienteve të kopshtit dhe vëzhgim të drejtpërdrejtë të situatës në kopsht.

Grumbullimi i të dhënave mbi indikatorët sasiorë është bërë nëpërmjet vëzhgimit direkt, ku

02 Standardet e Projektimit të Kopshteve

për secilin rast të vëzhguar janë mbledhur foto përkatëse si evidenca për të mbështetur rezultatet e gjeneruar.

## Hapi i tretë: Përpunimi i të dhënave

Duke qenë se të dhënat e grumbulluara janë mbi tregues sasiorë për të cilët Standardet e Projektimit të Kopshteve kanë përcaktuar vlerat optimale për secilin prej tyre, edhe përpunimi i të dhënave është bërë për të krahasuar situatën e rezultuar nga monitorimi me normat që duhet të plotësojnë këto ambiente. Për këtë është përdorur statistika deskriptive.

## Hapi i katërt: Raportimi

Produkti final i këtij projekti është përpilimi i raportit final, ku përmblidhen të gjitha rezultatet e gjeneruara nga përpunimi i të dhënave të grumbulluara.

Monitorimi i kopshteve të qytetit të Tiranës është grupuar sipas seksioneve të mëposhtme, në përputhje me treguesit sasiorë të Standardeve të Projektimit të Kopshteve.

1. Gjeneralitetet e kopshteve të monitoruara, në të cilin do të trajtohen të dhënat mbi kopshtet si:
    a. numrin e fëmijëve të regjistruar
    b. sipërfaqja bruto e dyshemesë
    c. tregues i cili mat hapësirën e nevojshme për qëndrimin e duhur të fëmijës në kopsht
    d. organizimi i fëmijëve sipas grupeve
    e. hapësirat për secilin grup fëmijësh

2. Hapësirat e brendshme dhe mobilimi minimal i nevojshëm, ku ambientet e marra në konsideratë për monitorim janë vetëm ato që ndikojnë në mirërritjen e fëmijëve, siç janë:
    a. Zyra e takimit Prind- Edukator
    b. Infermieria/ Psikologu
    c. Kuzhina Kryesore
    d. Shërbimet higjienike për prindërit apo bashkëpunëtorët e tjerë
    e. Zona e pranimit
    f. Zona aktive
    g. Shërbimet higjienike të fëmijëve
    h. Zona e fjetjes
    i. Kuzhina (aneksi për shërbimin e ushqimit)
    j. Dhoma e izolimit për parandalimin e epidemive
    k. Të tjera

3. Lehtësirat

4. Hapësira e jashtme që ndikon në:
   a. Hapësirën e lojës
   b. Hapësirën e rrugëve lidhëse dhe parkimin për mjetet që furnizojnë kopshtet

5. Siguria, e cila shfaqet në dimensionet e mëposhtme:
   a. Sistemet e ndriçimit
   b. Mbrojtja ndaj zjarrit
   c. Sistemi CCTV
   d. Njoftimi zanor

Skematikisht, si më poshtë:



# 1.1.1 Seksioni 1: Gjeneralitete

Gjetjet kryesore në seksionin e gjeneraliteteve tregojnë mbi kapacitetin e kopshteve, hapësirën shumë të vogël në dispozicion të secilit fëmijë, organizimin e fëmijëve nëpër grupe dhe numrin e edukatoreve për secilin grup fëmijësh.

Totali i kopshteve të marra në shqyrtim për monitorim është 43. Por për seksionin "Gjeneralitete" janë monitoruar fizikisht 41 kopshte, duke përjashtuar këtu kopshtet nr. 17 dhe nr. 18, pasi në kohën e monitorimit ishin në rikonstruksion.

| Përshkrimi | vlera |
|---|---|
| Kopshtet e marra në shqyrtim | 43 |
| Kopshtet e monitoruara | 41 |
| Kopshte të nismës "Adopto një kopsht" | 26 |
| Kopshte me të dhëna mbi sipërfaqen e shfrytëzueshme | 23 |
| Kopshte me fëmijë përtej vlerave normale | 21 |
| Kopshte me fëmijë / sipërfaqen minimale | 43 |
| *pa të dhëna* | *20* |
| *hapësirë më e vogël se 7m2/ fëmijë* | *14* |
| *hapësirë brenda normave* | *7* |
| *kanë hapësirë më të madhe se vlerat normale* | *2* |



## Grupet e fëmijëve nëpër kopshte janë 3:

### Grupi i I-rë

Janë fëmijë të moshës 3-4 vjeç. Grupe të tilla, bazuar në Standardet e Projektimit të Kopshteve, duhet të jenë maksimalisht prej 15 fëmijësh.

### Grupi i II-të

Në këto grupe janë fëmijë të moshës 4-5 vjeç. Sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve, numri maksimal i fëmijëve në këto grupe duhet të jetë 25 fëmijë.

### Grupi i III-të

Në këto grupe janë fëmijë të moshës 5-6 vjeç. Sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve, numri maksimal i fëmijëve në këto grupe duhet të jetë 30 fëmijë.

E rëndësishme është që, sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve, nuk duhet të ketë grupe me mosha të përziera. Secili fëmijë duhet të vendoset në grupin ku përket sipas grupmoshës.

### Gjatë monitorimit u konstatua se:

1. Për grupet e para, të cilat përbëhen nga fëmijë të moshave 3-4 vjeç, nuk është respektuar numri maksimal i fëmijëve që duhet të përmbajë grupi, bazuar në Standardet e Projektimit të Kopshteve. Në asnjë nga kopshtet prej të cilave u grumbulluan të dhëna (duke përfshirë këtu edhe ato të nismës "Adopto një kopsht"), nuk u gjet të ishte respektuar numri maksimal prej 15 fëmijësh në grupin e parë.

2. Gjatë monitorimit vihet re se, në grupet e para mosha e fëmijëve që marrin pjesë nuk është gjithmonë homogjene. Në kopshtin nr. 29, njëri nga dy grupet e fëmijëve të 3-4 vjeç është i përzierë me fëmijë të moshave të ndryshme.

3. Në grupet e dyta, ku bëjnë pjesë fëmijë të moshës 4-5 vjeç, vihet re fenomeni i mbi-kapaciteteve të hapësirave. Në 89% të kopshteve të monitoruara (nga të cilat 24 janë të nismës "Adopto një kopsht"), prej të cilave u morën informacione të sakta dhe të plota, vihet re një numër fëmijësh për grup përtej normave të këshilluara për mirërritjen e tyre.

4. Po ashtu, në grupet e dyta të 4 prej kopshteve të marra në vëzhgim (nga të cilat 1 është i nismës "Adopto një kopsht") u vërejt se ka fëmijë jashtë grupmoshës 4-5 vjeç.

5. Në 29 nga 36 kopshte prej të cilave janë tërhequr të dhëna (nga të cilat 19 janë të nismës "Adopto një kopsht") në grupet e treta, ku bëjnë pjesë fëmijë të moshës 5-6 vjeç, vihet re tejkalimi i numrit maksimal për grup i parashikuar në Standardet e Projektimit të Kopshteve.

6. Edhe në rastin e grupeve të treta, vihet re prezenca e grupmoshave heterogjene në 4 kopshte të ndryshme të Tiranës (nga të cilat 3 janë të nismës “Adopto një kopsht”).


KOPSHTI ME USHQIM 36 DAR/ZA

ADRESA: RR. FORTUZI

TË DHËNA STATISTIKORE

Kopshti është me ushqim Po [x] Jo [ ]

Fëmijë gjithsej 207 Numri mesatar i fëmijëve /grupe 50

Grupe mësimore gjithsej 4 grupe

Fëmijë gjithsej në grupin e parë 60 mosha 3 vjeç

Fëmijë gjithsej në grupin e dytë 5 0 mosha 4 vjeç

Fëmijë gjithsej në grupin e tretë 4 1 mosha 4 vjeç

Fëmijë gjithsej në grupin e katërt 5 6 mosha 5 vjeç

Foto: Të dhëna statistikore për kopshtin nr. 36 “Kësulkuqja”.



Foto: Pamje të regjistrave të kopshtit nr. 36 “Kësulkuqja”, ku numri i fëmijëve për një grup shkon edhe 56.

| Të dhëna mbi Grupet e I-ra (3-4 vjeç) | Vlerat nominale |
|---|---|
| Nr. i kopshteve të monitoruar | 43 |
| Nr. i kopshteve me të dhëna | 41 |
| Tejkalim i nr. maksimal për grupet e para | 39 |
| Grupe me mosha jo homogjene | 1 |
| **Të dhëna mbi Grupet e II-ta (4-5vjeç)** | **Vlerat nominale** |
| Nr. i kopshteve të monitoruar | 43 |
| Nr. i kopshteve me të dhëna | 41 |
| Tejkalim i nr. maksimal për grupet e dyta | 35 |
| Grupe me mosha jo homogjene | 4 |
| **Të dhëna mbi Grupet e III-ta (5-6 vjeç)** | **Vlerat nominale** |
| Nr. i kopshteve të monitoruar | 43 |
| Nr. i kopshteve me të dhëna | 36 |
| Tejkalim i nr. maksimal për grupet e treta | 29 |
| Grupe me mosha jo homogjene | 4 |

*Tabelë Përmbledhëse: Përmbledhje e informacioneve mbi gjeneralitetet për të tri llojet e grupeve të fëmijëve në kopshtet e monitoruara.*

Për të tri nivelet e grupeve në kopshtet e vëzhguara, vihet re numri i ulët i edukatoreve në raport me numrin e fëmijëve. Më poshtë, në formë tabelore dhe grafike, paraqiten rezultatet e këtij raporti në vendet fqinje dhe të rajonit:

Vihet re se, mesatarisht, edukatoret e ciklit parashkollor në qytetin e Tiranës kanë pothuajse dyfishin e fëmijëve që kanë koleget e tyre në Greqi, Maqedoni, Itali dhe Kroaci.

| Nr. | Shteti | Nr. mesatar i fëmijëve/ edukatore** | Dif. në % mes vendeve të tjera dhe Shqipërisë |
|---|---|---|---|
| 1 | Shqipëri | 24.2 | |
| 2 | Greqi | 11.9 | -50.8% |
| 3 | Maqedoni | 10.4 | -57.0% |
| 4 | Itali | 13.5 | -44.2% |
| 5 | Kroaci | 12.2 | -49.6% |

***Tabela e mësipërme është hartuar me të dhënat e publikuara* në faqen zyrtare të Eurostat për periudhën e vitit 2013.






Foto: Pamje nga kopshti "Kodër Kaméz", gjendet brenda ambienteve të shkollës 9-vjeçare "Isa Boletini.

## 1.1.2 Seksioni 2: Hapësirat e brendshme

Monitorimi i këtij seksioni është më i rëndësishmi, pasi hapësirat e brendshme janë ato në të cilat fëmijët kalojnë kohën më të madhe. Duhet që mirërritja dhe siguria e fëmijëve të jetë maksimale.

Nga monitorimi i kopshteve të Tiranës u përpunuan të dhënat e mëposhtme:

| Ambientet e brendshme | Vlera nominale | Vlera në % |
|---|---|---|
| Kopshte të monitoruara | 41 | |
| Kopshte me zonë aktive | 41 | 100% |
| Kopshte me zonë fjetje | 29 | 71% |
| Kopshte me kuzhinë kryesore | 34 | 83% |
| Kopshte me kuzhinë - aneks për shërbimin e ushqimit | 15 | 37% |
| Kopshte me shërbime higjienike për fëmijët | 41 | 100% |
| Kopshte me zyrën e takimit prind-edukatore | 10 | 24% |
| Kopshte me infermieri/ zyrën e psikologut | 13 | 32% |
| Kopshte me zonë pranimi | 37 | 90% |
| Kopshte me shërbime higjienike për prindërit dhe bashkëpunëtorët | 12 | 29% |
| Kopshte me dhomë izolimi | 0 | 0.0% |

**Zona Aktive** *(të gjitha kopshtet e kanë zonën aktive).*

- 2 kopshte nuk kanë fare tavolinë didaktike për fëmijët dhe 7 kopshte të tjera (nga të cilat 4 janë të nismës “Adopto një kopsht”) përdorin si tavolina didaktike ato të ngrënies.

- 2 kopshte, të cilat janë të nismës “Adopto një kopsht”, nuk kanë dollapë për mjetet e fëmijëve, lodrat apo librat e tyre në zonën aktive.

- 36 kopshte nga 41 nuk kanë tapetat e sfungjerit me ngjyra, të rekomanduara si mjetet minimale të nevojshme nga Standardet e Projektimit të Kopshteve. 20 prej këtyre kopshteve janë të nismës “Adopto një kopsht”.

- Vetëm 4 kopshte kanë teatër, ku njëri prej këtyre të katërve është i sajuar/ krijuar nga vetë edukatoret. Ndërkohë, 20 kopshte të rikonstruktuara sipas nismës “Adopto një kopsht” nuk kanë teatër për fëmijët e tyre.

- 14 kopshte (nga të cilat 11 janë të nismës “Adopto një kopsht”) kanë tavolina me cepa dhe kënde të pazmusuara.

- 16 kopshte (nga të cilat 5 janë të nismës "Adopto një kopsht") kanë karrige aspak të përshtatshme për moshën e fëmijëve. Në 27 kopshte vihet re që karriget e përdorura për fëmijët janë karrige ose të prishura, ose standarde për të rriturit, ose thjesht karrige druri, jo të duhura për moshën e fëmijëve. 14 prej këtyre kopshteve janë kopshte të rikonstruktuara sipas nismës "Adopto një Kopsht".



Foto: Kopshti nr. 56 "Beni ecën vetë" një vit pas rikonstruksionit.

**Zona e fjetjes** *(29 kopshte gjithsej e kanë këtë hapësirë, nga 41 kopshte të monitoruara).*

Kopshte me zonë fjetje janë vetëm 29 të tillë, nga të cilat, kopshti "Bregu i Lumit", i rikonstruktuar me anë të nismës "Adopto një kopsht", është pa zonë fjetje.

- Vetëm 7 kopshte (nga të cilat vetëm 4 janë të nismës "Adopto një kopsht") kanë tavolinë në zonën e fjetjes.

- 12 kopshte (nga të cilat 11 janë të nismës "Adopto një kopsht") kanë dollap në këtë zonë.

- 7 kopshte (nga të cilat 1 është i nismës "Adopto një kopsht") janë pa krevate fare

- 31 kopshtet (nga të cilat 21 janë të nismës "Adopto një kopsht") me zonë fjetje dhe me krevate i kanë shtretërit e ngjitur pas njëri-tjetrit, duke mos respektuar hapësirën minimale të nevojshme mes shtretërve, 0.5 m.



Foto: Pamje nga zona e fjetjes te kopshti nr. 11 “Cicërimat”.



Foto: Pamje nga zona e fjetjes te kopshti nr. 45 “4 Stinët”.



Foto: Pamje nga zona e fjetjes te kopshti nr. 34 në Kombinat.

Kuzhina kryesore (34 kopshte e kanë këtë hapësirë, nga 41 kopshte të monitoruara).

Kopshte të cilave u mungon kuzhina kryesore janë 19%, dhe janë vetëm 15 kopshte që kanë aneks ku mund të përgatitet shpërndarja e ushqimit, nga të cilat 13 janë të nismës “Adopto një kopsht”. Kopshti “Bregu i Lumit”, i nismës “Adopto një kopsht”, figuron pa ambientin e kuzhinës kryesore.

- Dhoma frigoriferike ishte vetëm në 3 nga 34 kopshtet që kishin kuzhinë kryesore (20 kopshte të nismës “Adopto një kopsht” nuk kanë dhomë frigoriferike)

- Vetëm 8 kopshte (nga të cilat 6 janë të nismës Adopto një kopsht) kanë lavastovilje në kuzhinë për larjen e enëve.

- Pajisja e frigoriferit nuk u gjet vetëm në 4 kopshte. Këta kopshte nuk janë të nismës “Adopto një kopsht”.

- 7 kopshte (nga të cilat 4 janë të nismës “Adopto një kopsht”) të qytetit të Tiranës nuk kanë lavaman në kuzhinën kryesore.

- Aspiratori mungon në 14 kopshte (7 prej këtyre kopshteve janë të nismës “Adopto një kopsht”).



Foto: Pamje nga pjesa e kuzhinës dhe aneksi ku shpërndahen ushqimet, tek kopshti nr. 45 “4 Stinët”.

Shërbimet higjienike për fëmijë (të gjitha kopshtet e monitoruara i kanë shërbimet higjienike për fëmijë).

- Në kopshtin “Kodër Kamëz” nuk kishte WC për fëmijët. Ata përdornin ambientet e shkollës 9-vjeçare “Isa Boletini”.

- Lavamani i thellë për larjen e fëmijëve 3-vjeçarë u gjet vetëm në një kopsht, i cili nuk është i nismës “Adopto një kopsht”. Në rastin e një kopshti tjetër, përdoret vaska si mjet zëvendësues i këtij lavamani. 39 kopshtet e tjera nuk kanë lavaman të thellë për kujdesin e higjienës së fëmijëve të vegjël.



Foto: Pamje nga ambientet e WC të shkollës shkollës 9-vjeçare “Isa Boletini”, që përdoren edhe nga fëmijët e kopshtit “Kodër Kamëz”.



Foto: Pamje nga ambientet e WC të kopshtit 25/1 “Duarartët”.

**Zyra e takimit prind – edukatore** *(vetëm 10 kopshte e kanë këtë zyrë, nga kopshtet e monitoruara).*

Zyra e takimit prind-edukator, e cila duhet të jetë një dhomë e veçantë, nuk ekziston për

pjesën më të madhe të kopshteve. Vetëm 24% e kopshteve të monitoruara e kanë këtë dhomë. Për sa i përket nismës "Adopto një kopsht", vetëm 7 prej këtyre kopshteve të rikonstruktuara e kanë dhomën e takimit prind-edukatore.

- 5 nga 10 kopshtet që e kanë këtë ambient të brendshëm, nga të cilat 4 janë të nismës "Adopto një kopsht", nuk kanë kompjuterin dhe projektorin në të.

- 6 nga 10 kopshtet me zyrën e takimit prind – edukator nuk kanë printer, nga të cilat 4 janë të nismës "Adopto një kopsht".



Foto: Pamje nga zyra e drejtorisë të kopshtit nr. 3, që përdoret edhe si zyra e takimit prind – edukatore.

**Infermieria/ zyra e psikologut** *(vetëm 13 kopshte e kanë këtë zyrë nga kopshtet e monitoruara,* nga të cilat 7 janë të nismës "Adopto një kopsht").

Sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve, një kopsht duhet të ketë edhe një dhomë infermierie dhe një zyrë psikologu. Në rastin tonë, gjatë monitorimit u konstatua se vetëm 13 kopshte nga 41 kanë njërën nga këto dy dhoma. Kryesisht bëhet fjalë për infermierinë. Kopshtet e tjera nuk kanë asnjërën prej tyre. Lidhur me kopshtet e nismës "Adopto një kopsht", vetëm 7 kopshte kanë dhomën e infermierisë. Tre prej këtyre 7 kopshteve e përdorin këtë dhomë edhe për shërbimet e psikologut.

- Frigoriferi për ruajtjen e medikamenteve, që duhet të jetë pjesë e këtyre ambienteve, u gjet vetëm tek 1 kopsht i nismës "Adopto një kopsht".

- Vetëm 4 kopshte nga 13 (nga të cilat vetëm kopshti "Bregu i Lumit" i nismës "Adopto një kopsht"), kishin lavaman brenda në këtë zyrë, ashtu siç kërkohet nga Standardet e Projektimit të Kopshteve.

- Asnjë nga 13 kopshtet që e kanë këtë zyrë nuk kanë PC, printer dhe aparat dezinfektimi, duke përfshirë këtu edhe kopshtet e rikonstruktura të nismës "Adopto një kopsht".

- Vetëm 2 kopshte, nga 13 që e kanë zyrën e infermierisë/psikologut, kishin krevatin e nevojshëm (nga të cilat 1 kopsht është i nismës "Adopto një kopsht").



Pamje: Foto nga zyra e infermierisë/psikologut te kopshti "Kodër Kamëz".

**Zona e pranimit** *(4 kopshte nuk e kanë këtë hapësirë nga 41 kopshte të monitoruara). Tri prej kopshteve që nuk e kanë këtë hapësirë janë kopshte të rikonstruktuara nëpërmjet nismës "Adopto një kopsht".*

Zona e pranimit, ku fëmijët duhet të grumbullohen para se të hyjnë nëpër klasat e tyre, nuk është në të gjitha kopshtet. 5 prej kopshteve të Tiranës nuk e kanë këtë ambient të brendshëm. Kopshtet e rikonstruktuara sipas nismës "Adopto një kopsht" janë të pajisura me ambiente pranimi.

- 2 kopshte (nga të cilat 1 është i nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë dollapë me module në zonën e pranimit.

- 18 kopshte (nga të cilat 14 janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë dollapë me varje për rrobat e fëmijëve në zonën e pranimit.



Foto: Pamje nga zona e pranimit te kopshti nr. 64 "Xixëllonjat".

**Shërbimet higjienike për prindërit apo të rritur të tjerë,** që vijnë vizitojnë kopshtet, janë vetëm për 12, nga të gjitha kopshtet e marra në monitorim (nga të cilat 21 kopshte që nuk kanë shërbime higjienike janë të nismës "Adopto një kopsht").

**Dhomë izolimi –** Në asnjë nga kopshtet e monitoruara nuk ka një dhomë izolimi në raste sëmundjesh për të parandaluar rastet epidemike tek fëmijët, duke përfshirë këtu edhe kopshtet e rikonstruktuara rishtazi me anë të nismës "Adopto një kopsht".

## Komente të tjera

- Vetëm 6 kopshte (nga të cilat 5 janë të nismës "Adopto një kopsht"), nga 41 të monitoruara, kanë ambiente të brendshme të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.

# 1.1.3 Seksioni 3: Lehtësira

Problematikat e identifikuara në këtë seksion kanë të bëjnë me disa aspekte të kushteve fizike që ofrojnë kopshtet e qytetit të Tiranës për fëmijët parashkollorë. Këtu do të përmenden uji i rrjedhshëm, uji i ngrohtë dhe i ftohtë, ngrohja dhe freskimi i ambienteve të brendshme etj.

Më poshtë po përmbledhim gjetjet sipas çështjeve që trajtohen në këtë seksion:

1. Kopshti "Kodër Kamëz" ka probleme me energjinë elektrike.

2. 24% e kopshteve të qytetit të Tiranës (nga të cilat 9 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") kanë vetëm ngrohje për mbajtjen e temperaturës konstante në ambientet e tyre.

3. Fëmijët e 7 prej kopshteve të monitoruara (nga të cilat nuk ka të nismës "Adopto një kopsht"), (17%) nuk kanë në ambientet e tyre as ngrohje e as ftohje.

4. 15% e kopshteve të qytetit të Tiranës (nga të cilat 2 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë ujë të ngrohtë dhe të ftohtë pa ndërprerje. Vlen të theksohet se kopshti nr. 34 " nuk ka ujë të ngrohtë.

5. Po ashtu, siç vihet re edhe në Aneks 5, 6 kopshte (nga të cilat 1 është i nismës "Adopto një kopsht"), që përbëjnë 14.3% të kopshteve të monitoruara, nuk kanë depozitë uji për të siguruar vazhdimësi në higjienën e fëmijëve dhe të vetë institucionit.

6. Janë 23 kopshte, nga të cilat 13 janë të nismës "Adopto një kopsht" (54.8% e kopshteve të monitoruara), të cilat nuk kanë asnjë TV satelitor apo tokësor në ambientet e qëndrimit të fëmijëve.

7. Si dhe 17 kopshte, nga të cilat 5 janë të nismës Adopto një kopsht (40.5% e kopshteve të monitoruara), nuk kanë TV satelitor apo tokësor në dhomat e argëtimit të fëmijëve.

| **Lehtësira** | **Vlerat nominale** | **Vlerat në %** |
|---|---|---|
| Nr i kopshteve të monitoruar | 41 | |
| Nr i kopshteve me energji elektrike pa ndërprerje | 40 | 98% |
| Nr i kopshteve me probleme me energjinë elektrike | 1 | 2% |
| Nr i kopshteve me ngrohje dhe ftohje për temperaturë konstante | 24 | 59% |
| Nr i kopshteve vetëm me ngrohje | 10 | 24% |
| Nr i kopshteve pa ngrohje dhe ftohje për temperaturë konstante | 7 | 17% |
| Nr i kopshteve me ujë të rrjedhshëm pa ndërprerje | 35 | 85% |
| Nr i kopshteve pa ujë të rrjedhshëm | 6 | 15% |
| Nr i kopshteve me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë pa ndërprerje | 34 | 83% |
| Nr i kopshteve me ujë të ngrohtë dhe të ftohtë me ndërprerje | 6 | 15% |
| Nr i kopshteve pa ujë të ngrohtë | 1 | 2% |
| Nr i kopshteve me depozitë uji kur mungon furnizimi i linjës | 35 | 85% |
| Nr i kopshteve pa depozitë uji | 6 | 15% |
| Nr i kopshteve me TV satelitor/ tokësor në ambientin e qëndrimit të fëmijëve | 18 | 44% |
| Nr i kopshteve pa TV satelitor/ tokësor në ambientin e qëndrimit të fëmijëve | 23 | 56% |
| Nr i kopshteve me TV satelitor/ tokësor në dhomat e argëtimit të fëmijëve | 14 | 34% |
| Nr i kopshteve pa TV satelitor/ tokësor në dhomat e argëtimit të fëmijëve | 17 | 41% |



*Foto: Pamje nga kopshti nr.34 në Kombinat, fëmijët ngrohen me sobë drush.*




*Foto: Pamje nga kopshti nr. 14, pajisjet e ngrohjes lehtësisht të aksesueshme nga fëmijët.*

# 1.1.4 Seksioni 4: Hapësirat e jashtme

Seksioni "Hapësirat e jashtme" e vendos vëmendjen në ato aspekte të cilat shoqërojnë mirërritjen e fëmijëve, siç janë: hapësirat për aktivitetet argëtuese dhe hapësirat e mjediseve përreth godinës për aktivitetin e përditshëm operacional të një institucioni përkujdesës.

Në pjesën e parë të këtij seksioni janë trajtuar evidencat e identifikuara gjatë monitorimit të hapësirave të lojërave për fëmijët. Gjatë monitorimit u vunë re gjetjet e mëposhtme:

1. 17% e kopshteve të monitoruara (nga të cilat 2 janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë mure ndarëse për të kufizuar ambientet e tyre të jashtme, ashtu siç kërkohet nga Standardet e Projektimit të Kopshteve.

2. 13 nga 41 kopshtet e monitoruara (nga të cilat 3 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë lodra në ambientet e tyre të jashtme për fëmijët. 4 kopshte të tjera (nga të cilat 2 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") kanë lodra të pamjaftueshme për numrin e fëmijëve të pranishëm në institucion.
Është e rëndësishme të theksohet se, kopshti nr. 64 "Xixëllonjat" , kopshti "Bregu i Lumit" (pjesë e nismës "Adopto një kopsht") kanë lodra që nuk janë të përshtatshme për fëmijët në këto grupmosha, duke cenuar sigurinë e tyre.



Foto: Pamje nga hapësira e lojërave në ambientet e jashtme të Kopshtit "Xixëllonjat"



Foto: Pamje nga hapësira e lojërave në ambientet e jashtme të kopshtit "Bregu i Lumit"



*Foto: Pamje nga hapësira e lojërave në ambientet e jashtme të kopshtit nr. 25/1 ”Duarartët”*



*Foto: Pamje nga hapësira e lojërave në ambientet e jashtme të Kopshtit Nr. 20*



*Foto: Pamje nga hapësira e lojërave në ambientet e jashtme të Kopshtit Nr. 21*

3. 10 nga kopshtet e monitoruara nuk kanë gjelbërim dhe bimësi të shkurtër në mjediset e lojërave. 3 prej këtyre kopshteve që nuk kanë gjelbërim janë të nismës "Adopto një Kopsht".

4. 39% e kopshteve (nga të cilat 6 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë stola për fëmijë në hapësirat e jashtme.

5. 11 (nga të cilat 4 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") nga kopshtet e monitoruara nuk ofrojnë hije në mjediset e lojërave.

| **Hapësira e lojërave në ambientet e jashtme** | **Vlerat nominale** | **Vlerat në %** |
|---|---|---|
| Kopshte të monitoruara | 41 | |
| Kopshte të rrethuara me mure ndarëse | 35 | 85% |
| Kopshte të parrethuara me mure ndarëse | 7 | 17% |
| Kopshte me lodra në ambientet e jashtme për fëmijët | 23 | 56% |
| Kopshte që nuk kanë lodra në ambientet e jashtme për fëmijët | 13 | 32% |
| Kopshte me lodra në ambientet e jashtme për fëmijët të pamjaftueshme | 4 | 10% |
| Kopshte me lodra në ambientet e jashtme të rrezikshme për fëmijët | 1 | 2% |
| Kopshte me oborr të mbuluar me gjelbërim dhe bimë të shkurtra | 26 | 63% |
| Kopshte me oborr të pambuluar me gjelbërim dhe bimë të shkurtra | 10 | 24% |
| Kopshte me oborr të mbuluar me pak gjelbërim dhe bimë të shkurtra | 6 | 15% |
| Kopshte me stola për fëmijë në ambientet e jashtme | 24 | 59% |
| Kopshte pa stola për fëmijë në ambientet e jashtme | 16 | 39% |
| Kopshte me pak stola për fëmijë në ambientet e jashtme | 2 | 5% |
| Kopshte me hapësira të jashtme 25% në hije | 31 | 76% |
| Kopshte me hapësira të jashtme më pak se 25% hije | 11 | 27% |

Në pjesën e dytë të këtij seksioni do të trajtohet hapësira për rrugët lidhëse me institucionin dhe parkimin brenda mjediseve të tij.

Nga të dhënat e marra nga 41 kopshtet e monitoruara, vihen re gjetjet e mëposhtme:

1. 50% e kopshteve të qytetit të Tiranës (nga të cilat 11 kopshte janë të nismës “Adopto një kopsht”) nuk ofrojnë akses për makinat që furnizojnë kopshtin me materiale të ndryshme.

2. 50% e kopshteve të monitoruara (nga të cilat 16 kopshte janë të nismës “Adopto një kopsht”) nuk ofrojnë akses për karrocat e fëmijëve.

3. 86% e kopshteve të qytetit të Tiranës të monitoruara (nga të cilat 21 kopshte janë të nismës “Adopto një kopsht”) nuk ofrojnë akses për personat me aftësi të kufizuara.

**Më poshtë është tabela përmbledhëse dhe grafikët përshkrues.**

| **Hapësira e Rrugëve lidhëse dhe Parkimit** | **vlerat nominale** | **vlerat në %** |
|---|---|---|
| Kopshte të monitoruara | 41 | |
| Kopshte me akses për makinat që furnizojnë kopshtin me materiale | 21 | 50% |
| Kopshte pa akses për makinat që furnizojnë kopshtin me materiale | 21 | 50% |
| Kopshte me akses të karrocave të fëmijëve | 17 | 40% |
| Kopshte pa akses të karrocave të fëmijëve | 25 | 60% |
| Kopshte me akses për PAK | 6 | 14% |
| Kopshte pa akses për PAK | 36 | 86% |









## 1.1.5 Seksioni 5: Siguria

Siguria që ofrojnë kopshtet e monitoruara si institucione të mirërritjes së fëmijëve parashkollorë është trajtuar në disa aspekte:

## Sistemi i ndriçimit të emergjencës

Gjetjet e identifikuara gjatë procesit të monitorimit u përmblodhën në tabelën e mëposhtme:

1. 36.6% e kopshteve të qytetit të Tiranës nuk kanë sistem ndriçimi emergjence. 2 kopshte e kanë sistemin jofunksional. 8 kopshte të rikonstruktuar sipas nismës "Adopto një Kopsht" nuk kanë sistem ndriçimi emergjence.

2. 97.6% e kopshteve (nga të cilat 24 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë gjeneratorë për të siguruar gjithmonë ndriçimin alternativ.

3. 32 kopshte, nga 41 për të cilat u mblodh informacion, rezultojnë pa sistem ndriçimi për evakuim. 18 kopshte të nismës "Adopto një kopsht" nuk kanë sistem ndriçimi për evakuim.

4. 82.9% e kopshteve të monitoruara (nga të cilat 21 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë kontraste kromatike në dysheme për të treguar drejtimin e evakuimit.

5. Për kopshtet nr. 14 dhe nr. 31 (ky i fundit pjesë e nismës "Adopto një kopsht") kontrastet kromatike janë vendosur nga vetë edukatoret dhe fëmijët.

6. 92.7% e kopshteve të qytetit të Tiranës (nga të cilat 23 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë dalje sigurie dhe 73.2% e kopshteve (nga të cilat 19 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë sinjalistikë që të të udhëheqë drejt daljeve të emergjencës.

| Sistemi i ndriçimit të emergjencës | vlerat nominale | vlerat në % |
|---|---|---|
| Kopshte të monitoruara | 41 | |
| Kopshte me sistem ndriçimi emergjence | 24 | 58.5% |
| **Kopshte me sistem ndriçimi emergjence jofunksional** | 2 | 4.9% |
| Kopshte pa sistem ndriçimi emergjence | 15 | 36.6% |
| Kopshte me gjenerator për ta siguruar gjithmonë ndriçimin alternativ | 1 | 2.4% |
| Kopshte pa gjenerator për ta siguruar gjithmonë ndriçimin alternativ | 40 | 97.6% |
| Kopshte me sistem ndriçimi evakuimi | 9 | 22.0% |
| Kopshte pa sistem ndriçimi evakuimi | 32 | 78.0% |
| Kopshte me kontraste kromatike në dysheme për të treguar drejtimin e evakuimit | 4 | 9.8% |
| Kopshte me kontraste kromatike në dysheme për të treguar drejtimin e evakuimit - përgatitur nga vetë edukatoret dhe fëmijët | 2 | 4.9% |
| Kopshte pa kontraste kromatike në dysheme për të treguar drejtimin e evakuimit | 34 | 82.9% |
| Kopshte me dalje sigurie në holl dhe korridore | 3 | 7.3% |
| Kopshte pa dalje sigurie në holl dhe korridore | 38 | 92.7% |
| Kopshte me sinjalistikë për daljet e emergjencës | 9 | 22.0% |
| Kopshte me sinjalistikë për daljet e emergjencës - përgatitur nga edukatoret dhe fëmijët | 2 | 4.9% |
| Kopshte pa sinjalistikë për daljet e emergjencës | 30 | 73.2% |

## Sistemi i mbrojtjes kundër zjarrit

Nga monitorimi i kopshteve të qytetit të Tiranës u vunë re gjetjet e mëposhtme:

1. Janë 13 kopshte të monitoruara (nga të cilat 8 kopshte janë të nismës “Adopto një kopsht”) që dritaret i kanë të mbyllura me kangjella hekuri. Dritaret nuk duhet të shërbejnë për të izoluar fëmijët, por për të dhënë mundësinë e shpëtimit prej zjarrit.

2. 92.7% e kopshteve (nga të cilat 24 kopshte janë të nismës “Adopto një kopsht”) i kanë dyert që hapen në drejtimin “brenda - jashtë”, duke vështirësuar daljet sa më emergjente në situatë zjarri.

3. Në 70.2% të kopshteve të Tiranës (nga të cilat 19 kopshte janë të nismës “Adopto një kopsht”) mungojnë tabela shpjeguese për ngjyrat që paralajmërojnë rrezikun.

4. 18 kopshte (nga të cilat 11 janë të nismës “Adopto një kopsht”) nuk kanë sistem detektimi të zjarrit.

5. 20 kopshte (nga të cilat 14 kopshte janë të nismës “Adopto një kopsht”) nuk kanë sirena alarmi për lajmërimin e ndonjë zjarri të mundshëm.

6. Në 6 kopshte (nga të cilat 4 kopshte janë të nismës “Adopto një kopsht”) rezulton se edukatoret nuk dinë si të përdorin mjetet emergjente për shuarjen e zjarrit.




Foto: Pamje nga kopshti 25/A, i pajisur me të gjitha sistemet e sigurisë.

Më poshtë prezantohet tabela më të dhënat sintetike sipas gjetjeve të lartpërmendura.

| **Mbrojtja ndaj zjarrit** | **vlerat nominale** | **vlerat në %** |
|---|---|---|
| Kopshte të monitoruara | 41 | |
| Kopshte me dritare pa skara hekuri | 28 | 68.3% |
| Kopshte me dritare me skara hekuri | 13 | 31.7% |
| Kopshte me dyer që hapen nga brenda - jashtë | 3 | 7.3% |
| Kopshte me dyer që nuk hapen nga brenda - jashtë | 38 | 92.7% |
| Kopshte me tabela shpjeguese për ngjyrat që paralajmërojnë rrezikun | 11 | 26.8% |
| Kopshte pa tabela shpjeguese për ngjyrat që paralajmërojnë rrezikun | 30 | 73.2% |
| Kopshte me sistem detektimi të zjarrit | 23 | 56.1% |
| Kopshte pa sistem detektimi të zjarrit | 18 | 43.9% |
| Kopshte me sirena alarmi në rast zjarri | 21 | 51.2% |
| Kopshte pa sirena alarmi në rast zjarri | 20 | 48.8% |
| Kopshte me impiante për shuarjen e zjarrit | 41 | 100.0% |
| Kopshte pa impiante për shuarjen e zjarrit | 0 | 0.0% |
| Staf i informuar për përdorimin e mjeteve për shuarjen e zjarrit | 35 | 85.4% |
| Staf i painformuar për përdorimin e mjeteve për shuarjen e zjarrit | 6 | 14.6% |

# Sistemi CCTV dhe Njoftimi Zanor

Gjatë monitorimit të seksionit të sigurisë, ishte e rëndësishme edhe pjesa e kamerave të sigurisë dhe njoftimit zanor.

U vunë re se:

1. Nga 41 kopshte të monitoruara, vetëm në 2 prej tyre, të cilat janë të nismës "Adopto një kopsht", ekziston dhoma e serverit ku është i vendosur sistemi CCTV. Duke rezultuar në 37 kopshte (nga të cilat 23 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") pa dhomë serveri dhe pa sistemin CCTV.

2. Kopshte pa kamera sigurie, dhe që nuk sigurojnë informacion të rrjedhshëm, janë 38 (nga të cilat 24 janë të nismës "Adopto një kopsht").

3. Të gjithë kopshtet e monitoruara janë pa altoparlantë në ambientet e përbashkëta, sigurisht këtu përfshihen të gjitha kopshtet e nismës "Adopto një kopsht".

Më poshtë është tabela me materialin përmbledhës, lidhur me gjetjet e lartpërmendura.

| **Sistemi CCTV dhe njoftimi zanor** | **vlerat nominale** | **Vlerat në %** |
|---|---|---|
| Kopshtet e monitoruara | 41 | |
| Kopshte me dhomë serveri ku të jetë i vendosur sistemi CCTV | 2 | 4.9% |
| Kopshte pa dhomë serveri me sistem CCTV | 37 | 90.2% |
| Kopshte me kamera sigurie në secilën dhomë dhe ambient që sigurojnë informacion të rrjedhshëm | 1 | 2.4% |
| Kopshte që nuk sigurojnë informacion të rrjedhshëm | 38 | 92.7% |
| Kopshte me kamera funksionale në hyrje të kopshtit | 2 | 4.9% |
| Kopshte me altoparlantë në korridore | 1 | 2.4% |
| Kopshte pa altoparlantë në korridore | 35 | 85.4% |
| Kopshte me altoparlantë në ambientet e përbashkëta (klasa, dhoma fjetje etj) | 0 | 0.0% |
| Kopshte pa altoparlantë në ambientet e përbashkëta | 41 | 100.0% |



Foto: Pamje nga kopshti nr. 45, një nga 2 kopshtet e pajisur me kamera sigurie.

# 1.2 Konkluzione dhe Rekomandime

Prej monitorimit të kopshteve në qytetin e Tiranës, vihen re se problemet e evidentuar përgjatë seksioneve të mësipërme vijnë si pasojë e dy shkaqeve kryesore:

## 1. Mungesa e hapësirave të duhura për numrin e lartë të fëmijëve të regjistruar.

Të gjitha problemet që kanë të bëjnë me gjetjet e përmendura më lart, në thelb tregojnë për mungesë të hapësirave të nevojshme për mirërritjen e fëmijëve në kopshtet e kryeqytetit.

Shtimi apo edhe zgjerimi i kopshteve aktuale do të kontribuojë menjëherë në:

a. Uljen e dendësisë së fëmijëve nëpër grupe;
b. Homogjenitetin e grupeve të fëmijëve;
c. Uljen e raportit fëmijë/edukator për të qenë sa më pranë raportit që përdorin vendet fqinje dhe ato të rajonit;
d. Uljen e numrit të shtretërve për secilin grup, duke bërë të mundur respektimin e hapësirave të nevojshme sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve;
e. Plotësimin e mjeteve të nevojshme të kopshteve sipas mungesave që has stafi si pasojë e mbipopullimit;
f. Shtimin e dhomës së takimit prind/edukator, dhomës së psikologut dhe të infermierisë për të gjitha kopshtet.

## 2. Mungesa e sistemeve efektive të kontrollit të brendshëm

Një katalizator i rëndësishëm i ofrimit të një shërbimi cilësor, të krahasueshëm me standardet e projektimit të kopshteve, është sistemi i kontrollit të brendshëm. Një sistem i efektshëm kontrolli i brendshëm garanton mos cedim të cilësisë së shërbimit dhe zgjidhjen e shpejtë të problemeve të konstatuara.

Prandaj, monitorime të shpeshta, periodike dhe të mirëplanifikuara për të gjitha ambientet e kopshteve të kryeqytetit janë jetike në garantimin e shërbimit.

Shumë probleme të mungesave të shumta në pajisje, mjete pune apo mësimore, cilësinë e stafit, apo edhe vetë higjienën e ambienteve të brendshme e të jashtme, mund t'i minimizojnë sisteme efektive të kontrollit të brendshëm.

# Anekse të monitorimit fizik të kopshteve të qytetit të Tiranës

# Aneks 1 – Gjeneralitete

| Nr. | Kopshtet | Kapaciteti i kopshtit | Nr. i fëmijëve të regjistruar | SBD*/ fëmijë** | Diferenca në % e fëmijëve të regjistruar ndaj vlerës së duhur | Diferenca në % e hapësirës së brendshme për fëmijë ndaj vlerave të duhura |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *max 125 fëmijë* | *70-75 fëmijë* | *7m2/ fëmijë - 7.5 m2/ fëmijë* | | |
| 1 | "Borëbardha" - Adopto një kopsht | 120 | 140 | na | 86.67% | na |
| 2 | Nr. 1 | 150 | 143 | na | 90.67% | na |
| 3 | Nr. 2 "Peter Pan" - Adopto një kopsht | 100 | 170 | 2.94 | 126.67% | -57.98% |
| 4 | Nr. 3 | 120 | 234 | 5.13 | 212.00% | -26.74% |
| 5 | Nr. 6 - Adopto një kopsht | 130 | 210 | 2.62 | 180.00% | -62.59% |
| 6 | Nr. 8 - Adopto një kopsht | 150 | 190 | na | 153.33% | na |
| 7 | Nr. 11 "Cicërimat" - Adopto një kopsht | 100 | 143 | na | 90.67% | na |
| 8 | Nr. 14 | 150 | 255 | na | 240.00% | na |
| 9 | Nr. 17 | na | 53 | na | -29.33% | na |
| 10 | Nr. 19 - Adopto një kopsht | 110 | 170 | na | 126.67% | na |
| 11 | Nr. 20 - Adopto një kopsht | 120 | 150 | 7.00 | 100.00% | 0.00% |
| 12 | Nr. 21 - Adopto një kopsht | 120 | 130 | 2.42 | 73.33% | -65.40% |
| 13 | Nr. 24- Adopto një kopsht | 100 | 216 | 2.08 | 188.00% | -70.24% |
| 14 | Nr. 25/A- Adopto një kopsht | 100 | 132 | na | 76.00% | na |
| 15 | Nr. 25/1 "Duarartët"- Adopto një kopsht | 125 | 160 | na | 113.33% | na |
| 16 | Nr. 26 "Dielli"- Adopto një kopsht | 100 | 210 | na | 180.00% | na |
| 17 | Nr. 27/K- Adopto një kopsht | 128 | 166 | na | 121.33% | na |
| 18 | Nr. 27/- Adopto një kopsht A | 125 | 169 | 6.51 | 125.33% | -7.02% |
| 19 | Nr. 28 "Avatar"- Adopto një kopsht | 100 | 127 | 1.57 | 69.33% | -77.50% |
| 20 | Nr. 29 | 120 | 160 | 7.00 | 113.33% | 0.00% |
| 21 | Nr. 29/1 | 150 | 144 | 7.00 | 92.00% | 0.00% |
| 22 | Nr. 31- Adopto një kopsht | 245 | 228 | 5.39 | 204.00% | -22.93% |
| 23 | Nr. 34 | 75 | 84 | na | 12.00% | na |
| 24 | Nr. 35 | 120 | 167 | na | 122.67% | na |
| 25 | Nr. 36- Adopto një kopsht | 120 | 215 | 1.40 | 186.67% | -80.07% |
| 26 | Nr. 38- Adopto një kopsht | 100 | 125 | na | 66.67% | na |
| 27 | Nr. 39- Adopto një kopsht | 80 | 165 | na | 120.00% | na |
| 28 | Nr. 40 "Nënë Tereza" | 100 | 167 | na | 122.67% | na |
| 29 | Nr. 41 | 230 | 246 | 6.91 | 228.00% | -1.28% |
| 30 | Nr. 42 | 100 | 161 | 8.88 | 114.67% | 26.89% |
| 31 | Nr. 43 | 120 | 165 | 7.27 | 120.00% | 3.90% |
| 32 | Nr. 45 "4 Stinët" - Adopto një kopsht | na | 250 | na | 233.33% | na |
| 33 | Nr. 51 "Tomi & Xherri" - Adopto një kopsht | 120 | 250 | 7.00 | 233.33% | 0.00% |
| 34 | Nr. 52 - Adopto një kopsht | 100 | 120 | 3.33 | 60.00% | -52.38% |
| 35 | Nr. 55 | 110 | 60 | 7.00 | -20.00% | 0.00% |
| 36 | Nr. 56 - Adopto një kopsht | 120 | 190 | 2.25 | 153.33% | -67.82% |
| 37 | Nr. 60 | 120 | 65 | 7.00 | -13.33% | 0.00% |
| 38 | Nr. 64 "Xixëllonjat" - Adopto një kopsht | 75 | 133 | 6.14 | 77.33% | -12.24% |
| 39 | Bregu Lumit - Adopto një kopsht | 120 | 210 | 1.00 | 180.00% | -85.71% |
| 40 | Kodër Kamëz | 100 | 115 | na | 53.33% | na |
| 41 | Shkozë "Ylber" | 100 | 100 | na | 33.33% | na |
| 42 | Shkozë | 150 | 98 | 7.00 | 30.67% | 0.00% |
| 43 | Nr. 18 - rikonstruksion | na | na | na | na | na |

# Aneks 2 - Të dhëna mbi Grupin e I-rë (mosha 3- 4 vjeç)

| Kopshtet | **Grupi I (3-4 vjeç)** ***deri në 15 fëmijë*** | **Nr i Edukatoreve për Grupin I** | **Dif. në % e fëmijëve në grupin I ndaj vlerës normale** | **Nr. i fëmijëve/ edukator për grupin I** |
|---|---|---|---|---|
| "Borëbardha" - Adopto një kopsht | 30 | 1 | 100.00% | 30 |
| Nr. 1 | 36 | 2 | 140.00% | 18 |
| Nr. 2 "Peter Pan" - Adopto një kopsht | 40 | 2 | 166.67% | 20 |
| Nr. 3 | 62 | 2 | 313.33% | 31 |
| Nr. 6 - Adopto një kopsht | 51 | 2 | 240.00% | 26 |
| Nr. 8 - Adopto një kopsht | 40 | 2 | 166.67% | 20 |
| Nr. 11 "Cicërimat" - Adopto një kopsht | 39 | 2 | 160.00% | 20 |
| Nr. 14 | 44+44 | 2 | 193.33% | 44 |
| Nr. 17 | na | 4 | na | na |
| Nr. 19 - Adopto një kopsht | 40 | 2 | 166.67% | 20 |
| Nr. 20 - Adopto një kopsht | 15+15 | 2 | 200.00% | 15 |
| Nr. 21 - Adopto një kopsht | 30 | 2 | 100.00% | 15 |
| Nr. 24- Adopto një kopsht | 58 | 2- | 286.67% | 29 |
| Nr. 25/A- Adopto një kopsht | 26+26 | 2+2 | 273.33% | 26 |
| Nr. 25/1 "Duarartët"- Adopto një kopsht | 46 | 2 | 206.67% | 23 |
| Nr. 26 "Dielli"- Adopto një kopsht | 50 | 2 | 233.33% | 25 |
| Nr. 27/K- Adopto një kopsht | 37 | 2 | 146.67% | 19 |
| Nr. 27/- Adopto një kopsht A | 32 | 2 | 113.33% | 16 |
| Nr. 28 "Avatar"- Adopto një kopsht | 45 | 2 | 200.00% | 23 |
| Nr. 29 | 38+35* | 2 | 153.33% | 35 |
| Nr. 29/1 | 42 | 2 | 180.00% | 21 |
| Nr. 31- Adopto një kopsht | 32+33 | 2 | 113.33% | 32 |
| Nr. 34 | 27 | 2 | 80.00% | 14 |
| Nr. 35 | 43 | 2 | 186.67% | 22 |
| Nr. 36- Adopto një kopsht | 47 | 2 | 213.33% | 24 |
| Nr. 38- Adopto një kopsht | 34 | 2 | 126.67% | 17 |
| Nr. 39- Adopto një kopsht | 35 | na | 133.33% | na |
| Nr. 40 "Nënë Tereza" | 36 | 2 | 140.00% | 18 |
| Nr. 41 | 81 | 2 | 440.00% | 41 |
| Nr. 42 | 40 | 2 | 166.67% | 20 |
| Nr. 43 | 47 | 2 | 213.33% | 24 |
| Nr. 45 "4 Stinët" - Adopto një kopsht | 38+38 | 2+2 | 153.33% | 19 |
| Nr. 51 "Tomi & Xherri" - Adopto një kopsht | 54 | 2+1 | 260.00% | 18 |
| Nr. 52 - Adopto një kopsht | 35 | 2 | 133.33% | 18 |
| Nr. 55 | 20 | 1 | 33.33% | 20 |
| Nr. 56 - Adopto një kopsht | 33 | 2 | 120.00% | 17 |
| Nr. 60 | 13 | 1 | -13.33% | 13 |
| Nr. 64 "Xixëllonjat" - Adopto një kopsht | 47 | 2 | 213.33% | 24 |
| Bregu Lumit - Adopto një kopsht | 80 | 2 | 433.33% | 40 |
| Kodër Kamëz | 27 | 2 | 80.00% | 14 |
| Shkozë "Ylber" | 30 | 1 | 100.00% | 30 |
| Shkozë | 29 | 1 | 93.33% | 29 |
| Nr. 18 - rikonstruksion | na | na | na | na |

*Shënim: * tregon që grupet në kopshtet përkatëse nuk janë homogjene sipas moshës 3-4 vjeç por janë të përbërë me fëmijë të moshave të ndryshme.*

# Aneks 3 - Të dhënat për Grupin e II-të, mosha 4-5 vjeç

| Kopshtet | Grupi II (4-5 vjeç) *deri në 25 fëmijë* | Nr i Edukator-eve për Grupin II | Dif në % e fëmijëve në grupin II ndaj vlerës normale | Nr. i fëmijëve/ Eduka-tor për grupin II |
|---|---|---|---|---|
| **"Borëbardha" - Adopto një kopsht** | 35+ 48* | 1 | 40.00% | 35 |
| **Nr. 1** | 42+30 | 2 | 20.00% | 15 |
| **Nr. 2 "Peter Pan" - Adopto një kopsht** | 35+35 | 4 | 40.00% | 9 |
| **Nr. 3** | 50 | 2 | 100.00% | 25 |
| **Nr. 6 - Adopto një kopsht** | 52+52 | 2+2 | 108.00% | 26 |
| **Nr. 8 - Adopto një kopsht** | 35+ 38 | 2+2 | 40.00% | 18 |
| **Nr. 11 "Cicërimat" - Adopto një kopsht** | 35 + 37 | 2+2 | 40.00% | 18 |
| **Nr. 14** | 32+32+32+35* | 6 | 28.00% | 22 |
| **Nr. 17** | na | na | na | na |
| **Nr. 19 - Adopto një kopsht** | 43 | 2 | 72.00% | 22 |
| **Nr. 20 - Adopto një kopsht** | 35 | 2 | 40.00% | 18 |
| **Nr. 21 - Adopto një kopsht** | 33+35+33 | 2+2+2 | 32.00% | 17 |
| **Nr. 24- Adopto një kopsht** | 52 | 2 | 108.00% | 26 |
| **Nr. 25/A- Adopto një kopsht** | 40 | 2 | 60.00% | 20 |
| **Nr. 25/1 "Duarartët"- Adopto një kopsht** | 41 | 2 | 64.00% | 21 |
| **Nr. 26 "Dielli"- Adopto një kopsht** | 52+47 | 2+2 | 108.00% | 24 |
| **Nr. 27/K- Adopto një kopsht** | 31+37 | 2+2 | 24.00% | 16 |
| **Nr. 27/- Adopto një kopsht A** | 32+33+34 | 2+2+1 | 28.00% | 20 |
| **Nr. 28 "Avatar"- Adopto një kopsht** | 40+40 | 3 | 60.00% | 27 |
| **Nr. 29** | 36 | 2 | 44.00% | 18 |
| **Nr. 29/1** | 31+31 | 2+2 | 24.00% | 31 |
| **Nr. 31- Adopto një kopsht** | 33+34 | 2 | 32.00% | 33 |
| **Nr. 34** | 26 | 1 | 4.00% | 26 |
| **Nr. 35** | 80* | 5 | 220.00% | 16 |
| **Nr. 36- Adopto një kopsht** | 40+56 | 2+2 | 60.00% | 40 |
| **Nr. 38- Adopto një kopsht** | 32+30 | 2+2 | 20.00% | 30 |
| **Nr. 39- Adopto një kopsht** | 35 | na | 40.00% | na |
| **Nr. 40 "Nënë Tereza"** | 43 | 2 | 72.00% | 22 |
| **Nr. 41** | 50+41* | 2+2 | 64.00% | 41 |
| **Nr. 42** | 44+44 | 2+2 | 276.00% | 44 |
| **Nr. 43** | 40 | 2 | 60.00% | 20 |
| **Nr. 45 "4 Stinët" - Adopto një kopsht** | 42+43 | 2+2 | 68.00% | 42 |
| **Nr. 51 "Tomi & Xherri" - Adopto një kopsht** | 49 | 2 | 96.00% | 25 |
| **Nr. 52 - Adopto një kopsht** | 22 | 2 | -12.00% | 11 |
| **Nr. 55** | 25+27 | 1 | 0.00% | 52 |
| **Nr. 56 - Adopto një kopsht** | 38+35 | 2 | 40.00% | 35 |
| **Nr. 60** | 13 | 1 | -48.00% | 13 |
| **Nr. 64 "Xixëllonjat" - Adopto një kopsht** | 37+38 | 4 | 48.00% | 37 |
| **Bregu Lumit - Adopto një kopsht** | 44 | 1 | 76.00% | 44 |
| **Kodër Kamëz** | 25+27 | 2 | 0.00% | 25 |
| **Shkozë "Ylber"** | 6 | 1 | -76.00% | 6 |
| **Shkozë** | 35 | 1 | 40.00% | 35 |
| Nr. 18 - rikonstruksion | na | na | na | na |

*Shënim: * tregon që grupet në kopshtet përkatëse nuk janë homogjene sipas moshës 4-5 vjeç por janë të përbërë me fëmijë të moshave të ndryshme.*

# Aneks 4 – Të dhënat për grupin e tretë, mosha 5-6 vjeç

| **Kopshtet** | **Grupi III ( 5-6 vjeç)** *deri në 30 fëmijë* | **Nr i Eduka-toreve për Grupin III** | **Dif në % e fëmijëve në grupin III ndaj vlerës normale** | **Nr. i fëmi-jëve/ Eduka-tor për grupin III** |
|---|---|---|---|---|
| "Borëbardha" - Adopto një kopsht | 34 | 2 | 13.33% | 17 |
| Nr. 1 | 35 | 2 | 16.67% | 18 |
| Nr. 2 "Peter Pan" - Adopto një kopsht | 48 | 2 | 60.00% | 24 |
| Nr. 3 | 53 | 2+2 | 76.67% | 13 |
| Nr. 6 - Adopto një kopsht | 54 | 2 | 80.00% | 27 |
| Nr. 8 - Adopto një kopsht | 38+40 | 2+2 | 26.67% | 20 |
| Nr. 11 "Cicërimat" - Adopto një kopsht | 32 | 2 | 6.67% | 16 |
| Nr. 14 | 44 | 2 | 46.67% | 22 |
| Nr. 17 | na | na | na | na |
| Nr. 19 - Adopto një kopsht | 42+38 | 2+2 | 26.67% | 20 |
| Nr. 20 - Adopto një kopsht | 35* | 2 | 16.67% | 18 |
| Nr. 21 - Adopto një kopsht | na | na | na | na |
| Nr. 24- Adopto një kopsht | 52+53 | 2+2 | 73.33% | 26 |
| Nr. 25/A- Adopto një kopsht | 40 | 2 | 33.33% | 20 |
| Nr. 25/1 "Duarartët"- Adopto një kopsht | 34+39 | 4 | 13.33% | 18 |
| Nr. 26 "Dielli"- Adopto një kopsht | 49 | 2 | 63.33% | 25 |
| Nr. 27/K- Adopto një kopsht | na | 2 | na | na |
| Nr. 27/- Adopto një kopsht A | 36 | 2 | 20.00% | 18 |
| Nr. 28 "Avatar"- Adopto një kopsht | na | na | na | na |
| Nr. 29 | 39 | 2 | 30.00% | 20 |
| Nr. 29/1 | 37 | 2 | 23.33% | 19 |
| Nr. 31- Adopto një kopsht | 31+32+33* | 4 | 3.33% | 24 |
| Nr. 34 | 30 | 2 | 0.00% | 15 |
| Nr. 35 | 44 | 2 | 46.67% | 22 |
| Nr. 36- Adopto një kopsht | 48 | 1 | 60.00% | 48 |
| Nr. 38- Adopto një kopsht | 28 | 2 | -6.67% | 14 |
| Nr. 39- Adopto një kopsht | 40+35 | na | 11766.67% | na |
| Nr. 40 "Nënë Tereza" | 45+45 | 2+2+1 | 50.00% | 18 |
| Nr. 41 | 74 | 2 | 146.67% | 37 |
| Nr. 42 | 41 | 2 | 36.67% | 21 |
| Nr. 43 | 40 | 2 | 33.33% | 20 |
| Nr. 45 "4 Stinët" - Adopto një kopsht | 45+31+33 | 4 | 3.33% | 27 |
| Nr. 51 "Tomi & Xherri" - Adopto një kopsht | 45+43* | 2+1 | 43.33% | 29 |
| Nr. 52 - Adopto një kopsht | 25+28 | 2+2 | -16.67% | 13 |
| Nr. 55 | 31+30* | 1+1 | 0.00% | 31 |
| Nr. 56 - Adopto një kopsht | 35 | 2 | 16.67% | 18 |
| Nr. 60 | na | 1 | na | na |
| Nr. 64 "Xixëllonjat" - Adopto një kopsht | 0 | 0 | na | na |
| Bregu Lumit - Adopto një kopsht | 86 | 2 | 186.67% | 43 |
| Kodër Kamëz | 30 | 1 | 0.00% | 30 |
| Shkozë "Ylber" | 25 | 1 | -16.67% | 25 |
| Shkozë | 30 | 1 | 0.00% | 30 |
| Nr. 18 - rikonstruksion | na | na | na | na |

# Aneks 5 – Të dhëna mbi “Lehtësirat” në kopshtet e monitoruara

| Kopshtet | Facilitete | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Energji Elektrike pa ndërprerje | Ngrohje dhe Ftohje për tempera-turë konstante | H2O i rrjedhshëm dhe pa ndërprerje | H2O i ngrohtë dhe i ftohtë pa ndër-prerje | Depozitë uji kur mungon furnizimi i linjës | TV satelitor/ tokë-sor në ambientet e qëndrimit të fëmi-jëve | TV satelitor/ tokë-sor në dhomat e ar-gëtimit të fëmijëve |
| **“Borëbardha” – Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | jo | po |
| **Nr. 1** | po | jo | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 2 “Peter Pan” – Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | po | po |
| **Nr. 3** | po | po | po | po | po | po | po |
| **Nr. 6 – Adopto një kopsht** | po | ngrohje | po | po | po | jo | na |
| **Nr. 8 – Adopto një kopsht** | po | ngrohje | po | po | po | jo | na |
| **Nr. 11 “Cicërimat” – Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 14** | po | po | po | po | jo | po | po |
| **Nr. 17** | na | na | na | na | na | na | na |
| **Nr. 19 – Adopto një kopsht** | po | ngrohje | po | po | po | jo | na |
| **Nr. 20 – Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 21 – Adopto një kopsht** | po | ngrohje* | po | po | po | jo | na |
| **Nr. 24- Adopto një kopsht** | po | ngrohje | po | po | po | po | na |
| **Nr. 25/A- Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | po | po |
| **Nr. 25/1 “Duarartët”- Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 26 “Dielli”- Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | po | na |
| **Nr. 27/K- Adopto një kopsht** | po | ngrohje | po | po | po | jo | na |
| **Nr. 27/- Adopto një kopsht A** | po | po | po | po | po | po | po |
| **Nr. 28 “Avatar”- Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | po | po |
| **Nr. 29** | po | po | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 29/1** | po | po | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 31- Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 34** | po* | ngrohje* | Jo | Nuk ka uje te ngrohte | po | jo | na |
| **Nr. 35** | po | jo | po | po | po | po | po |
| **Nr. 36- Adopto një kopsht** | po | ngrohje | jo | jo | po | po | po |
| **Nr. 38- Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | jo | na |
| **Nr. 39- Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | jo | na |
| **Nr. 40 “Nënë Tereza”** | po | po | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 41** | po | po | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 42** | po | po | po | po | po | po | jo |
| **Nr. 43** | po | po | po | po | jo | po | jo |
| **Nr. 45 “4 Stinët” – Adopto një kopsht** | po | ngrohje | po | po | po | po | po |
| **Nr. 51 “Tomi & Xherri” – Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 52 – Adopto një kopsht** | po | po | jo | jo | jo | po | po |
| **Nr. 55** | po | jo | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 56 – Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | po | po |
| **Nr. 60** | po | jo | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 64 “Xixëllonjat” – Adopto një kopsht** | po | po | po | po | po | po | po |
| **Bregu Lumit – Adopto një kopsht** | po | ngrohje | jo | jo | po | po | po |
| **Kodër Kamëz** | jo | jo | po | jo | jo | jo | jo |
| **Shkozë “Ylber”** | po | jo | jo | jo | jo | po | jo |
| **Shkozë** | po | jo | po | po | po | jo | jo |
| Nr. 18 – rikonstruksion | na | na | na | na | na | na | na |

# Aneks 6 – Hapësira e lojërave për fëmijë në ambientet e jashtme

| Nr. | Kopshtet | Rrethohet me mure ndarëse | Ka lodra që ndihmojnë fëmijët të argëtohen | Oborri është i mbuluar me gjelbërim dhe bimë të shkrutra 0.4m | Stola për fëmijët për të pushuar apo qëndruar | 25% e lojërave në oborr mund të luhen në hije |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | "Borëbardha" - Adopto një kopsht | po | pak | pak | po | po |
| 2 | Nr. 1 | po | po | po | jo | po |
| 3 | Nr. 2 "Peter Pan" - Adopto një kopsht | jo | po | po | pak | po |
| 4 | Nr. 3 | po | jo | po | po | po |
| 5 | Nr. 6 - Adopto një kopsht | po | po | po | po | po |
| 6 | Nr. 8 - Adopto një kopsht | po | po | pjesërisht | pak | po |
| 7 | Nr. 11 "Cicërimat" - Adopto një kopsht | po | po | po | po | jo |
| 8 | Nr. 14 | po | jo | pak | po | po |
| 9 | Nr. 17 | jo | Na | Na | Na | na |
| 10 | Nr. 19 - Adopto një kopsht | po | po | po | po | po |
| 11 | Nr. 20 - Adopto një kopsht | po | po | po | po | po |
| 12 | Nr. 21 - Adopto një kopsht | po | po | po | po | po |
| 13 | Nr. 24- Adopto një kopsht | po | jo | po | po | po |
| 14 | Nr. 25/A- Adopto një kopsht | po | jo | jo | po | po |
| 15 | Nr. 25/1 "Duarartët"- Adopto një kopsht | po | po | po | po | po |
| 16 | Nr. 26 "Dielli"- Adopto një kopsht | jo | po | po | po | po |
| 17 | Nr. 27/K- Adopto një kopsht | po | po | po | po | po |
| 18 | Nr. 27/- Adopto një kopsht A | po | po | po | jo | jo |
| 19 | Nr. 28 "Avatar"- Adopto një kopsht | po | po | po | po | po |
| 20 | Nr. 29 | jo | jo | jo | jo | jo |
| 21 | Nr. 29/1 | po | jo | po | jo | po |
| 22 | Nr. 31- Adopto një kopsht | po | pak | pak | po | po |
| 23 | Nr. 34 | po | jo | jo | jo | po |
| 24 | Nr. 35 | po | po | po | jo | po |
| 25 | Nr. 36- Adopto një kopsht | po | po | po | jo | po |
| 26 | Nr. 38- Adopto një kopsht | po | po | po | po | po |
| 27 | Nr. 39- Adopto një kopsht | po | jo | jo | jo | po |
| 28 | Nr. 40 "Nënë Tereza" | po | jo | jo | jo | po |
| 29 | Nr. 41 | po | jo | jo | jo | jo |
| 30 | Nr. 42 | jo | pak | pak | po | jo |
| 31 | Nr. 43 | jo | po | po | po | jo |
| 32 | Nr. 45 "4 Stinët" - Adopto një kopsht | po | po | po | po | po |
| 33 | Nr. 51 "Tomi & Xherri" - Adopto një kopsht | po | po | po | po | po |
| 34 | Nr. 52 - Adopto një kopsht | po | po | po | jo | jo |
| 35 | Nr. 55 | po | jo | jo | jo | jo |
| 36 | Nr. 56 - Adopto një kopsht | po | pak | jo | jo | jo |
| 37 | Nr. 60 | jo | jo | jo | jo | jo |
| 38 | Nr. 64 "Xixëllonjat" - Adopto një kopsht | po | me rrezikshmëri për fëmijët | pak | po | po |
| 39 | Bregu Lumit - Adopto një kopsht | po | po | po | jo | po |
| 40 | Kodër Kamëz | po | po | po | po | po |
| 41 | Shkozë "Ylber" | po | jo | jo | jo | jo |
| 42 | Shkozë | po | jo | po | po | po |
| 43 | Nr. 18 | na | na | na | na | na |

# Aneks 7 – Hapësirat për rrugët lidhëse dhe parkimi

| Kopshtet | Akses për makinat që furnizojnë kopshtin me materiale | Akses i karrocave të fëmijëve | Akses i PAK |
|---|---|---|---|
| "Borëbardha" - Adopto një kopsht | jo | po | jo |
| Nr. 1 | po | po | po |
| Nr. 2 "Peter Pan" - Adopto një kopsht | po | po | jo |
| Nr. 3 | po | po | jo |
| Nr. 6 - Adopto një kopsht | po | po | po |
| Nr. 8 - Adopto një kopsht | jo | jo | jo |
| Nr. 11 "Cicërimat" - Adopto një kopsht | jo | jo | jo |
| Nr. 14 | po | po | jo |
| Nr. 17 | Na | Na | na |
| Nr. 19 - Adopto një kopsht | jo | jo | jo |
| Nr. 20 - Adopto një kopsht | po | jo | jo |
| Nr. 21 - Adopto një kopsht | jo | jo | jo |
| Nr. 24- Adopto një kopsht | jo | jo | jo |
| Nr. 25/A- Adopto një kopsht | po | po | po |
| Nr. 25/1 "Duarartët"- Adopto një kopsht | po | jo | jo |
| Nr. 26 "Dielli"- Adopto një kopsht | jo | jo | jo |
| Nr. 27/K- Adopto një kopsht | jo | jo | jo |
| Nr. 27/- Adopto një kopsht A | po | po | po |
| Nr. 28 "Avatar"- Adopto një kopsht | jo | jo | jo |
| Nr. 29 | po | po | jo |
| Nr. 29/1 | po | po | po |
| Nr. 31- Adopto një kopsht | po | po | jo |
| Nr. 34 | jo | jo | jo |
| Nr. 35 | jo | jo | jo |
| Nr. 36- Adopto një kopsht | po | jo | jo |
| Nr. 38- Adopto një kopsht | jo | jo | jo |
| Nr. 39- Adopto një kopsht | jo | jo | jo |
| Nr. 40 "Nënë Tereza" | jo | jo | jo |
| Nr. 41 | jo | po | jo |
| Nr. 42 | po | po | jo |
| Nr. 43 | jo | jo | jo |
| Nr. 45 "4 Stinët" - Adopto një kopsht | po | jo | jo |
| Nr. 51 "Tomi & Xherri" - Adopto një kopsht | po | po | jo |
| Nr. 52 - Adopto një kopsht | jo | po | po |
| Nr. 55 | jo | jo | jo |
| Nr. 56 - Adopto një kopsht | po | jo | jo |
| Nr. 60 | jo | jo | jo |
| Nr. 64 "Xixëllonjat" - Adopto një kopsht | po | po | jo |
| Bregu Lumit - Adopto një kopsht | po | jo | jo |
| Kodër Kamëz | po | jo | jo |
| Shkozë "Ylber" | jo | jo | jo |
| Shkozë | po | po | jo |
| Nr. 18 - rikonstruksion | na | na | na |

# Aneks 8 – Sistemi i ndriçimit të emergjencës

| **Kopshtet** | **A ka sistem ndricimi emergjence?** | **A ka gjenerator për ta siguruar gjithmonë ndriçimin alternativ?** | **A ka sistem ndriçimi evakuimi? (sinjalistika për evakuim e ndriçuar)** | **A ka kontraste kromatike në dysheme për të treguar drejtimin e evakuimit?** | **A ka dalje sigurie në holl dhe korridoret?** | **Sa dalje emergjente ka në secilin korridor?** | **A ka sinjalistikë për daljet e emergjencës?** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| "Borëbardha" - Adopto një kopsht | po | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 1 | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 2 "Peter Pan" - Adopto një kopsht | po | jo | jo | jo | jo | 0 | po |
| Nr. 3 | po, por nuk funksionon | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 6 - Adopto një kopsht | po | po | jo | Ne dritare | jo | 0 | jo |
| Nr. 8 - Adopto një kopsht | po | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 11 "Cicërimat" - Adopto një kopsht | po | jo | po | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 14 | po | jo | jo | Po, janë vendosur vetë nga edukatoret dhe fëmijët | jo | 0 | Po disa të vendosura vetë nga edukatoret dhe fëmijët |
| Nr. 17 | na | na | na | na | na | na | na |
| Nr. 19 - Adopto një kopsht | po | jo | po | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 20 - Adopto një kopsht | po | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 21 - Adopto një kopsht | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 24- Adopto një kopsht | po | jo | po | jo | jo | 0 | po |
| Nr. 25/A- Adopto një kopsht | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | po |
| Nr. 25/1 "Duarartët"- Adopto një kopsht | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 26 "Dielli"- Adopto një kopsht | Jo | jo | jo | jo | jo | 0 | Jo |
| Nr. 27/K- Adopto një kopsht | Po | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 27/- Adopto një kopsht A | po | jo | jo | jo | jo | 0 | po |
| Nr. 28 "Avatar"- Adopto një kopsht | po | jo | po | po | jo | 0 | po |
| Nr. 29 | po | jo | po | po | jo | 0 | po |
| Nr. 29/1 | po, por nuk funksionon | jo | po | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 31- Adopto një kopsht | po | jo | jo | Po, janë vendosur vetë nga edukatoret dhe fëmijët | jo | 0 | Po disa të vendosura vetë nga edukatoret dhe fëmijët |
| Nr. 34 | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 35 | po | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 36- Adopto një kopsht | jo | jo | jo | po | jo | 0 | jo |
| Nr. 38- Adopto një kopsht | po | jo | po | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 39- Adopto një kopsht | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 40 "Nënë Tereza" | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | po |
| Nr. 41 | po | jo | jo | jo | jo | 0 | po |
| Nr. 42 | po | jo | jo | jo | jo, kanë qenë por I kaneëhequr | 0 | jo |
| Nr. 43 | po | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 45 "4 Stinët" - Adopto një kopsht | po | jo | po | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 51 "Tomi & Xherri" - Adopto një kopsht | po | jo | jo | jo | po | 0 | jo |
| Nr. 52 - Adopto një kopsht | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 55 | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 56 - Adopto një kopsht | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Nr. 60 | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | po |
| Nr. 64 "Xixëllonjat" - Adopto një kopsht | po | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Bregu Lumit - Adopto një kopsht | po | jo | po | po | po | 1 | jo |
| Kodër Kamëz | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Shkozë "Ylber" | jo | jo | jo | jo | jo | 0 | jo |
| Shkozë | po | jo | jo | jo | po | 1 | jo |
| Nr. 18 - rikonstruksion | na | na | na | na | na | 0 | na |

# Aneks 9 – Mbrojtja kundër zjarrit

| Kopshtet | Dritaret janë pa skara hekuri | Hapja e dyerve bëhet nga Brenda - Jashtë | A ka tabela për shpjegimin e ngjyrave sipas nivelit të rrezikut? (E kuqe, E verdhë/ Portokalli, Bo-jëqielli, E gjelbër) | Sistem detektimi i zjarrit | Sirenat e zjarrit | Impiante për shuarjen e zjarrit | Dinë edukatoret si t'i përdorin në rast zjarri? |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| "Borëbardha" - Adopto një kopsht | po | jo | jo | jo | jo | po | jo |
| Nr. 1 | po | jo | jo | po | po | po | jo |
| Nr. 2 "Peter Pan" - Adopto një kopsht | po | jo | po | jo | jo | po | po |
| Nr. 3 | po | jo | jo | jo | jo | po | po |
| Nr. 6 - Adopto një kopsht | po | jo | jo | po | po | po | po |
| Nr. 8 - Adopto një kopsht | po (por të mbërthyera me gozhda) | jo | jo | po | po | po | jo |
| Nr. 11 "Cicërimat" - Adopto një kopsht | jo | jo | jo | jo | jo | po | po |
| Nr. 14 | po | jo | po | po | po | po | po |
| Nr. 17 | na | na | na | na | na | na | na |
| Nr. 19 - Adopto një kopsht | po | jo | jo | po | po | po | po |
| Nr. 20 - Adopto një kopsht | po | po | jo | jo | jo | po | po |
| Nr. 21 - Adopto një kopsht | po | jo | jo | po | po | po | po |
| Nr. 24- Adopto një kopsht | po | jo | jo | po | po | po | po |
| Nr. 25/A- Adopto një kopsht | po | jo | po | po | po | po | po |
| Nr. 25/1 "Duarartët"- Adopto një kopsht | jo | jo | jo | jo | jo | po | po |
| Nr. 26 "Dielli"- Adopto një kopsht | jo | jo | jo | po | po | po | po |
| Nr. 27/K- Adopto një kopsht | jo | jo | jo | po | po | po | po |
| Nr. 27/- Adopto një kopsht A | po | jo | po | jo | jo | po | jo |
| Nr. 28 "Avatar"- Adopto një kopsht | po | jo | jo | jo | jo | po | po |
| Nr. 29 | po | jo | jo | po | po | po | po |
| Nr. 29/1 | po | po | jo | po | po | po | po |
| Nr. 31- Adopto një kopsht | po | jo | po | po | po | po | po |
| Nr. 34 | jo | jo | jo | jo | jo | po | po |
| Nr. 35 | po | jo | po | jo | po | po | po |
| Nr. 36- Adopto një kopsht | jo | jo | jo | po | jo | po | po |
| Nr. 38- Adopto një kopsht | po | jo | jo | po | po | po | po |
| Nr. 39- Adopto një kopsht | jo | jo | po | po | po | po | po |
| Nr. 40 "Nënë Tereza" | po | jo | po | po | po | po | po |
| Nr. 41 | po | jo | po | po | po | po | po |
| Nr. 42 | po | jo | Po - vendosur vetë nga edukatoret dhe fëmijët | po | po | po | po |
| Nr. 43 | po | po | jo | po | po | po | po |
| Nr. 45 "4 Stinët" - Adopto një kopsht | po | jo | jo | po | jo | po | po |
| Nr. 51 "Tomi & Xherri" - Adopto një kopsht | jo | jo | jo | jo | jo | po | po |
| Nr. 52 - Adopto një kopsht | po | jo | po | jo | jo | po | po |
| Nr. 55 | jo | jo | jo | jo | jo | po | po |
| Nr. 56 - Adopto një kopsht | jo | jo | jo | jo | jo | po | po |
| Nr. 60 | po | jo | jo | jo | jo | po | jo |
| Nr. 64 "Xixëllonjat" - Adopto një kopsht | po | jo | jo | jo | jo | po | jo |
| Bregu Lumit - Adopto një kopsht | jo | jo | jo | po | jo | po | po |
| Kodër Kamëz | jo | jo | jo | jo | jo | po | po |
| Shkozë "Ylber" | jo | jo | jo | jo | jo | po | po |
| Shkozë | po | jo | jo | po | po | po | po |
| Nr. 18 - rikonstruksion | na | na | na | na | na | na | na |

# Aneks 10 – Sistemi CCTV dhe njoftimi zanor

| Kopshtet | Dhomë serveri ku të jetë i vendosur sistemi CCTV | Kamera sigurie në secilën dhomë dhe ambient që të sigurojnë informacion të rrjedhshëm | Kamera funksionale në hyrje të kopshtit | Altoparlantë në korridore | Altoparlantë në ambientet e përbashkëta (klasa, dhoma fjetje, etj) |
|---|---|---|---|---|---|
| **"Borëbardha" - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | po | po |
| **Nr. 1** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 2 "Peter Pan" - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 3** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 6 - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 8 - Adopto një kopsht** | po | po | po | jo | jo |
| **Nr. 11 "Cicërimat" - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 14** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 17** | na | na | na | na | na |
| **Nr. 19 - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | na | na |
| **Nr. 20 - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 21 - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 24- Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | na | jo |
| **Nr. 25/A- Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 25/1 "Duarartët"- Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 26 "Dielli"- Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 27/K- Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 27/- Adopto një kopsht A** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 28 "Avatar"- Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 29** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 29/1** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 31- Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 34** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 35** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 36- Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 38- Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 39- Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 40 "Nënë Tereza"** | na | jo | na | jo | jo |
| **Nr. 41** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 42** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 43** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 45 "4 Stinët" - Adopto një kopsht** | po | na | po | po | jo |
| **Nr. 51 "Tomi & Xherri" - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 52 - Adopto një kopsht** | na | na | na | na | na |
| **Nr. 55** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 56 - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 60** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Nr. 64 "Xixëllonjat" - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | po | po |
| **Bregu Lumit - Adopto një kopsht** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Kodër Kamëz** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Shkozë "Ylber"** | jo | jo | jo | jo | jo |
| **Shkozë** | jo | jo | jo | jo | jo |
| Nr. 18 - rikonstruksion | na | na | na | na | na |

# Aneks 11 – Lista e kopshteve dhe fëmijët e regjistruar

| Nr | Kopshte publike | Fëmijë të regjistruar Shtator 2016 | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Grupi i parë** | | **Grupi i dytë** | | **Grupi i tretë** *(pa përgatitorët)* | | **Grup i perzier** | | **Gjithsej** | |
| | | **Gjithsej** | **Femra** | **Gjithsej** | **Femra** | **Gjithsej** | **Femra** | **Gjithsej** | **Femra** | **Gjithsej** | **Femra** |
| 1 | 1 | 34 | 12 | 32 | 19 | 0 | 0 | 82 | 41 | 148 | 72 |
| 2 | 2 | 42 | 16 | 92 | 42 | 43 | 19 | 0 | 0 | 177 | 77 |
| 3 | 3 | 62 | 30 | 61 | 32 | 50 | 36 | 61 | 31 | 234 | 129 |
| 4 | 6 | 57 | 31 | 109 | 41 | 54 | 23 | 0 | 0 | 220 | 95 |
| 5 | 8 | 42 | 21 | 72 | 28 | 80 | 33 | 0 | 0 | 194 | 82 |
| 6 | 11 | 40 | 19 | 41 | 19 | 34 | 17 | 43 | 18 | 158 | 73 |
| 7 | 14 | 95 | 42 | 96 | 40 | 46 | 18 | 0 | 0 | 237 | 100 |
| 7 | 14 pa ushqim | 0 | 0 | 25 | 6 | 0 | 0 | 0 | 0 | 25 | 6 |
| 8 | 17 | 26 | 6 | 27 | 9 | 0 | 0 | 0 | 0 | 53 | 15 |
| 9 | 18 | 38 | 18 | 40 | 19 | 40 | 17 | 38 | 10 | 156 | 64 |
| 10 | 19 | 40 | 19 | 42 | 19 | 86 | 42 | 0 | 0 | 168 | 80 |
| 11 | 20 | 64 | 40 | 40 | 18 | 0 | 0 | 42 | 15 | 146 | 73 |
| 12 | 21/KOMBINAT | 36 | 16 | 94 | 47 | 0 | 0 | 0 | 0 | 130 | 63 |
| 13 | 22 | 38 | 22 | 39 | 23 | 39 | 22 | 38 | 19 | 154 | 86 |
| 14 | 24 | 57 | 29 | 54 | 28 | 54 | 29 | 58 | 25 | 223 | 111 |
| 15 | 25 ALLIAS | 51 | 24 | 39 | 14 | 42 | 18 | 0 | 0 | 132 | 56 |
| 16 | 25/'1 | 49 | 27 | 45 | 15 | 34 | 11 | 42 | 20 | 170 | 73 |
| 17 | 26 | 54 | 28 | 108 | 50 | 48 | 18 | 0 | 0 | 210 | 96 |
| 18 | 27 ALLIAS | 32 | 17 | 65 | 30 | 36 | 22 | 0 | 0 | 133 | 69 |
| 18 | 27 ALLIAS pa ushqim | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 34 | 12 | 34 | 12 |
| 19 | 27KOMBINAT | 40 | 25 | 80 | 34 | 40 | 16 | 0 | 0 | 160 | 75 |
| 20 | 28 LAPRAKË | 45 | 22 | 41 | 18 | 0 | 0 | 0 | 0 | 86 | 40 |
| 20 | 28 LAPRAKE pa ushqim | 0 | 0 | 41 | 18 | 0 | 0 | 0 | 0 | 41 | 18 |
| 21 | 29 | 41 | 17 | 66 | 35 | 37 | 18 | 0 | 0 | 144 | 70 |
| 22 | 31 | 70 | 33 | 68 | 25 | 67 | 29 | 35 | 19 | 240 | 106 |
| 23 | 34 KOMBINAT | 28 | 13 | 0 | 0 | 26 | 9 | 0 | 0 | 54 | 22 |
| 23 | 34 KOMBINAT pa ushqim | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 29 | 8 | 29 | 8 |
| 24 | 35 | 45 | 28 | 79 | 32 | 47 | 26 | 0 | 0 | 171 | 86 |
| 25 | 36 | 54 | 25 | 97 | 44 | 56 | 28 | 0 | 0 | 207 | 97 |
| 26 | 38KOMBINAT | 35 | 16 | 65 | 38 | 31 | 22 | 0 | 0 | 131 | 76 |
| 27 | 39 | 38 | 17 | 40 | 18 | 35 | 19 | 40 | 27 | 153 | 81 |
| 28 | 40 | 38 | 23 | 36 | 14 | 82 | 39 | 0 | 0 | 156 | 76 |
| 29 | 41 | 69 | 38 | 58 | 28 | 71 | 37 | 48 | 20 | 246 | 123 |
| 30 | 42 | 45 | 26 | 47 | 18 | 47 | 26 | 49 | 23 | 188 | 93 |
| 31 | 43 | 50 | 26 | 40 | 14 | 40 | 23 | 35 | 24 | 165 | 87 |
| 32 | 45 | 73 | 31 | 84 | 33 | 44 | 22 | 62 | 25 | 263 | 111 |
| 33 | 51 | 61 | 36 | 48 | 25 | 46 | 25 | 54 | 26 | 209 | 112 |
| 34 | 52 | 35 | 17 | 31 | 15 | 52 | 29 | 0 | 0 | 118 | 61 |
| 35 | 55 pa ushqim | 23 | 7 | 57 | 23 | 60 | 30 | 0 | 0 | 140 | 60 |
| 36 | 56 | 64 | 33 | 45 | 20 | 48 | 24 | 40 | 12 | 197 | 89 |
| 37 | 60 pa ushqim | 12 | 7 | 20 | 10 | 15 | 8 | 0 | 0 | 47 | 25 |
| 38 | K.KAMZË pa ushqim | 33 | 15 | 54 | 25 | 26 | 13 | 0 | 0 | 113 | 53 |
| 39 | SHKOZË pa ushqim | 35 | 15 | 35 | 12 | 7 | 3 | 25 | 13 | 102 | 43 |
| 40 | BREGU I LUMIT pa ushqim | 80 | 40 | 44 | 13 | 86 | 51 | 0 | 0 | 210 | 104 |
| 41 | SAUK pa ushqim | 59 | 25 | 63 | 32 | 59 | 23 | 0 | 0 | 181 | 80 |
| 42 | K.F.AVIACIONIT | 54 | 24 | 85 | 54 | 0 | 0 | 0 | 0 | 139 | 78 |
| 43 | SHKOZË E RE pa ushqim | 30 | 15 | 35 | 17 | 30 | 14 | 0 | 0 | 95 | 46 |
| | Gjithsej | 2014 | 991 | 2480 | 1114 | 1738 | 859 | 855 | 388 | 7087 | 3352 |

# MODULI I MUNITORIMIT

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | **[illegible]** | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | **[illegible]** | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | **[illegible]** | | | | |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| [illegible] | **[illegible]** | | | | |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| Hapësira e jashtme | **[illegible]** | | | | |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | **[illegible]** | | | | |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| Siguria | **[illegible]** | | | | |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | **[illegible]** | | | | |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | **[illegible]** | | | | |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | **[illegible]** | | | | |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | **[illegible]** | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Higjena | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |
| | [illegible] | | | [illegible] | [illegible] |

KAPITULLI 2

# ANKETIMI I PRINDËRVE



# 2. ANKETIMI I PRINDËRVE

## 2.1 Qëllimi i përgjithshëm:

Qëllimi i këtij studimi është matja e kënaqësisë së prindërve në 43 kopshtet publike të Tiranës në lidhje me respektimin e standardeve të infrastrukturës fizike, sigurisë, higjienës, si dhe kapaciteteve pritëse të tyre.

## 2.2. Objektivat specifikë:

Objektivat specifikë të këtij studimi janë:

1. Të përcaktohet shpërndarja e subjekteve të studimit sipas faktorëve demografikë;
2. Të përcaktohet shpërndarja e kënaqësisë së subjekteve të studimit në lidhje me infrastrukturën fizike të kopshteve;
3. Të përcaktohet shpërndarja e kënaqësisë së subjekteve të studimit në lidhje me sigurinë në kopshte;
4. Të përcaktohet shpërndarja e kënaqësisë së subjekteve të studimit në lidhje me punën e psikologut;
5. Të përcaktohet shpërndarja e kënaqësisë së subjekteve të studimit në lidhje me aksesin e duhur shëndetësor në kopsht;
6. Të përcaktohet shpërndarja e kënaqësisë së subjekteve të studimit në lidhje me aspektet më të rëndësishme të kopshteve;
7. Të përcaktohet shpërndarja e kënaqësisë së subjekteve të studimit në lidhje me

kontribuimin në kopshtin e fëmijës së tyre;
8. Të përcaktohet lidhja (shoqërimi) midis faktorëve social - demografikë dhe kënaqësisë së prindërve lidhur me kushtet fizike, infrastrukturore, të sigurisë, higjienës dhe popullimit të kopshteve;
9. Të analizohen rezultatet dhe të bëhet krahasimi me referencat e njohura të literaturës;
10. Të nxirren konkluzionet e nevojshme bazuar në të dhënat e rezultateve.

## 2.3 Metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave nga anketimi

### *2.3.1 Periudha kohore e studimit*

Studimi ka nisur në shkurt të vitit 2017 dhe ka përfunduar në prill të vitit 2017, pra me një kohëzgjatje 2-mujore. Procesi i anketimit të prindërve, për perceptimin e kënaqësisë së tyre lidhur me kushtet fizike, infrastrukturore, të sigurisë, higjienës dhe popullimit të kopshteve të fëmijëve të tyre, zgjati për një periudhë 2-mujore.

### *2.3.2 Karakteristikat e popullatës së marrë në studim*

Studimi është kryer në 43 kopshtet publike të Tiranës. Kopshtet private nuk u përfshinë në studim, pasi nuk ka të dhëna të sakta për listën e plotë të kopshteve private dhe numrin e saktë të fëmijëve të regjistruar, duke marrë parasysh që jo të gjitha kopshtet janë të deklaruara dhe të licencuara.

Në çdo rast, përgjithësimi i rezultateve të këtij studimi do t'i referohet kopshteve publike në qytetin e Tiranës. Nga kjo pikëpamje, përjashtimi i kopshteve private nga ky studim nuk e cenon aspak vlefshmërinë e punimit në tërësi.

Ky studim është bërë në qytetin e Tiranës, ku jeton rreth 30% e popullsisë së vendit. Monitorimi i 43 kopshteve të Tiranës është bazuar në listën e konfirmuar nga Ministria e Arsimit dhe QEZHEF Tiranë. Qyteti i Tiranës ka 43 kopshte publike, me 7087 fëmijë të regjistruar. Pikërisht kjo listë shërbeu dhe si kornizë kampionimi në studimin aktual. Lista e kopshteve publike të Tiranës është paraqitur në rubrikën aneks në fund të punimit.

Kopshtet publike janë institucione të arsimit parashkollor publik jo të detyrueshëm, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Kopshtet janë gjysmë-ditore ose gjithë-ditore, dhe funksionojnë gjatë gjithë vitit. Në kopshte regjistrohen fëmijët 3 - 6 vjeç, të ndarë në grupe sipas grupmoshave. Në grupin e parë regjistrohen fëmijët e moshës nga 3 - 4 vjeç. Në grupin e dytë regjistrohen fëmijët e moshës 4 - 5 vjeç, dhe ata që kanë mbushur 5 vjeç regjistrohen në grupin e tretë.

Në disa kopshte ka edhe grupe të përziera, ku numri i fëmijëve të së njëjtës grupmoshë e tejkalon numrin e lejuar për një grup, që zakonisht varion nga 35 deri në 40 fëmijë. Në grupe të përziera bashkohen fëmijët e mbetur nga grupi i parë dhe i dytë, ose ata të mbetur nga grupi i dytë dhe i tretë.

Në çdo grup për fëmijët kujdesen 2 edukatore dhe, në rastet kur njëra prej tyre mungon, ajo zëvendësohet nga drejtoresha. Fëmijët përfshihen në programe edukative, krijuese dhe marrin

pjesë në lojëra të ndryshme.

Gjatë kohës në kopsht fëmijët konsumojnë vaktin e mëngjesit dhe të drekës, në orare të rregullta me një dietë të kontrolluar, sipas standardeve përkatëse.

Nga informacioni që morëm në kopshtet ku u krye studimi, rezultoi se asnjë mjek dhe psikolog nuk ishte paraqitur në këto kopshte për një periudhë kohe shumë të gjatë, konkretisht në kopshtin nr. 56, kopshtin Kodër Kamëz dhe kopshtin Shkozë (pranë banesave sociale) psikologu mungonte prej më shumë se 6 muajsh.

Gjatë monitorimit u vu re përdorimi i rezistencave për ngrohje, edhe pse kaldajat ishin të pranishme në këto ambiente. Lidhur me kontributin që prindërit japin në kopsht, ekziston kontributi vjetor i cili përdoret për të paguar rojën, si dhe kontribute shtesë që jepen për materiale didaktike ose të higjienës.

## *2.3.3 Përzgjedhja e mostrës së marrë në studim*

Në këtë studim u përfshinë 43 kopshtet publike të qytetit të Tiranës, sipas listës së siguruar nga Ministria e Arsimit dhe QEZHEF Tiranë. Këto kopshte përfaqësojnë shumë mirë qytetin e Tiranës. Lista e kopshteve publike të Tiranës është paraqitur në rubrikën aneks në fund të punimit.

### Madhësia e mostrës së marrë në studim

Në total në këtë studim u përfshinë 1320 prindër/kujdestarë të fëmijëve, të cilët u anketuan në momentin që ata paraqiteshin në ambientet e kopshtit për të marrë fëmijën e tyre. Orari më i përshtatshëm në të cilin u realizua anketimi i prindërve ishte 12.00 -13.00 dhe 15.00 -17.00, orar në të cilin prindërit merrnin fëmijët nga kopshti. Nga këta 1320 pyetësorë, u gjetën të pavlefshëm 14. Pra, shkalla e pjesëmarrjes në studim ishte 98.9%. Por, në fakt, kampioni përfundimtar i këtij studimi (n=1306) kishte një madhësi shumë të gjerë për të realizuar qëllimin edhe objektivat e këtij studimi.

### Mbledhja e të dhënave në studim

Mbledhja e informacionit të nevojshëm për këtë studim u realizua me miratimin e marrë nga Ministria e Arsimit dhe QEZHEF. Mbledhja e këtyre të dhënave u krye nëpërmjet pyetësorëve të cilët u plotësuan nga prindërit gjatë muajve shkurt –prill, kohë gjatë së cilës u zhvillua procesi i anketimit të prindërve për perceptimin e kënaqësisë lidhur me kushtet fizike, infrastrukturore, të sigurisë, higjienës dhe popullimit të kopshteve publike të Tiranës.

### Pyetësorët e përdorur në studim

*Për këtë studim u përgatit një pyetësor i strukturuar në përshtatje me disa modele të përdorura në studime të tjera të ngjashme.* Pyetësori është paraqitur në rubrikën aneks në fund

të punimit. Informacioni i përgjithshëm i kërkuar në pyetësor përmbante ID e pyetësorit, data e plotësimit, nr. kopshtit, moshën e fëmijës, gjininë e fëmijës, emrin e prindit/kujdestarit, si dhe numrin e telefonit.

Pyetjet ishin të shkurtra dhe në të shumtën e rasteve kërkohej përgjigje duke zgjedhur njërën nga aternativat (gjithmonë, ndonjëherë, rrallë, asnjëherë, nuk e di), si dhe alternativën po, jo, nuk e di.

Përgjigjet duhet të plotësoheshin nga prindërit/kujdestari i fëmijës, duke zgjedhur njërën nga alternativat. Pyetjet e pyetësorit ishin të qarta dhe të thjeshta për t'u kuptuar dhe interpretuar nga ana e prindërve, dhe kërkonin informacion në lidhje me disa të dhëna të rëndësishme, si:

1. Statusi social ekonomik i nënës/kujdestarit, që ka të bëjë me arsimimin dhe nivelin ekonomik të tyre. Arsimimi lidhet me shkollimin e ndjekur nga prindi/kujdestari dhe është në 5 nivele, nga arsimimi i ulët deri tek ai pasuniversitar. Niveli ekonomik është përcaktuar në 4 nivele dhe është lënë në dorë të zgjedhjes së prindërve, pasi në vendin tonë nuk ka të dhëna me shifra të sakta në lidhje me nivelin ekonomik për familjet shqiptare, duke marrë parasysh deklarimin jo të plotë të të ardhurave dhe informalitetin. Prindërit mund ta klasifikonin nivelin ekonomik të familjes së tyre si më të ulët, pothuajse njëlloj, më të lartë ose refuzon, kjo në krahasim me familjet e tjera shqiptare.
2. Aksesin e duhur shëndetësor lidhur me kujdesin e ofruar nga mjeku dhe punën e psikologut, si mbështetje për fëmijën e tyre në kopsht, që është në 5 nivele (gjithmonë, ndonjëherë, rrallë, asnjëherë dhe nuk e di).
3. Hapësirën e brendshme dhe të jashtme të kopshteve, që është në 5 nivele (gjithmonë, ndonjëherë, rrallë, asnjëherë dhe nuk e di).
4. Facilitetet e brendshme lidhur me furnizimin me energji elektrike, freskinë e ambienteve gjatë ditëve të nxehta, praninë e ujit të ngrohtë dhe të ftohtë pa ndërprerje në kopshte, që është në 5 nivele (gjithmonë, ndonjëherë, rrallë, asnjëherë dhe nuk e di).
5. Higjienën e kopshteve në lidhje me ajrosjen dhe pastërtinë e ambienteve të brendshme (tualetet, kuzhina, klasa), pastrimin e ambienteve të kopshtit para ardhjes në kopsht dhe në momentin e largimit nga kopshti.
6. Kontribuimin dhe format e kontribuimit, ku vlen të theksohet forma e kontribuimit, që raportohet në 5 nivele (me para, me dhurata, me objekte dhe suplemente të higjienës, me ide dhe tjetër (specifiko).

## Analiza statistikore e të dhënave në studim

Procedurat e analizës statistikore të përdorura në këtë studim përshkruhen në paragrafët e mëposhtëm:

1. Për variablat (ndryshoret) kategorike u llogaritën vlerat absolute dhe përqindjet përkatëse.
2. Krahasimi i proporcioneve (përqindjeve) për variablet kategorike u mundësua përmes testit Hi Katror.
3. Në të gjitha rastet u konsiderua statistikisht sinjifikative (e përfillshme) një vlerë e $p \leq 0.05$.
4. E gjithë analiza statistikore u realizua në SPSS (Statistical Package for Social Sciences, Version 21.0).
5. Rezultatet u paraqitën në vlerë absolute dhe në përqindje, dhe u ilustruan nëpërmjet tabelave dhe figurave të grafikëve.

## *2.3.4 Rezultatet*

### Shpërndarja e subjekteve sipas karakteristikave demografike

Tabela e mëposhtme tregon shpërndarjen e prindërve/kujdestarëve sipas nivelit arsimor. Nga të dhënat rezulton se, 3.07% e prindërve rezultojnë me arsim të ulët, 16.17% rezultojnë me arsim tetëvjeçar, 40.15 me arsim të mesëm, 39.46 me arsim të lartë dhe 1.15% e prindërve rezultojnë me arsim pasuniversitar.

| Variabli | Numri | Perqindja |
|---|---|---|
| **Arsimi:** | | |
| **Arsimim i ulët** | 40 | 3.07 |
| **Arsimim tetëvjeçar** | 211 | 16.17 |
| **Arsimim i mesëm** | 524 | 40.15 |
| **Arsimim i lartë** | 515 | 39.46 |
| **Arsimim pasuniversitar** | 15 | 1.15 |

*Tabela.: Shpërndarja e subjekteve të studimit sipas nivelit arsimor të prindit/kujdestarit.*




*Grafik: Shpërndarja e subjekteve të studimit sipas nivelit arsimor*

Tabela 1.1 tregon shpërndarjen e prindërve në lidhje me punësimin e tyre, ku nga të dhënat rezulton se, 44.63% (n=582) e prindërve deklarojnë që janë të punësuar në sektorin privat, 19.62% (n=256) në sektorin shtetëror dhe 28.37% (n=370) në profesione të tjera. Ndërsa 7.35% (n=96) prindër refuzuan t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| Punësimi: | | |
| Sektorin privat | 582 | 44.63 |
| Sektorin shtetëror | 256 | 19.62 |
| Refuzon | 96 | 7.35 |
| Profesione të tjera | 370 | 28.37 |

*Tabela 1.1: Shpërndarja e subjekteve të studimit në lidhje me punësimin.*




*Grafik 2: Shpërndarja e subjekteve të studimit n*ë lidhje me nivelin e punësimit.

Tabela 1.2 tregon shpërndarjen e prindërve në lidhje me nivelin ekonomik, krahasuar me familjet e tjera shqiptare, ku nga të dhënat rezulton se, 15.47% (n=202) deklarojnë se janë me nivel më të ulët ekonomik, krahasuar me familjet e tjera shqiptare, 80% (n=1051) deklarojnë pothuajse njëlloj dhe rreth 2.76% (n=36) me nivel ekonomik më të lartë.

.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| Niveli ekonomik | | |
| Më të ulët | **202** | **15.47** |
| Pothuajse njëlloj | **1051** | **80.47** |
| Më të lartë | **36** | **2.76** |
| Refuzon | **17** | **1.30** |

*Tabela 1.2: Shpërndarja e subjekteve të studimit sipas nivelit ekonomik krahasuar me familjet e tjera shqiptare.*




*Grafik 3: Shpërndarja e subjekteve të studimit sipas nivelit ekonomik krahasuar me familjet e tjera shqiptare*

Tabela 1.3 tregon shpërndarjen e fëmijëve sipas klasës/grupmoshës. Nga të dhënat e mbledhura rezulton se, rreth 38.13% (n=498) ishin të grupmoshës 3-4 vjeç, 35.38% (n=462) të grupmoshës 4-5 vjeç dhe rreth 26.49% (n=346) ishin të grupmoshës 5-6 vjeç.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| Grupmosha: | | |
| 3 – 4 vjeç | **498** | **38.13** |
| 4 – 5 vjeç | **462** | **35.38** |
| 5 – 6 vjeç | **346** | **26.49** |

*Tabela 1.3 Shpërndarja e fëmijeve sipas klasës/grupmoshës.*




*Grafik 4: Shpërndarja e fëmijëve sipas klasës/grupmoshës*

Tabela 1.4 tregon shpërndarjen e prindërve në lidhje me numrin e edukatoreve që kanë fëmijët e tyre. Nga të dhënat rezulton se, 12.78% e prindërve deklarojnë se fëmija i tyre ka 1 (një) edukatore, ndërsa 85.14% e tyre deklarojnë se fëmija i tyre ka 2 (dy) edukatore. Vetëm 2.08% u përgjigjen nuk e di.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| Nr.Edukatoreve: | | |
| 1 | **167** | **12.78** |
| 2 | **1112** | **85.14** |
| Nuk e di | **27** | **2.08** |

*Tabela 1.4: Shpërndarja e subjekteve të studimit sipas numrit të edukatoreve që ka fëmija i tyre.*




*Grafik 5: Shpërndarja e subjekteve të studimit sipas numrit të edukatoreve që ka fëmija i tyre.*

Tabela 1.5 tregon perceptimin e prindërve në lidhje me marrjen e kujdesit të duhur shëndetësor nga fëmija i tyre në kopsht. Nga të dhënat rezulton se, 55.67% e prindërve deklarojnë se fëmija i tyre e merr gjithmonë kujdesin e duhur shëndetësor, 14.78% deklarojnë ndonjëherë, 3.13% deklarojnë rrallë dhe 8.04% deklarojnë se fëmija i tyre nuk e merr asnjëherë kujdesin e duhur shëndetësor.Vetëm 18.38% e prindërve u përgjigjën nuk e di.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| Mendoni se fëmija juaj merr kujdesin e duhur shëndetësor në kopsht: | | |
| Gjithmonë | **727** | **55.67** |
| Ndonjëherë | **193** | **14.78** |
| Rrallë | **41** | **3.13** |
| Asnjëherë | **105** | **8.04** |
| Nuk e di | **240** | **18.38** |

*Tabela 1.5: Tregon perceptimin e prindërve në lidhje me marrjen e kujdesit të duhur shëndetësor nga fëmija i tyre në kopsht.*




*Grafik 6: Perceptimi i prindërve në lidhje me marrjen e kujdesit të duhur shëndetësor nga fëmija i tyre në kopsht.*

Tabela 1.6 tregon perceptimin e prindërve në lidhje me punën e psikologut si mbështetje për fëmijët e tyre. Nga të dhënat rezulton se, 40.69% e prindërve deklarojnë se puna e psikologut shërben gjithmonë si mbështetje për fëmijët e tyre, 8.74% deklarojnë ndonjëherë shërben si mbështetje, 3.13% deklarojnë rrallë shërben si mbështetje dhe 8.04% deklarojnë se puna e psikologut nuk shërben asnjëherë si mbështetje për fëmijët e tyre. Vetëm 18.38% e prindërve janë përgjigjur nuk e di.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| A mendoni se puna e psikologut i jep mbështetjen e duhur fëmijës suaj: | | |
| Gjithmonë | **531** | **40.69** |
| Ndonjëherë | **114** | **8.74** |
| Rrallë | **41** | **3.13** |
| Asnjëherë | **105** | **8.04** |
| Nuk e di | **240** | **18.38** |

*Tabela 1.6: Perceptimi i prindërve lidhur me punën e psikologut si mbështetje për fëmijët e tyre.*




*Grafik 7: Perceptimi i prindërve lidhur me punën e psikologut si mbështetje për fëmijët e tyre.*

Tabela 1 .7 tregon se shumica e prindërve (98.7%, n=1289) u shprehen se fëmija i tyre nuk bën pjesë në grupin e fëmijëve me aftësi të kufizuara lëvizëse, kundrejt 1.3% (n=17) të cilët u shprehën se fëmija i tyre bën pjesë në këtë grup.

| **Variabli** | **Numri** | **Përqindja** |
|---|---|---|
| **Aftësitë e kufizuara lëvizëse:** | | |
| **Po** | **17** | **1.3** |
| **Jo** | **1289** | **98.7** |

*Tabela 1.7: Perceptimi i prindërve nëse fëmija i tyre është me aftësi të kufizuara lëvizëse.*




*Grafik 8: Perceptimi i prindërve nëse fëmija i tyre është me aftësi të kufizuara lëvizëse.*

Tabela 1.8 tregon perceptimin e prindërve nëse kopshti është i pajisur me rampa dhe lehtësitë e nevojshme për lehtësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara lëvizëse. Nga të dhënat rezulton se, 17.99% e prindërve deklarojnë se kopshti është i pajisur me rampa dhe lehtësitë e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, 56.82% deklarojnë që nuk i ka rampat dhe lehtësitë e nevojshme dhe 25.19% janë përgjigjur nuk e di.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| Pajisja me rampa | | |
| Po | **235** | **17.99** |
| Jo | **742** | **56.82** |
| Nuk e di | **329** | **25.19** |

*Tabela 1.8: Shpërndarja nëse kopshti është i pajisur me rampa dhe lehtësitë e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara lëvizëse.*




*Grafik 9: Shpërndarja nëse kopshti* është i pajisur me ramp*a dhe lehtësitë e nevojshme për fëmijët me aftësi të kufizuara lëvizëse.*

Tabela 1.9 tregon perceptimin e prindërve lidhur me lehtësitë që u ofrohen për të hyrë në ambientet e brendshme me karrocën e fëmijës së tyre. Nga të dhënat rezulton se, 34.84% e prindërve deklarojnë se kanë gjithmonë lehtësi për të hyrë në ambientet e brendshme të kopshtit me karrocën e fëmijës së tyre, 6.89% deklarojnë ndonjëherë, 5,28% deklarojnë se rrallë kanë lehtësira dhe 11.03% deklarojnë që nuk kanë pasur asnjëherë lehtësira për të hyrë me karrocën e fëmijës në ambientet e brendshme të kopshtit. 41.96% janë përgjigjur nuk e di.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| Lehtësia për hyrjen në kopsht: | | |
| Gjithmonë | **455** | **34.84** |
| Ndonjëherë | **90** | **6.89** |
| Rrallë | **69** | **5.28** |
| Asnjëherë | **144** | **11.03** |
| Nuk e di | **548** | **41.96** |

*Tabela 1.9: Perceptimi i prindërve lidhur me lehtësinë që u ofrohet për të hyrë në ambientet e brendshme me karrocën e fëmijës së tyre.*




*Grafik 10: Tregon perceptimin e prindërve lidhur me lehtësinë që u ofrohet për të hyrë në ambientet e brendshme me karrocën e fëmijës së tyre.*

Tabela1.10.1 tregon perceptimin e prindërve në lidhje me mjaftueshmërinë e hapësirës për të hyrë në ambientin pritës të fëmijëve, ku nga të dhënat rezulton se, 65.85% e prindërve deklarojnë se kanë pasur gjithmonë hapësirën e mjaftueshme për të hyrë në ambientin pritës të fëmijëve të tyre, 20.92% deklarojnë ndonjëherë kanë pasur hapësirën e mjaftueshme, 2.98% deklarojnë rrallë, 9.03% e prindërve deklarojnë që asnjëherë nuk e kanë pasur hapësirën e mjaftueshme dhe 1.22% e prindërve janë përgjigjur nuk e di.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| Mjaftueshmeria e hapësirës në ambientin e pritjes | | |
| Gjithmonë | **860** | **65.85** |
| Ndonjëherë | **273** | **20.92** |
| Rrallë | **39** | **2.98** |
| Asnjëherë | **118** | **9.03** |
| Nuk e di | **16** | **1.22** |

*Tabela 1.10.1: Perceptimi i prindërve në lidhje me mjaftueshmërinë e hapësirës për të hyrë në ambientin pritës të fëmijëve.*




*Grafik 11: Perceptimi i prindërve në lidhje me mjaftueshmërinë për të hyrë në ambientin pritës të fëmijëve.*

Tabela 1.10.2 tregon kënaqësinë e prindërve në lidhje me ngrohjen e ambienteve të brendshme të kopshtit në dimër, ku nga të dhënat rezulton se, 75.65% e prindërve deklarojnë se janë gjithmonë të kënaqur me ngrohjen e ambienteve të brendshme të kopshteve në dimër, 14.78% e prindërve deklarojnë se ndonjëherë janë të kënaqur, 2.37% deklarojnë se rralleherë janë të kënaqur, asnjëherë të kënaqur deklarojnë 5.59% e prindërve dhe 1.61% janë përgjigjur nuk e di.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| Kënaqësia për ngrohjen e ambienteve të brendshme të kopshtit | | |
| Gjithmonë | **988** | **75.65** |
| Ndonjëherë | **193** | **14.78** |
| Rrallë | **31** | **2.37** |
| Asnjëherë | **73** | **5.59** |
| Nuk e di | **21** | **1.61** |

*Tabela 1.10.2:* Kënaqësia e prindërve në lidhje me ngrohjen e ambienteve të brendshme të kopshtit në dimër.




*Grafik 12:* Kënaqësia *e prindërve në lidhje me ngrohjen e ambienteve të brendshme të kopshtit në dimër.*

Tabela 1.10.3 tregon perceptimin e prindërve në lidhje me freskinë e ambienteve të brendshme gjatë ditëve të nxehta, ku nga të dhënat rezulton se, 41.58% e prindërve deklarojnë se ambientet e brendshme janë gjithmonë të freskëta gjatë ditëve të nxehta,16.16% deklarojnë se ndonjëherë janë të freskëta, 3.67% deklarojnë se rrallë janë të freskëta, asnjëherë të freskëta deklarojnë 17.46% dhe 21.13% e prindërve janë përgjigjur nuk e di.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| A janë të freskëta ambientet e brendshme gjatë ditëve të nxehta: | | |
| Gjithmonë | **543** | **41.58** |
| Ndonjëherë | **211** | **16.16** |
| Rrallë | **48** | **3.67** |
| Asnjëherë | **228** | **17.46** |
| Nuk e di | **276** | **21.13** |

*Tabela 1.10.3: Perceptimi i prindërve nëse ambientet e brendshme janë të freskëta gjatë ditëve të nxehta.*




*Figura 13: Perceptimi i prindërve nëse ambientet e brendshme janë të freskëta gjatë ditëve të nxehta.*

Tabela 1.10.4 tregon perceptimin e prindërve nëse në ambientet e kopshtit ka ndodhur të mos ketë pasur drita, ku nga të dhënat rezulton se, 3.06% e prindërve deklarojnë se ka ndodhur gjithmonë të mos ketë pasur drita, 11.72% deklarojnë se ka ndodhur ndonjëherë, 5.74% deklarojnë se ka ndodhur rrallëherë, 29.79% deklarojnë asnjëherë dhe 49.69% e prindërve janë përgjigjur nuk e di.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| A ka ndodhur që në kopsht të mos ketë pasur drita: | | |
| Gjithmonë | **40** | **3.06** |
| Ndonjëherë | **153** | **11.72** |
| Rrallë | **75** | **5.74** |
| Asnjëherë | **389** | **29.79** |
| Nuk e di | **649** | **49.69** |

*Tabela 1.10.4: Perceptimi i prindërve nëse ka ndodhur që në ambientet e kopshtit të mos ketë pasur drita.*




*Figura 14: Perceptimi i prindërve nëse ka ndodhur që në ambientet e kopshtit të mos ketë pasur drita.*

Tabela 1.10.5 tregon perceptimin e prindërve nëse ka ndodhur që në kopsht të mos ketë pasur ujë të rrjedhshëm gjatë gjithë kohës. Nga të dhënat rezulton se, 3.98% deklarojnë se ka ndodhur gjithmonë, 7.04 % deklarojnë se ka ndodhur ndonjëherë, 4.29% deklarojnë se ka ndodhur rrallëherë, 30.02% deklarojnë asnjëherë dhe 54.67% janë përgjigjur nuk e di.

| Variabli | Numri | Perqindja |
|---|---|---|
| A ka ndodhur që në kopsht të mos ketë ujë të rrjedhshëm gjatë gjithë kohës: | | |
| Gjithmonë | **52** | **3.98** |
| Ndonjëherë | **92** | **7.04** |
| Rrallë | **56** | **4.29** |
| Asnjëherë | **392** | **30.02** |
| Nuk e di | **714** | **54.67** |

*Tabela 1.10.5: Perceptimi i prindërve nëse ka ndodhur që në kopsht të mos ketë pasur ujë të rrjedhshëm (të ngrohtë/të ftohtë) gjatë gjithë kohës.*




*Figura 15: Perceptimi i prindërve nëse ka ndodhur që në kopsht të mos ketë pasur ujë të rrjedhshëm (të ngrohtë/të ftohtë) gjatë gjithë kohës.*

Tabela1.10.6 tregon perceptimin e prindërve nëse e gjejnë të pastruar ambientin e brendshëm kur vijnë në mëngjes në kopsht për të sjellë fëmijën. Nga të dhënat rezulton se, 92.12% e prindërve deklarojnë se e gjejnë të pastruar ambientin e brendshëm kur vijnë në mëngjes për të sjellë fëmijën, 3.98% deklarojnë ndonjëherë, 0.69% deklarojnë se rrallëherë e gjejnë të pastruar, 0.84% deklarojnë asnjëherë dhe 2.37% e prindërve janë përgjigjur me nuk e di.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| A e gjeni të pastruar ambientin e brendshëm kur vini në mëngjes për të sjellë fëmijën: | | |
| Gjithmonë | **1203** | **92.12** |
| Ndonjëherë | **52** | **3.98** |
| Rrallë | **9** | **0.69** |
| Asnjëherë | **11** | **0.84** |
| Nuk e di | **31** | **2.37** |

*Tabela 1.10.6: Perceptimi i prindërve nëse e gjejnë të pastruar ambientin e brendshëm kur vijnë në mëngjes në kopsht për të sjellë fëmijën.*




*Grafik 16: Perceptimi i prindërve nëse e gjejnë të pastruar ambientin e brendshëm kur sjellin fëmijën në kopsht.*

Tabela 1.10.7 tregon perceptimin e prindërve nëse ambienti i jashtëm është i pastruar. Nga të dhënat rezulton se, 90.66% e prindërve deklarojnë se ambienti jashtë është gjithmonë i pastruar, 6.13% e prindërve deklarojnë se është i pastruar ndonjëherë, 1.15 % deklarojnë se rrallëherë është i pastruar, 1.45% deklarojnë asnjëherë dhe 0.61% e prindërve janë përgjigjur nuk e di.

| Variabli | Numri | Perqindja |
|---|---|---|
| A ëshët i pastruar ambienti i jashtëm: | | |
| Gjithmonë | **1184** | **90.66** |
| Ndonjëherë | **80** | **6.13** |
| Rrallë | **15** | **1.15** |
| Asnjëherë | **19** | **1.45** |
| Nuk e di | **8** | **0.61** |

*Tabela 1.10.7: Perceptimi i prindërve nëse ambienti i jashtëm është i pastruar*




*Grafik 17: Perceptimi i prindërve nëse ambienti i jashtëm është i pastruar*

Tabela 1.10.8 tregon perceptimin e prindërve nëse ambientet e brendshme të kopshtit janë të pastra dhe higjienike. Nga të dhënat rezulton se, 82.47% e prindërve deklarojnë se ambientet e brendshme të kopshtit janë gjithmonë të pastra, 6.58% e prindërve deklarojnë se janë të pastra ndonjëherë, 0.69% deklarojnë se rrallëherë janë të pastra dhe 1.15% deklarojnë se nuk janë asnjëherë të pastra. Me nuk e di janë përgjigjur 9.11%.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| A janë higjienike dhe të pastra ambientet e brendshme të kopshtit (tualetet, kuzhina, klasat etj): | | |
| Gjithmonë | **1077** | **82.47** |
| Ndonjëherë | **86** | **6.58** |
| Rrallë | **9** | **0.69** |
| Asnjëherë | **15** | **1.15** |
| Nuk e di | **119** | **9.11** |

*Tabela 1.10.8: Perceptimi i prindërve nëse ambientet e brendshme të kopshtit (tualetet, kuzhina, klasat etj) janë të pastra dhe higjienike.*




*Grafik 18: Perceptimi i prindërve nëse ambientet e brendshme të kopshtit (tualetet, kuzhina, klasat etj) janë të pastra dhe higjienike.*

Tabela 1.10.9 tregon shpërndarjen e prindërve lidhur me kontributin e dhënë në kopshtin e fëmijës së tyre. Nga të dhënat rezulton se, 60.95% e prindërve deklarojnë se kontribuojnë gjithmonë në kopshtin e fëmijës së tyre, 25.96% deklarojnë se kontribuojnë ndonjëherë, 1.15% deklarojnë rrallëherë, 9.80% deklarojnë se nuk kanë kontribuar asnjëherë, dhe nuk e di janë përgjigjur 2.14%.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| A keni kontribuar në kopshtin e fëmijës suaj: | | |
| Gjithmonë | **796** | **60.95** |
| Ndonjëherë | **339** | **25.96** |
| Rrallë | **15** | **1.15** |
| Asnjëherë | **128** | **9.80** |
| Nuk e di | **28** | **2.14** |

*Tabela 1.10.9: Shpërndarja e subjekteve të studimit nëse kanë kontribuar në kopshtin e fëmijës së tyre.*




*Grafiku 19 tregon shpërndarjen e subjekteve të studimit nëse kanë kontribuar në kopshtin e fëmijës së tyre.*

Tabela 1.11.1 tregon shpërndarjen e prindërve në lidhje me format e kontribuimit. Nga të dhënat rezulton se, 38.36% e prindërve kontribuojnë me para, 10.18% kontribuojnë me dhurata, 47.17% deklarojnë se kontribuojnë me objekte dhe suplemente të higjienës, 3.45% me ide dhe 0.84% deklarojnë se kontribuojnë me forma të tjera.

| Variabli | Numri | Përqindja |
|---|---|---|
| Në cilat forma kontribuoni: | | |
| Me para | **501** | **38.36** |
| Me dhurata | **133** | **10.18** |
| Me objekte dhe suplemente të higjienës | **616** | **47.17** |
| Me ide | **45** | **3.45** |
| Forma të tjera | **11** | **0.84** |

*Tabela 1.11.1: Shpërndarja e subjekteve të studimit lidhur me format e kontribuimit.*




*Figura 20: Shpërndarja e  subjekteve të studimit lidhur me format e kontribuimit.*

Tabela 1.11.2 paraqet shpërndarjen e nivelit arsimor të prindërve të përfshirë në studim dhe rezulton të ketë lidhje (shoqërim) domethënëse statistikore (p=0.020) me mbështetjen që i jep puna e psikologut fëmijës. Këto të dhëna paraqiten më të detajuara në tabelën 1.11.2.

| **Variabli** | **Gjithmonë** | **Ndonjëherë** | **Rrallë** | **Asnjëherë** | **Vlera e p-se** |
|---|---|---|---|---|---|
| **Arsimim i ulët** | 11 (2.07) | 3 (2.65) | 1 (3.44) | 3 (2.88)µ | |
| **Arsimim tetëvjeçar** | 72 (13.58) | 19 (16.81) | 1 (3.44) | 22 (21.15) | |
| **Arsimim i mesëm** | 210 (39.62) | 48 (42.48) | 13 (44.83) | 48 (46.16) | |
| **Arsimim i lartë** | 231 (43.58) | 39 (34.51) | 12 (41.39) | 30 (28.85) | |
| **Arsimim pasuniversitar** | 6 (1.13) | 4 (3.54) | 2 (6.9) | 1 (0.96) | P=0.020 £ |

£ Vlera e p-së sipas testit hi-katror
µ Numrat absolute dhe përqindjet në kllapa




*Grafik 21: Shpërndarja e mbështetjes që jep puna e psikologut sipas nivelit arsimor.*

Tabela 1.11.3 paraqet shpërndarjen e nivelit arsimor të prindërve të përfshirë në studim dhe rezulton të mos ketë lidhje (shoqërim) statistikisht të rëndësishme (p=0.153) me kujdesin e duhur shëndetësor që merr fëmija në kopsht. Këto të dhëna paraqiten më të detajuara në tabelën 1.11.3.

| Variabli | Gjithmonë | Ndon-jëherë | Rrallë | Asnjëherë | Vlera e p-së |
|---|---|---|---|---|---|
| **Arsimim i ulët** | 18 (2.48) | 9 (4.46) | 1 (2.44) | 6 (5.71) µ | |
| **Arsimim tetëvjeçar** | 108 (14.9) | 34 (17.71) | 3 (7.31) | 17 (16.19) | |
| **Arsimim i mesëm** | 299 (41.24) | 90 (46.87) | 12 (29.27) | 41 (39.05) | |
| **Arsimim i lartë** | 295 (40.69) | 55 (28.65) | 25 (60.98) | 40 (38.1) | |
| **Arsimim pasuniversitar** | 5 (0.69) | 4 (2.08) | 0(0.0) | 1 (0.95) | P=0.153£ |

£ Vlera e testit hi-katror

*µ Numrat absolute dhe përqindjet në kllapa*




*Grafik 22: Shpërndarja e kujdesit të duhur shëndetësor sipas nivelit arsimor.*

Tabela 1.11.4 paraqet shpërndarjen e nivelit ekonomik të prindërve të përfshirë në studim dhe rezulton të ketë lidhje (shoqërim) statistikisht të rëndësishme (p=0.000) me kontributin e prindërve në kopshtin e fëmijës së tyre. Këto të dhëna paraqiten më të detajuara në tabelën 1.11.4.

| Variabli | Gjithmonë | Ndonjëherë | Rrallë | Asnjëherë | Vlera e p-se |
|---|---|---|---|---|---|
| Më të ulët | 66(8.6) | 94 (27.9) | 4(26.7) | 32 (25.2) µ | |
| Pothuajse njëlloj | 680 (88.89) | 235 (69.73) | 10(66.7) | 94(74.01) | |
| Më të lartë | 19 (2.48) | 8 (2.37) | 1(6.6) | 1(0.79) | P=0.000£ |

£ Vlera e p-së sipas testit hi-katror
µ Numrat absolute dhe përqindjet në kllapa




*Grafik 23: Shpërndarja e kontribuimit në kopsht sipas nivelit ekonomik.*

## Për kopshtet e nismës "Adopto një kopsht"

**Tabela 1.11.4.** Paraqet shpërndarjen e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për praninë e rampave në kopshtet e fëmijëve të tyre. Nga të dhënat e raportuara, rezulton që niveli i perceptimit të prindërve në lidhje me praninë e rampave në kopshtin e fëmijëve të tyre mbetet i lartë, konkretisht në kopshtin nr. 19, nga ku rezulton se, 62.5% e prindërve deklarojnë se kopshti është i pajisur me rampa, kundrejt 37.5% të cilët deklarojnë mungesën e rampave në kopshtet e fëmijëve të tyre. Rezultatet e studimit konkludojnë perceptim të lartë edhe në kopshtet nr. 27 A dhe kopshtin 56, ku si rezultat i rikonstruktimit, 100% e prindërve të intervistuar raportojnë pajisjen e kopshtit me rampa. Gjithashtu, perceptimi i prindërve mbetet i lartë edhe në kopshtin nr. 52, nga ku rezulton se, 70% deklarojnë se kopshti është i pajisur me rampa, kundrejt 30%. Vihet re se, nga rezultatet e studimit në kopshtet e tjera të qytetit të Tiranës, perceptimi i prindërve për praninë e rampave në kopshtin e fëmijës së tyre mbetet i ulët. Më të detajuara këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme.

**Tabela 1.11.5.** paraqet shpërndarjen e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për lehtësinë e hyrjes nga jashtë në ambientet e brendshme të kopshtit me karrocën e fëmijës së tyre. Nga të dhënat e raportuara, rezulton që niveli i perceptimit të prindërve në lidhje me lehtësinë e hyrjes nga jashtë në ambientet e brendshme të kopshtit me karrocën e fëmijës së të tyre mbetet i ulët në kopshtin nr. 71, ku 100% e prindërve të intervistuar mendojnë se nuk e kanë të lehtë të hyjnë në ambientet e brendshme të kopshtit të fëmijës së tyre. Perceptimi mbetet i ulët edhe në kopshtin nr. 11, nga ku rezulton se, 21% nuk janë asnjëherë të kënaqur, 32.1% mendojnë rrallë, 32.1% mendojnë ndonjëherë dhe 14.3% mendojnë se gjithmonë janë të kënaqur. Nga rezultatet e studimit, vihet re se perceptimi i prindërve mbetet i ulët edhe në kopshtin nr. 26, nga ku rezulton se, 54.5% e prindërve mendojnë se asnjëherë s'kanë

| | Kopshti | Po | Jo | Nuk e di |
|---|---|---|---|---|
| **Njësia 11** | 70 | 38(73.1) | 14(26.9) | 0(0.0) |
| | 28 | 15(46.9)* | 17(53.1) | 0(0.0) |
| **Njësia 9** | 36 | 2(14.3) | 12(85.7) | 0(0.0) |
| **Njësia 8** | 6 | 2(9.1) | 20(90.9) | 0(0.0) |
| | 19 | 15(62.5) | 9(37.5) | 0(0.0) |
| **Njësia 4** | 27A | 30(100) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 25A | 14(51.9) | 13(48.1) | 0(0.0) |
| | 51 | 0(0.0) | 29(100) | 0(0.0) |
| | 39 | 14(51.9) | 13(48.1) | 0(0.0) |
| **Njësia 3** | 20 | 0(0.0) | 28(100) | 0(0.0) |
| **Njësia 1** | 56 | 19(100) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 24 | 10(50.0) | 9(45.0) | 0(5.0) |
| **Njësia 2** | Sauk i vjetër (71) | 0(0.0) | 30(100) | 0(0.0) |
| **Njësia 5** | 11 | 0(0.0) | 26(96.4) | 1(3.6) |
| | 25/1 | 14(51.9) | 13(48.1) | 0(0.0) |
| | 31 | 8(50.0) | 8(50.0) | 0(0.0) |
| | 42 | 6(27.3) | 16(72.7) | 0(0.0) |
| | 45 | 0(0.0) | 27(100) | 0(0.0) |
| | 52 | 7(70.0) | 3(30.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 7** | Xixëllonja (72) | 0(0.0) | 21(100) | 0(0.0) |
| | 2 | 4(22.2) | 14(77.8) | 0(0.0) |
| | 26 | 5(9.8) | 45(88.2) | 0(0.0) |
| **Njësia 10** | 8 | 0(0.0) | 30(100) | 0(0.0) |
| **Njësia 6** | 27 | 30(100) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 38 | 13(44.8) | 16(55.2) | 0(0.0) |

*Numrat absolute dhe përqindjet në kllapa

*Tabela 1.11.4: Shpërndarja e kopshteve të rikonstruktuara në lidhje me perceptimin e prindërve për pajisjen me rampa për lehtësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara lëvizëse.*

lehtësira për të hyrë nga jashtë në ambientet e brendshme, 13.6% mendojne rrallë, 4.5% mendojnë ndonjëherë dhe vetëm 27.5% e prindërve të intervistuar mendojnë së gjithmonë e kanë të lehtë të hyjnë nga jashtë në ambientet e brendshme të fëmijës së tyre. Ndërsa, në të gjitha kopshtet e tjera të rikonstruktuara, perceptimi i prindërve për lehtësirat që kanë për të hyrë nga jashtë në ambientet e brendshme të fëmijës së tyre mbetet i lartë. Më të detajuara këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme.

| Njësia | Kopshti Nr. | Gjithmonë | Ndon-jëherë | Rrallë | Asn-jëherë | Nuk e di |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Njësia 11** | 70 | 49(86.0)* | 0(0.0) | 0(0.0) | 8(14.0) | 0(0.0) |
| | 28 | 19(86.4) | 1(4.5) | 1(4.5) | 1(4.5) | 0(0.0) |
| **Njësia 9** | 36 | 13(81.3) | 2(12.5) | 1(6.3) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 8** | 6 | 11(64.7) | 3(17.6) | 0(0.0) | 3(17.6) | 0(0.0) |
| | 19 | 6(85.7) | 0(0.0) | 0(0.0) | 1(4.3) | 0(0.0) |
| **Njësia 4** | 27A | 27(100) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 25A | 29(93.5) | 0(0.0) | 0(0.0) | 2(6.5) | 0(0.0) |
| | 51 | 4(57.1) | 2(28.6) | 1(14.3) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 39 | 12(42.9) | 6(21.4) | 5(17.9) | 5(17.9) | 0(0.0) |
| **Njësia 3** | 20 | 9(90.0) | 1(10.0) | 0(0.0) | 1(14.3) | 0(0.0) |
| **Njësia 1** | 56 | 20(69.0) | 5(17.2) | 1(3.4) | 3(10.3) | 0(0.0) |
| | 24 | 20(64.5) | 6(19.4) | 3(9.7) | 2(6.5) | 0(0.0) |
| **Njësia 2** | Sauk i vjetër (71) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 15(100) | 0(0.0) |
| **Njësia 5** | 11 | 4(14.3) | 9(32.1) | 9(32.1) | 6(21.4) | 0(0.0) |
| | 31 | 17(89.5) | 1(5.3) | 1(5.3) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 42 | 8(100) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 52 | 20(100) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 7** | Xixëllon-ja(72) | 4(25.0) | 6(37.5) | 6(37.5) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 2 | 7(50.0) | 1(7.1) | 3(21.4) | 3(21.4) | 0(0.0) |
| | 26 | 6(27.3) | 1(4.5) | 3(13.6) | 12(54.5) | 0(0.0) |
| **Njësia 10** | 8 | 6(28.6) | 9(42.9) | 4(19.0) | 2(9.5) | 0(0.0) |
| **Njësia 6** | 21 | 28(96.6) | 0(0.0) | 0(0.0) | 1(3.4) | 0(0.0) |
| | 38 | 19(67.9) | 2(12.5) | 1(6.3) | 0(0.0) | 0(0.0) |

**Numrat absolute dhe përqindjet në kllapa*

*Tabela 1.11.5: Shpërndarja e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për lehtësinë e hyrjes nga jashtë në ambientet e brendshme të kopshtit me karrocën e fëmijës së tyre.*

**Tabela 1.11.6** paraqet shpërndarjen e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për mjaftueshmërinë e hapësirës për të hyrë në ambientin pritës të fëmijës së tyre. Rezultatet e studimit tregojnë se, nga të gjitha kopshtet e rikonstruktuara dy vitet e fundit, perceptimi i prindërve në lidhje me mjaftueshmërinë e hapësirës për të hyrë në ambientin pritës të fëmijëve të tyre mbetet i ulët, konkretisht në kopshtin nr. 71, nga ku rezulton se, 43.3% e prindërve të intervistuar asnjëherë nuk janë të kënaqur, 20% deklarojnë rrallë dhe vetëm 36.7% deklarojnë ndonjëherë. Perceptimi i prindërve mbetet i ulët edhe në kopshtin

nr. 26, ku nga rezultatet e studimit rezulton se, 53.4% e prindërve të intervistuar asnjëherë nuk janë të kënaqur, 15.5% deklarojnë ndonjëherë dhe vetëm 31% e prindërve deklaruan që gjithmonë janë të kënaqur. Nga rezultatet e studimit vihet re se, në të gjitha kopshtet e tjera të rikonstruktuara dy vitet e fundit, perceptimi i prindërve në lidhje me mjaftueshmërinë e hapësirës për të hyrë në ambientin pritës të fëmijës së tyre mbetet i lartë. Më të detajuara këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme.

| Njësia | Kopshti Nr. | Gjithmonë | Ndon-jëherë | Rrallë | Asnjëherë | Nuk e di |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Njësia 11** | 70 | 51(86.4)* | 6(10.2) | 2(3.4) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 28 | 28(87.5) | 4(12.5) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 9** | 36 | 28(82.4) | 6(17.6) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 8** | 6 | 13(38.2) | 16(47.1) | 1(2.9) | 4(11.8) | 0(0.0) |
| | 19 | 17(56.7) | 9(34.6) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0 (0.0) |
| **Njësia 4** | 27A | 13(43.3) | 11(36.7) | 5(16.7) | 1(3.3) | 0(0.0) |
| | 25A | 35(74.5) | 8(17.0) | 1(2.1) | 2(6.5) | 0(0.0) |
| | 51 | 31(96.9) | 1(3.1) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 39 | 22(75.9) | 5(17.2) | 1(3.4) | 1(3.4) | 0(0.0) |
| **Njësia 1** | 56 | 24(80.0) | 5(16.7) | 1(3.3) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 24 | 25(80.6) | 3(9.7) | 1(3.2) | 2(6.5) | 0(0.0) |
| **Njësia 2** | Sauk i vjetër (71) | 0(0.0) | 11(36.7) | 6(20.0) | 13(43.3) | 0(0.0) |
| **Njësia 5** | 11 | 19(73.1) | 6(23.1) | 0(0.0) | 1(3.8) | 0(0.0) |
| | 31 | 25(86.2 | 3(10.3) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 42 | 19(65.5) | 10(34.5) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 52 | 25(80.6) | 6(19.4) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 7** | Xixëllon-ja(72) | 22(78.6) | 6(21.4) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 2 | 18(69.2) | 6(23.1) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 26 | 18(31.0) | 9(15.5) | 0(0.0) | 31(53.4) | 0(0.0) |
| **Njësia 10** | 8 | 17(54.8) | 14(45.2) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 6** | 21 | 27(93.1) | 2(6.9) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 38 | 19(63.3) | 11(36.7) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |

*Numrat absolute dhe përqindjet në kllapa

*Tabela 1.11.6: Shpërndarja e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për mjaftueshmërinë e hapësirës për të hyrë në ambientin pritës të fëmijës së tyre.*

**Tabela 1.11.7** paraqet shpërndarjen e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për ngrohjen në ambientet e brendshme të kopshtit në dimër, ku, nga rezultatet e studimit, konkludon se niveli i kënaqësisë së prindërve mbetet i ulët në kopshtin nr. 71. Këtu rezulton që, 46.7% e prindërve të intervistuar janë rrallë të kënaqur, 10% deklarojnë se ndonjëherë janë të kënaqur dhe vetëm 40% e prindërve janë gjithmonë të kënaqur. Nga rezultatet e studimit vihet re se, në të gjitha kopshtet e tjera të rikonstruktuara dy vitet e fundit, niveli i kënaqësisë së prindërve mbetet i lartë. Më të detajuara këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme.

| Njësia | Kopshti Nr. | Gjithmonë | Ndon-jëherë | Rrallë | Asn-jëherë | Nuk e di |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Njësia 11** | 70 | 53(89.8)* | 3(5.1) | 3(5.1) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 28 | 24(82.8) | 3(10.3) | 1(3.4) | 1(3.4) | 0(0.0) |
| **Njësia 9** | 36 | 29(90.6) | 2(6.3) | 0(0.0) | 1(3.1) | 0(0.0) |
| **Njësia 8** | 6 | 25(73.5) | 7(23.3) | 0(0.0) | 1(3.3) | 0(0.0) |
| | 19 | 25(100) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 4** | 27A | 29(96.7) | 1(3.3) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 25A | 39(86.7) | 4(.9) | 0(0.0) | 2(4.4) | 0(0.0) |
| | 51 | 18(56.3) | 13(40.6) | 1(3.1) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 39 | 20(69.0) | 5(17.2) | 1(3.4) | 3(10.3) | 0(0.0) |
| **Njësia 3** | 20 | 21(100) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 1** | 56 | 23(79.3) | 4(13.8) | 1(3.4) | 1(3.4) | 0(0.0) |
| | 24 | 26(89.7) | 3(10.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 2** | Sauk i vjetër (71) | 12(40.0) | 3(10.0) | 14(46.7) | 1(3.3) | 0(0.0) |
| **Njësia 5** | 11 | 23(76.6) | 6(20.0) | 0(0.0) | 1(3.3) | 0(0.0) |
| | 31 | 23(76.7) | 4(13.8) | 0(0.0) | 2(6.9) | 0(0.0) |
| | 42 | 15(51.7) | 14(48.3) | 0(0.0) | 1(3.8) | 0(0.0) |
| | 52 | 25(80.6) | 4(12.9) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 7** | Xixëllon-ja(72) | 26(92.9) | 2(7.1) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 2 | 21(80.8) | 3(11.5) | 1(3.8) | 1(3.8) | 0(0.0) |
| | 26 | 40(66.7) | 16(26.7) | 0(0.0) | 4(6.7) | 0(0.0) |
| **Njësia 10** | 8 | 21(67.7) | 8(25.8) | 0(0.0) | 2(6.5) | 0(0.0) |
| **Njësia 6** | 21 | 25(86.2) | 1(3.4) | 1(3.4) | 2(6.9) | 0(0.0) |
| | 38 | 26(86.7) | 3(10.0) | 0(0.0) | 1(3.3) | 0(0.0) |

**Numrat absolute dhe përqindjet në kllapa*

*Tabela 1.11.7: Shpërndarjen e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për ngrohjen e ambienteve të brendshme të kopshtit në dimër.*

**Tabela 1.11.8** paraqet shpërndarjen e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për mungesën e dritave në kopshtet e fëmijëve të tyre. Nga rezultatet e studimit konkludon se, në të gjitha kopshtet e rikonstruktuara dy vitet e fundit, perceptimi i prindërve në lidhje me mungesën e dritave në kopshtet e fëmijëve të tyre mbetet i ulët. Këto të dhëna paraqiten më të detajuara në tabelën e mëposhtme.

| Njësia | Kopshti Nr. | Gjith-monë | Ndon-jëherë | Rrallë | Asn-jëherë | Nuk e di |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Njësia 11** | 70 | 0(0.0)* | 0(0.0) | 4(26.7) | 11(73.3) | 0(0.0) |
| | 28 | 0(0.0) | 3(33.3) | 0(0.0) | 5(55.6) | 0(0.0) |
| **Njësia 9** | 36 | 3(14.3) | 1(4.8) | 1(4.8) | 16(76.2) | 0(0.0) |
| **Njësia 8** | 6 | 0(0.0) | 1(5.6) | 2(11.1) | 15(83.3) | 0(0.0) |
| | 19 | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 9(100) | 0(0.0) |
| **Njësia 4** | 27A | 1(14.3) | 0(0.0) | 0(0.0) | 6(85.7) | 0(0.0) |
| | 25A | 2(8.0) | 1(4.0) | 2(8.0) | 20(80.0) | 0(0.0) |
| | 51 | 1(6.7) | 5(33.3) | 1(6.7) | 8(53.3) | 0(0.0) |
| | 39 | 0(0.0) | 3(30.0) | 1(10.0) | 6(60.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 3** | 20 | 1(7.1) | 2(14.3) | 3(21.4) | 8(57.1) | 0(0.0) |
| **Njësia 1** | 56 | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 8(100) | 0(0.0) |
| | 24 | 0(0.0) | 5(35.7) | 2(14.3) | 6(42.9) | 0(0.0) |
| **Njësia 2** | Sauk i vjetër (71) | 0(0.0) | 4(22.2) | 8(44.4) | 6(33.3) | 0(0.0) |
| **Njësia 5** | 11 | 1(6.7) | 1(6.7) | 0(0.0) | 13(86.7) | 0(0.0) |
| | 31 | 0(0.0) | 10(55.6) | 1(5.6) | 7(38.9) | 0(0.0) |
| | 42 | 0(0.0) | 5(23.8) | 0(0.0) | 16(76.2) | 0(0.0) |
| | 52 | 0(0.0) | 2(15.4) | 1(7.7) | 10(76.9) | 0(0.0) |
| **Njësia 7** | Xixëllon-ja(72) | 4(17.4) | 8(34.8) | 3(13.0) | 8(34.8) | 0(0.0) |
| | 2 | 0(0.0) | 7(36.8) | 1(5.3) | 11(57.9) | 0(0.0) |
| | 26 | 0(0.0) | 12(28.6) | 15(35.7) | 15(35.7) | 0(0.0) |
| **Njësia 10** | 8 | 1(7.7) | 4(30.8) | 0(0.0) | 8(61.5) | 0(0.0) |
| **Njësia 6** | 21 | 1(3.8) | 0(0.0) | 3(11.5) | 22(84.6) | 0(0.0) |
| | 38 | 1(16.7) | 2(33.3) | 0(0.0) | 2(33.3) | 0(0.0) |

**Numrat absolute dhe përqindjet në kllapa*

*Tabela 1.11.8 Shpërndarjen e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për mungesën e dritave në kopshtet e fëmijëve të tyre.*

**Tabela 1.11.9** paraqet shpërndarjen e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për mungesën e ujit të rrjedhshëm (të ngrohtë /të ftohtë) gjatë gjithë kohës në kopshtet e fëmijëve të tyre. Nga rezultatet e studimit konkludon se, vetëm në kopshtin nr. 56 perceptimi i prindërve në lidhje me mungesën e ujit në kopshtet e fëmijëve të tyre mbetet i ulët. Këtu konkludon se, 37.5% e prindërve të intervistuar deklarojnë se mungesa e ujit të rrjedhshëm (të ngrohtë/të ftohtë) është gjithmonë problem, ndërsa 50% e prindërve të intervistuar deklarojnë se asnjëherë nuk është problem. Vihet re se, në të gjitha kopshtet e rikonstruktuara dy vitet e fundit, perceptimi i prindërve në lidhje me mungesën e ujit të rrjedhshëm (të ngrohtë/të ftohtë) gjatë gjithë kohës në kopshtet e fëmijëve të tyre mbetet i ulët. Këto të dhëna paraqiten më të detajuara në tabelën e mëposhtme.

| Njësia | Kopshti Nr. | Gjithmonë | Ndonjëherë | Rrallë | Asnjëherë | Nuk e di |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Njësia 11** | 70 | 0(0.0)* | 2(12.5) | 3(18.8) | 10(62.5) | 0(0.0) |
| | 28 | 0(0.0) | 1(16.7) | 0(0.0) | 5(83.3) | 0(0.0) |
| **Njësia 9** | 36 | 4(16.7) | 1(4.2) | 1(4.2) | 17(70.8) | 0(0.0) |
| **Njësia 8** | 6 | 1(5.6) | 0(0.0) | 2(11.1) | 15(83.3) | 0(0.0) |
| | 19 | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 10(100) | 0(0.0) |
| **Njësia 4** | 27A | 2(25.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 4(50.0) | 2(25.0) |
| | 25A | 2(9.5) | 1(9.1) | 0(0.0) | 16(76.2) | 0(0.0) |
| | 51 | 1(8.3) | 5(41.7) | 2(16.7) | 4(33.3) | 0(0.0) |
| | 39 | 0(0.0) | 0(0.0) | 1(12.5) | 7(87.5) | 0(0.0) |
| **Njësia 3** | 20 | 0(0.0) | 1(7.7) | 2(15.4) | 10(76.9) | 0(0.0) |
| **Njësia 1** | 56 | 3(37.5) | 0(0.0) | 0(0.0) | 4(50.0) | 0(0.0) |
| | 24 | 3(27.3) | 1(9.1) | 0(0.0) | 7(63.6) | 0(0.0) |
| **Njësia 2** | Sauk i vjetër (71) | 0(0.0) | 4(22.2) | 8(44.4) | 6(33.3) | 0(0.0) |
| **Njësia 5** | 11 | 2(11.8) | 4(23.5) | 0(0.0) | 11(64.7) | 0(0.0) |
| | 31 | 1(8.3) | 2(16.7) | 0(0.0) | 9(75.0) | 0(0.0) |
| | 42 | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 9(100) | 0(0.0) |
| | 52 | 1(8.3) | 5(41.7) | 2(16.7) | 4(33.3) | 0(0.0) |
| **Njësia 7** | Xixëllonja(72) | 4(17.4) | 7(30.4) | 0(0.0) | 11(47.8) | 0(0.0) |
| | 2 | 3(17.6) | 2(11.8) | 0(0.0) | 11(64.7) | 0(0.0) |
| | 26 | 2(5.9) | 13(38.2) | 4(11.8) | 15(44.1) | 0(0.0) |
| **Njësia 10** | 8 | 0(0.0) | 2(18.2) | 0(0.0) | 9(81.8) | 0(0.0) |
| **Njësia 6** | 21 | 0(0.0) | 1(4.3) | 1(4.3) | 21(91.3) | 0(0.0) |
| | 38 | 0(0.0) | 1(25.0) | 0(0.0) | 3(75.0) | 0(0.0) |

**Numrat absolute dhe përqindjet në kllapa*

*Tabela 1.11.9: Shpërndarja e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me perceptimin e prindërve për mungesën e ujit të rrjedhshëm (të ngrohtë/të ftohtë) gjatë gjithë kohës në kopshtet e fëmijëve të tyre.*

**Tabela 1.12** paraqet shpërndarjen e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me kontribuimin e prindërve. Nga rezultatet e studimit, rezulton se në të gjitha kopshtet, gatishmëria e prindërve për të kontribuar në kopshtin e fëmijës së tyre mbetet e lartë. Më të detajuara këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme.

| Njësia | Kopshti Nr. | Gjithmonë | Ndonjëherë | Rrallë | Asnjëherë | Nuk e di |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Njësia 11** | 70 | 41(73.2)* | 8(14.3) | 0(0.0) | 4(7.1) | 3(5.4) |
| | 28 | 27(84.4) | 5(15.6) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 9** | 36 | 21(63.6) | 8(24.2) | 1(3.0) | 3(9.1) | 0(0.0) |
| **Njësia 8** | 6 | 15(44.1) | 16(47.1) | 0(0,0) | 2(5.9) | 1(2.9) |
| | 19 | 15(57.7) | 11(42.3) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 4** | 27A | 0(0.0) | 27(90.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 3(10.0) |
| | 25A | 30(68.2) | 4(9.1) | 1(2.3) | 9(20.5) | 0(0.0) |
| | 51 | 10(31.3) | 18(56.3) | 0(0.0) | 2(6.3) | 2(6.3) |
| | 39 | 15(53.6) | 10(35.7) | 0(0.0) | 3(10.7) | 0(0.0) |
| **Njësia 3** | 20 | 16(76.2) | 4(19.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 1(4.8) |
| **Njësia 1** | 56 | 22(73.3) | 5(16.7) | 0(0.00 | 3(10.0) | 0(0.0) |
| | 24 | 14(46.7) | 11(36.7) | 1(3.3) | 4(13.3) | 0(0.0) |
| **Njësia 2** | Sauk i vjetër (71) | 30(100) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 5** | 11 | 10(34.5) | 10(34.5) | 6(20.7) | 3(10.3) | 0(0.0) |
| | 31 | 20(71.4) | 4(14.3) | 0(0.0) | 4(14.3) | 0(0.0) |
| | 42 | 14(48.3) | 15(51.7) | 0(0.0) | 0(0.0) | 0(0.0) |
| | 52 | 26(86.7) | 3(10.0) | 0(0.0) | 0(0.0) | 1(3.3) |
| **Njësia 7** | Xixëllonja(72) | 7(25.9) | 18(66.7) | 0(0.0) | 2(7.4) | 0(0.0) |
| | 2 | 20(80.0) | 3(12.0) | 0(0.0) | 2(8.0) | 0(0.0) |
| | 26 | 31(51.7) | 20(33.3) | 0(0.0) | 9(15.0) | 0(0.0) |
| **Njësia 10** | 8 | 17(54.8) | 10(32.3) | 0(0.0) | 3(9.7) | 0(0.0) |
| **Njësia 6** | 21 | 22(75.9) | 1(3.4) | 0(0.0) | 6(20.7) | 0(0.0) |
| | 38 | 20(64.5) | 7(22.6) | 0(0.0) | 4(12.9) | 0(0.0) |

**Numrat absolute dhe përqindjet në kllapa*

*Tabela 1.12 Shpërndarja e kopshteve të rikonstruktuara dy vitet e fundit, në lidhje me kontribuimin e prindërve për kopshtin e fëmijës së tyre.*

## 2.3.5 Diskutim mbi rezultatet

### Faktorët socio-ekonomik

Rezultatet e këtij studimi treguan se, rreth 3.07% e prindërve ishin me arsim të ulët,16.17% me arsim tetëvjeçar, 40.15% me arsim të mesëm, 39% me arsim të lartë dhe rreth 1.15% e prindërve ishin me arsim pasuniversitar.

Për sa i përket nivelit ekonomik përkatës të familjeve të fëmijëve që u përfshinë në studim, vihet re që pjesa më e madhe e tyre, pra 80.47% kishin nivel ekonomik mesatar, krahasuar me 15.47% të cilët raportuan nivel të ulët ekonomik dhe 2.76% kishin nivel ekonomik të lartë, ndërsa 1.3% refuzuan të përgjigjen.

Në lidhje me punësimin, 44.63% e prindërve që morën pjesë në studim deklaruan se ishin të punësuar në sektorin privat, 19.62% në sektorin shtetëror, rreth 28.37% punësim tjetër, ndërsa 7.35% refuzuan të përgjigjen.

### Faktorët demografikë

Rezultatet e këtij studimi treguan se, rreth 38.13% e fëmijëve ishin të grupmoshës 3-4 vjeç, 35.38% ishin të grupmoshës 4-5 vjeç dhe rreth 26.49% ishin të grupmoshës 5-6 vjeç.

### Aksesi në shërbimin shëndetësor

Rezultatet e këtij studimi treguan se, 55.67% e fëmijëve e marrin gjithmonë kujdesin shëndetësor, 14.78% ndonjëherë, 3.13% rrallë dhe rreth 8.04% asnjëherë, ndërsa 18,38 u përgjigjen nuk e di.

Në lidhje me mbështetjen që jep puna e psikologut, 40.69% deklarojnë gjithmonë, 8.74% ndonjëherë, 3.14% rrallë dhe rreth 7.96% asnjëherë, ndërsa 39.47% u përgjigjën nuk e di.

Nëse fëmija është me aftësi të kufizuara lëvizëse, 1.3% e prindërve u përgjigjen me po dhe rreth 98.7% me jo.

### Hapësira e ambienteve të brendshme të kopshteve

Rezultatet e studimit treguan se, 34.84% e prindërve deklaruan se kanë gjithmonë lehtësira për të hyrë ne ambientet e brendshme të kopshteve, 6.89% deklarojnë ndonjëherë, 5.28% rrallë, 11.03% asnjëherë dhe rreth 41.96% u përgjigjen nuk e di.

Në lidhje me mjaftueshmërinë për të hyrë në ambientet pritëse, 65.85% e prindërve deklarojnë se hapësira është gjithmonë e mjaftueshme, 20.92% deklarojnë ndonjëherë, 2.98% rrallë, 9.03% asnjëherë dhe rreth 1.22 u përgjigjen nuk e di.

### Facilitetet e brendshme

Rezultatet e studimit treguan se, 75.65% e prindërve deklaruan se ishin gjithmonë të kënaqur me ngrohjen e ambienteve të brendshme, 14.78% deklarojnë ndonjëherë, 2.37% rrallë, 5.59% jo, asnjëherë dhe rreth 1.61 u përgjigjen nuk e di.

Lidhur me mungesën e dritave në kopshte, 3.06% e prindërve deklarojnë se ka pasur gjithmonë mungesë, 11.72% deklarojnë ndonjëherë, 5.74% rrallë, 29.79% asnjëherë dhe rreth 49.69% u përgjigjen nuk e di.

Në lidhje me mungesën e ujit të ngrohtë dhe të ftohtë gjatë gjithë kohës, 3.98% deklarojnë se ka pasur gjithmonë mungesë, 7.04% deklarojnë ndonjëherë, 4.29% rrallë, 30.02% asnjëherë dhe rreth 54.67% u përgjigjën nuk e di.

# Higjiena

Rezultatet e studimit treguan se, në lidhje me pastërtinë e ambienteve të brendshme, 92.12% e prindërve deklaruan se gjithmonë janë të pastra, 3.98% deklarojnë ndonjëherë, 0.69% rrallë, 0.84% asnjëherë dhe rreth 2.37% u përgjigjën nuk e di.

Në lidhje me pastërtinë e ambienteve të jashtme, 90.66% e prindërve deklaruan që gjithmonë janë të pastra, 6.13% deklaruan ndonjëherë, 1.15% rrallë dhe rreth 1.45% asnjëherë, ndërsa 0.61% u përgjigjën nuk e di.

Për sa i përket higjienës së tualeteve, kuzhinave, klasave, rezultatet e studimit treguan se, 82.47% e prindërve deklaruan se gjithmonë janë higjienike, 6.58% deklaruan ndonjëherë, 0.69% rrallë dhe rreth 1.15% asnjëherë, ndërsa 9.11% u përgjigjën nuk e di.

# Kontributi

Rezultatet e studimit treguan se, 60.95% e prindërve deklaruan se kontribuojnë gjithmonë për kopshtin e fëmijëve të tyre, 25.96% deklarojnë ndonjëherë, 1.15% rrallë dhe rreth 9.80% asnjëherë, ndërsa 2.14% u përgjigjën nuk e di.

Në lidhje me formën e kontribuimit, 38.36% e prindërve deklaruan se kontribuojnë me para, 10.18% deklarojnë me dhurata, 47.17% me objekte dhe suplemente të higjienës, 3.45% me ide dhe rreth 0.84% deklaruan forma të tjera.

## 2.3.6 Konkluzione

Në përfundim të këtij studimi, duke u bazuar në të dhënat e mara nga rezultatet dhe krahasimit të tyre me të dhënat e literaturës në studime të ngjashme nga autorë të ndryshëm, mund të nxjerrim këto konkluzione:

1. Kopshtet publike duhet të vlerësohen përtej një shërbimi të kujdesit të fëmijëve, si pika referimi komunitare për mirërritjen e brezave, këshillimin prindëror, referimin në zinxhirin mbrojtës të fëmijëve dhe mund të shërbejnë si pika hyrje për shërbime të tjera të ofruara nga Bashkia.

2. Ofrimi i shërbimeve duhet të ngrihet mbi standarde për të siguruar cilësi të shërbimeve.

3. Rezultatet e këtij studimi konfirmuan lidhjen statistikisht të rëndësishme midis nivelit ekonomik dhe kontribuimit të prindërve në kopshtin e fëmijës së tyre.

4. Gjithashtu, rezultatet e këtij studimi treguan lidhje statistikisht të rëndësishme midis arsimimit të prindërve dhe mbështetjes që i jep puna e psikologut fëmijës suaj.

5. Prindërit nuk kanë informacionin e nevojshëm mbi higjienën dhe kujdesin e duhur shëndetësor për fëmijët e tyre.

6. Në kopshtet e qytetit të Tiranës, asnjë mjek nga Autoriteti Shëndetësor Rajonal i Tiranës nuk është paraqitur për një periudhë kohe shumë të gjatë.

7. Për fëmijët e moshës parashkollore, të cilët jetojnë në familje me nivel ekonomik të ulët, nuk ofrohen mundësi për të pasur akses më të madh në shërbimin shëndetësor.

8. Në kopshtet e qytetit të Tiranës psikologu mungon për një kohë të gjatë, konkretisht në kopshtet nr.56, kopshtin Kodër Kamëz dhe kopshtin Shkozë psikologu mungonte prej më shumë se 6 muajsh.

9. Ndërhyrja e Bashkisë për rikonstruksion në disa kopshte është një nevojë emergjente për arritjen e standardeve dhe ruajtjen e shëndetit të fëmijëve.

# ANEKS

PYETËSORI

# Pyetësori

Ky pyetësor kryhet në kuadër të një studimi socio-demografik që realizohet nga Shoqata "Together for life", i cili ka për synim monitorimin e 44 kopshteve të Tiranës në lidhje me respektimin e standarteve të infrastrukturës fizike, sigurisë, higjienës si dhe kapacitetit pritës të tyre. Opinioni juaj si prindër është me shumë rëndësi për të plotësuar kuadrin e të dhënave të këtij monitorimi. Informacioni nga kjo bisedë do të mbetet tërësisht anonim dhe konfidencial.

ID Pyetësorit
Data

Kopshti nr.

1. Mosha e fëmijës

2. Seksi M/F

**3. Emri i prindit/kujdestarit** **Tel:**

**4. Arsimimi i prindit/kujdestarit.**
1. Arsimim i ulët
2. Arsimim tetëvjeçar
3. Arsimim i mesëm
4. Arsimim i lartë
5. Arsimim pasuniversitar

**5. Jeni të punësuar**
1. Sektorin privat
2. Sektorin shtetëror
88. Tjetër
99. Refuzon

**6. Niveli ekonomik:** krahasuar me familjet e tjera shqiptare, mendoni se familja juaj ka një nivel ekonomik:
1.Më të ulët
2.Pothuajse njëlloj
3.Më të lartë
99. Refuzon

**7. Në cilën klasë/grupmoshë është fëmija juaj?**
a. 3-4 vjeç
b. 4-5 vjeç
c. 5-6 vjeç

**8. A keni pasur vështirësi në pranimin e fëmijës suaj në kopsht?**

1. Po, për shkak të mungesës së kopshteve në zonën tonë të banimit
2. Po, sepse kam qenë në listë pritje
3. Po, sepse sistemi i pranimit nuk është i drejtë dhe transparent
4. Jo, nuk kam hasur vështirësi

**9. Sa edukatore ka fëmija juaj?**

1. 1
2. 2

88. Nuk e di

**10. Mendoni se fëmija juaj merr kujdesin e duhur shëndetësor në kopsht?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Asnjëherë

88. Nuk e di

**11. A mendoni se puna e psikologut i jep mbështetjen e duhur fëmijës suaj?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Asnjëherë

88. Nuk e di

**12. A është fëmija juaj me aftësi të kufizuara lëvizëse?**

1. Po
2. Jo

**13. A është kopshti i pajisur me rampa dhe lehtësitë e nevojshme për lehtësimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara lëvizëse?**

1. Po
2. Jo

88. Nuk e di

**14. E keni të lehtë të hyni nga jashtë në ambientet e brendshme të kopshtit me karrocën e fëmijës suaj?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Asnjëherë

88. Nuk e di

**15. A është e mjaftueshme hapësira për të hyrë në ambientin pritës të fëmijëve?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë

4. Asnjëherë
88. Nuk e di

**16. A jeni të kënaqur me ngrohjen e ambienteve të brendshme të kopshtit në dimër?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Jo, asnjëherë
88. Nuk e di

**17. A janë ambientet e brendshme të freskëta gjatë ditëve të nxehta?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Asnjëherë
88. Nuk e di

**18. A ka ndodhur që në kopsht të mos ketë pasur drita?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Asnjëherë
88. Nuk e di

**19. A ka ndodhur që kopshti të mos ketë ujë të rrjedhshëm (të ngrohtë/ të ftohtë) gjatë gjithë kohës?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Asnjëherë
88. Nuk e di

**20. A e gjeni ambientin e brendshëm të pastruar kur vini në mëngjes për të sjellë fëmijën tuaj?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Asnjëherë
88. Nuk e di

**21. A është ambienti i jashtëm i pastruar?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Asnjëherë
88. Nuk e di

**22. A janë higjienike dhe të pastra ambientet e brendshme të kopshtit (tualetet, kuzhina, klasat, etj)?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Asnjëherë
88. Nuk e di

**23. Cilat aspekte janë më të rëndësishmet për ju** (mund të zgjidhen disa alternativa):

1. Numri i fëmijëve në grup
2. Higjiena e ambienteve të brendshme
3. Kushtet fizike dhe mobilimi i ambienteve të brendshme
4. Hapësira e jashtme për zbavitjen e fëmijëve
5. Siguria e kopshtit ndaj fenomeneve të ndryshme dhe sistemi i evakuimit në rast rreziku
6. Të gjitha më sipër

**26. A keni kontribuar në kopshtin e fëmijës suaj?**

1. Gjithmonë
2. Ndonjëherë
3. Rrallë
4. Asnjëherë
88. Nuk e di

**27. Në cilat forma kontribuoni?**

1. Me para
2. Me dhurata
3. Me objekte dhe suplemente të higjienës
4. Me ide
99. Tjetër (specifiko)

**Faleminderit për bashkëpunimin!**

KAPITULLI 3

# FORUMET KOMUNITARE



## 3. FORUMET KOMUNITARE

Të gjitha problemet e evidentuara nga monitorimi fizik i ambienteve të kopshteve të qytetit të Tiranës dhe nga anketimi i prindërve, janë diskutuar në formë forumesh të hapura me disa palë interesi, siç janë përfaqësues të kopshteve të ndryshme, përfaqësues të Këshillit Bashkiak, prindër, organizata Lëviz Albania dhe moderatorët e këtyre forumeve nga shoqata "Togerther for Life".

Qëllimi final është konfirmimi i rëndësisë së gjetjeve të monitorimit dhe anketimit me disa grupe interesi, ku qëllimi final dhe i përbashkët është përmirësimi i kushteve të ofruara për mirërritjen e brezave të rinj.

## 3.1 Forumi i parë komunitar

### *"Lëviz për kopshtin tim", njësia bashkiake nr. 3*

### *Kopshtet e njësisë 3*

- *Kopshti nr.60*
- *Kopshti nr. 20*
- *Kopshti nr.1*
- *Kopshti nr. 29*
- *Kopshti nr.22*

### *Pjesëmarrës:*

- Ergresta Nika, administratore e njësisë nr. 3
- Mateo Spaho, përfaqësues i Këshillit Bashkiak
- Floida Kërpaci, përfaqësuese e Këshillit Bashkiak
- Dorina Kuka, përfaqësuese e Këshillit Bashkiak
- Nashide Shehapi, drejtoreshë e kopshtit nr. 1
- Altina Brokaj, drejtoreshë e kopshtit nr. 60
- Miranda Kokona, drejtoreshë e kopshtit nr. 20
- Remzie Dobrovoda, drejtoreshë e kopshtit nr. 22
- Anila Kukaviqi, drejtoreshë e kopshtit nr. 29
- Prindër të fëmijëve dhe të interesuar të tjerë

### Diskutime:

**Arlinda Gjypi, menaxhere projektesh, shoqata 'Together for Life'**

Si fillim dua t'ju falënderoj të gjithëve që jeni të pranishëm sot këtu. Shpresoj që ky takim, i cili do të ndiqet edhe nga 4 forume të tjera në komunitetin e Tiranës, të jetë frytdhënës, në mënyrë që në fund të këtij procesi ne të mund të shkojmë në Bashkinë e Tiranës dhe t'i paraqesim këto probleme, ashtu si duken në këndvështrimin tuaj si prind.

Për të gjithë që nuk më njohin, unë jam Arlinda dhe punoj në shoqatën "Together for Life" si menaxhere e programeve, dhe drejtoj këtë projekt që mbështetet nga "Lëviz Albania". Me vjen keq që ndoshta prezantimi i shkurtër që unë kam bërë nuk mund të përcjellë atë që duhet. Qëllimi i projektit "Lëviz për Kopshtin tim" është monitorimi i infrastrukturës dhe investimeve të 43 kopshteve publike të Tiranës, me qëllim informimin e qytetarëve dhe medias për të nxitur përgjegjshmërinë dhe transparencën e pushtetit vendor për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në kopshtet e Bashkisë së Tiranës.

Ky është një projekt i zbatuar nga shoqata "Together for life", me mbështetjen e Lëviz Al-

bania. Sot kemi përfaqësues nga 5 kopshtet e njësisë numër 3, prindër, edukatorë, mjekë, si dhe përfaqësues nga Këshilli Bashkiak e nga shoqëria civile. Fotoja që unë kam zgjedhur të shfaq në ekran është foto e tavolinave me kënde të prishura. Disa nga përfundimet që ne kemi nxjerrë janë:

Në grupet e dyta vihet re fenomeni i mbi-kapaciteteve të hapësirave. Në 89% të kopshteve të monitoruara (nga të cilat 24 janë të nismës "Adopto një kopsht"), prej të cilave u morën informacione të sakta dhe të plota, vihet re një numër fëmijësh për grup përtej normave të këshilluara për mirërritjen e tyre.

Për të tri nivelet e grupeve në kopshtet e vëzhguara, vihet re numri i ulët i edukatoreve në raport me numrin e fëmijëve.

Sipas Standardeve të Projektimit të Kopshteve, 1 kopsht duhet të ketë edhe një dhomë infermierie edhe një zyrë psikologu. Në rastin tonë, gjatë monitorimit u konstatua se vetëm 13 kopshte, nga 41, kanë njërën nga këto dy dhoma. Kryesisht bëhet fjalë për infermierinë. Kopshtet e tjera nuk kanë asnjërën prej tyre. Lidhur me kopshtet e nismës "Adopto një kopsht", vetëm 7 kopshte kanë dhomën e infermierisë. Tre prej këtyre 7 kopshteve e përdorin këtë dhomë edhe për shërbimet e psikologut.

Shërbimet higjienike për prindërit apo të rritur të tjerë që vijnë vizitojnë kopshtet janë vetëm për 12, nga 41 kopshtet e marra në monitorim (nga të cilat 21 kopshte që nuk kanë shërbime higjienike janë të nismës "Adopto një kopsht").

Kopshte të cilave u mungon kuzhina kryesore janë 19%. Janë vetëm 15 kopshte që kanë aneks ku mund të përgatitet shpërndarja e ushqimit, nga të cilat 13 janë të nismës "Adopto një kopsht".

24% e kopshteve të qytetit të Tiranës (nga të cilat 9 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") kanë vetëm ngrohje për mbajtjen e temperaturës konstante në ambientet e tyre.

Fëmijët e 7 prej kopshteve të monitoruara (nga të cilat nuk ka të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë në ambientet e tyre as ngrohje e as ftohje.

15% e kopshteve të qytetit të Tiranës (nga të cilat 2 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë ujë të ngrohtë dhe të ftohtë pa ndërprerje. Vlen të theksohet se kopshti nr. 34 nuk ka ujë të ngrohtë.

Po ashtu, siç vihet re edhe në Aneks 5, 6 kopshte (nga të cilat 1 është i nismës "Adopto një kopsht"), që përbëjnë 14.3% të kopshteve të monitoruara, nuk kanë depozitë uji për të siguruar vazhdimësi në higjienën e fëmijëve dhe të vetë institucionit.

13 nga 41 kopshtet e monitoruara (nga të cilat 3 kopshte janë të nismës Adopto një kopsht) nuk kanë lodra në ambientet e tyre të jashtme për fëmijët. 4 kopshte të tjera (nga të cilat 2 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") kanë lodra të pamjaftueshme për numrin e fëmijëve të pranishëm në institucion. Është e rëndësishme të theksohet se kopshti nr. 64 "Xixëllonjat" , Kopshti "Bregu i Lumit", (pjesë e nismës Adopto një kopsht) kanë lodra që nuk janë të përshtatshme për fëmijët në këto grupmosha, duke cenuar sigurinë e tyre.

92.7% e kopshteve i kanë dyert që hapen në drejtimin "Brenda - Jashtë", duke vështirësuar daljet sa më emergjente në situate zjarri. 8.04% asnjëherë, ndërsa 18,38 u përgjigjen nuk e di.

Në lidhje me mbështetjen që jep puna e psikologut, 40.69% deklarojnë gjithmonë, 8.74% ndonjëherë, 3.14% rrallë dhe rreth 7.96% asnjëherë, ndërsa 39.47% u përgjigjën nuk e di.

34.84% e prindërve deklaruan se kanë gjithmonë lehtësira për të hyrë ne ambientet e brendshme të kopshteve, 6.89% deklarojnë ndonjëherë, 5.28% rrallë, 11.03% asnjëherë dhe rreth 41.96% u përgjigjën nuk e di.

75.65% e prindërve deklaruan se ishin gjithmonë të kënaqur me ngrohjen e ambienteve të

brendshme, 14.78% deklarojnë ndonjëherë, 2.37% rrallë, 5.59% jo, asnjëherë dhe rreth 1.61 u përgjigjen nuk e di.

Mungesa e dritave në kopshte: 3.06% e prindërve deklarojnë se ka pasur gjithmonë mungesë, 11.72% deklarojnë ndonjëherë, 5.74% rrallë, 29.79% asnjëherë dhe rreth 49.69% u përgjigjen nuk e di.

Mungesa e ujit të ngrohtë dhe të ftohtë gjatë gjithë kohës: 3.98% deklarojnë se ka pasur gjithmonë mungesë, 7.04% deklarojnë ndonjëherë, 4.29% rrallë, 30.02% asnjëherë dhe rreth 54.67% u përgjigjën nuk e di.

**Miranda Kokona, drejtoreshë e kopshtit nr. 20**

Kopshti që unë drejtoj ka qenë në kushte skandaloze. Tani që është bërë i ri, situata ka ndryshuar, kushtet janë të mira. Problem të cilin unë vë re është pjesa e lojërave në oborrin e kopshtit. Mund të them se janë të rrezikshme për fëmijët. Do ishte mirë të tregohej më shumë kujdes në lidhje me këtë pjesë, pasi jemi gjatë gjithë kohës të shqetësuar për fëmijët mos rrëzohen ose mos përplasen me ndonjë nga lodrat. Nëse do të mund të ndërhyhej për këtë pjesë, do të ishte diçka shumë e mirë. Numri i fëmijëve që frekuentojnë kopshtin është i lartë, por kjo gjë nuk është në dorën tonë.

**Arlinda**

Numri i kopshteve është i njëjtë me atë që ka qenë para viteve '90?

**Nashide Shehapi, drejtoreshë e kopshtit nr. 1**

Jo, është më i vogël. Kanë qenë 60 kopshte, tani kanë shkuar në 43. I bie që numri i nxënësve të jetë rritur, ndërsa numri i kopshteve është ulur.

Kemi nevojë për shoqërues për fëmijët me probleme. Unë në kopshtin tim kam 4 fëmijë të sëmurë dhe nuk ia dal dot. Kur them të sëmurë, përfshihen fëmijët me nevoja të veçanta, me sindromën down, autizëm, të cilët kanë nevojë për një mësues ndihmës. Është e nevojshme të bëhen tavolina të reja, pasi ato që janë tek mensa janë të konsumuara. Kam 2 grupe të vogla me 35 fëmijë , ndërkohë që standardi është 25 fëmijë. Çdo grup ka 2 edukatore. Rikonstruksioni i kopshtit është bërë mirë, përveç këtyre problematikave që përmenda. Duhet të vendoset program për fëmijët parashkollorë. Ka shumë prindër që thonë nuk e çoj në parashkollor sepse mbaron shkollë në 11 dhe nuk kam ku ta lë. Kjo nuk më duket serioze. Në ambientet e kopshtit ka gjithashtu lagështi në mure, myk, si dhe mbikëqyrja nuk është shumë e mirë, pasi më janë vjedhur rrjetat dhe stolat e kopshtit.

**Anila Kukaviqi, drejtoreshë e kopshtit nr. 29**

Standardi në lidhje me metrat katror që duhet të ketë një fëmijë na ka ardhur nga Bashkia. Kërkesa që kemi ne për regjistrime është e lartë, por standardi duhet të plotësohet. Kuzhinë pa magazinë keni parë? Është tek kopshti im. Unë në kopshtin tim kam një hapësirë të pashfrytëzuar të cilën mund ta përdorim si magazinë për të mbajtur ushqimet, që mungon në kopsht dhe është shumë e nevojshme. Besojmë se me një fond mund të sistemohet ky problem që na shqetëson, gjë e cila është dhe e mirë për higjienën e kopshtit. Kam 58 metër katror hapësirë që mund të bëhet mensë. Është diçka që duhet të jetë me patjetër. Kosha jashtë për plehrat janë të nevojshme me patjetër gjithashtu. Sigurisht dhe prania e një kondicioneri do të ishte gjë e mirë, pasi në muajt e nxehtë fëmijët djersitin shumë ndërkohë që luajnë.

**Miranda Kokona, drejtoreshë e kopshtit nr. 20**

Problemi që do doja të shtroja unë janë krevatet të cilat nuk janë të mjaftueshme për numrin e fëmijëve në kopsht. Në shumë kopshte përdoren dhe krevatet portativë, që janë shumë komodë dhe të rehatshëm për fëmijët, sepse supozohet që pushimi i drekës është më shumë koha e qetësisë se sa koha e gjumit. Numri i ulët i kopshteve, numri i lartë i nxënësve, mungesa e një mësuesi ndihmës dhe mungesa e njohjes së standardeve, krevatet e ngjitur me njëri-tjetrin, janë disa probleme të tjera të cilat duhet të marrin zgjidhje për të mirën e fëmijëve.

**Kryetari i bordit të prindërve, kopshti nr. 20**

Unë kam pasur vajzën, tani kam dhe djalin tek ky kopsht. Mund të them që krevatet janë shumë të ngjitur dhe kjo më shqetëson mua si prind. Nëse standardi thotë që krevatet nuk duhet të jenë ngjitur, atëherë i bie që ky standard nuk po zbatohet.

**Remzie Dobrovoda, drejtoreshë e kopshtit nr. 22**

Në kopshtin që unë drejtoj është i nevojshëm një kondicioner, pasi temperaturat janë shumë të larta. Numri i lartë i fëmijëve është gjithashtu shqetësim. Mund të them se ka mungesë të theksuar të lodrave jashtë dhe brenda ambienteve të kopshtit. Do doja të sugjeroja që fondi të përdoret për të siguruar ndonjë lodër apo mjet didaktik për fëmijët, dhe jo për të paguar rojën. Një mësues zëvendësues do të ishte i nevojshëm.

**Altina Brokaj, drejtoreshë e kopshtit nr. 60**

Unë jam drejtoreshë në kopshtin numër 60, ku ka dalë dhe nga monitorimet që është tepër problematik. Mund të them se mungon gjithçka. Ky kopsht ndodhet në rrugën "Kongresi i Manastirit" në Tiranë, është funksional që prej vitit 1956. Kemi disa vite që jemi në listën e pritjes për t'u bërë pjesë e nismës "Adopto një Kopsht". Na është premtuar një rikonstruktim total nga ana e strukturave përkatëse, por ende nuk kemi asnjë gjë konkrete, ndërkohë që situata vazhdon të jetë alarmante. Ambientet e kopshtit janë vizituar shpesh herë nga persona që premtojnë rregullim dhe rikonstruksion, por asnjëri nga ata nuk ka ndërmarrë një hap konkret, edhe pse ambientet plot lagështi lënë shumë për të dëshiruar. Lagështia është vetëm një nga problemet, ndërkohë që mungesa e ambienteve për lojëra, mungesa e mensës për ta kthyer kopshtin nr. 60 në një kopsht me drekë, ashtu si dhe kopshtet e tjera të zonës. Gjithashtu, mungesa e argëtimit për fëmijët, pasi në oborr nuk ka lojëra, është diçka që më shqetëson. Nuk është vështirë për t'u kuptuar.

Një tjetër pikë e dobët, me të cilën përballem çdo ditë, është edhe numri i lartë i fëmijëve të larguar nga kopshti për shkak të kushteve të vështira. Përveç këtyre, mua më duhet të bëj edhe rolin e edukatores, ndërkohë që nuk i kam kapacitetet për ta bërë diçka të tillë. pasi nuk me del koha të bëj 3 ditë edukatore, 2 ditë drejtoreshën. Kam 150 fëmijë të regjistruar në kopsht dhe realisht nuk më del koha, ndërkohë që në institucione ka nga 7 – 8 vartës. Tavolinat, karriget janë skandal, me cepa. Kam dhe fëmijë autikë, që kërkojnë kujdes të veçantë. Janë bërë gabime në rikonstruksionin e vitit 2000 lidhur me sistemin e termoizolimit, gjë ë cila duhet të ndreqet sa më shpejt. Mos të flas për psikologun dhe mjekun, të cilët nuk janë të pranishëm aq sa duhet në kopsht. Do doja që këto probleme t'i adresoheshin Bashkisë nëpërmjet përfaqësuesve të pushtetit vendor që kemi sot këtu të pranishëm.

**Dorina Kuka/ përfaqësuese e Këshillit Bashkiak (PS)**

Kjo është një luftë për fëmijët tanë dhe ne duhet të jemi më të bashkuar se kurrë për më të

mirën e tyre. Një drejtues i mirë duhet të jetë edhe një menaxher i mirë, prandaj gjithsecili prej nesh duhet të menaxhojë sa më mirë. Lidhur me prezencën e psikologut, do të ishte mirë të ishte i pranishëm në çdo shkollë, jo 1 psikolog për shumë shkolla e kopshte. Edhe roja mos të paguhet nga prindërit por nga shteti.

**Mateo Spaho/ Këshilli Bashkiak**

Pasi dëgjova të gjitha këto probleme dhe, duke qenë se jam dhe vetë prind, mendoj se zgjidhja më e mirë do të ishte të përpilohet një kërkese drejtuar kreut të Këshillit Bashkiak, ku të kërkohet se sa është kostoja për të vendosur kopshtet brenda standardeve, në mënyrë që pastaj të llogaritet fillimi i punës. Të shihen cilat janë kopshtet që kanë nevojë për ndërhyrje dhe të fillohet nga puna menjëherë.

**Floida Kërpaci/ përfaqësuese e Këshillit Bashkiak (LSI)**

Të hartohen draft-propozime për secilin kopsht, për të parë ku mund të ndërhyhet. Këtë çështje mund ta trajtojmë në mbledhjet që organizohen me këshillin, për të rritur investimet për kopshtet. Me votën tonë ne i japim jetë këtyre projekteve, prandaj vazhdoj t'i qëndroj mendimit se një paketë propozimi për secilin kopsht do të ishte një fillim i mirë.



Foto: Pamje nga forumi i parë komunitar.




Foto: Pamje nga forumi i parë komunitar.




Foto: Pamje nga forumi i parë komunitar.

## 3.2 Forumi i dytë komunitar

### *"Lëviz për kopshtin tim", njësia bashkiake nr.6*

### *Kopshtet e njësisë numër 6:*

- *Kopshti 21/L*
- *Kopshti 27/ K*
- *Kopshti 38*
- *Kopshti 45*
- *Kopshti 34*

### *Pjesëmarrës:*

- Përfaqësues i Këshillit Bashkiak: Ardit Çela
- Përfaqësues i Këshillit Bashkiak: Fatmir Heti
- Administrator i njësisë bashkiake numër 6: Adriatik Merko
- Silvana Stefa, drejtoreshë e kopshtit nr. 34
- Eneida Sinani, drejtoresha e kopshtit nr. 38
- Almida Hoxhaj, drejtoresha e kopshtit nr. 27K
- Behare Titi, drejtoresha e kopshtit nr. 24

### Diskutime:

**Arlinda Gjypi, menaxhere projektesh tek shoqata "Together for Life"**

Ky është forumi i dytë komunitar që ne organizojmë në Tiranë. Është një projekt që mbështetet nga Lëviz Albania. Jam e sigurt që shumë prej jush kanë dëgjuar çfarë po bën Lëviz Albania për projektet në Shqipëri dhe për shoqërinë civile. Dua t'ju falënderoj shumë për praninë tuaj. Qëllimi i këtij takimi është të mbledhim opinionet e njerëzve dhe komunitetit, ku përfshihen jo vetëm prindërit, por edhe drejtuesit, edukatoret dhe të gjithë faktorët që kanë lidhje me kopshtet, në mënyrë që mbas mbledhjes, të gjithë këtij informacioni të mund t'i paraqesim autoriteteve vendore gjërat që mund të bëjnë të mundur ndryshimin e situatës në kopshte.

Unë kam përgatitur një prezantim të shkurtër. Projekti quhet "Lëviz për kopshtin tim" dhe ka filluar në muajin janar. Drejtueset e kopshteve e dinë se grupet e monitorimit kanë filluar në muajin janar dhe shkurt me matjen e standardeve fizike për 43 kopshte të Tiranës. Disa nga problematikat që janë nxjerrë nga monitoruesit në terren.

Gjatë muajit maj kemi mbyllur dhe 1300 anketime me prindër të ndryshëm nga 43 kopshtet e Tiranës. Kjo do të thotë se janë pyetur 1300 prindër për mendimin që ata kanë për situatën e kopshteve. Praktikisht kemi mbyllur dy faza të këtij projekti, monitorimin dhe anketimin, dhe tani jemi në fazën e forumeve komunitare, ku diskutohet mbi problemet e nxjerra nga dy fazat e para.

Me mbështetjen dhe të Lëviz Albania, kemi propozuar që këto forume komunitare të jenë me

pjesëmarrjen e komunitetit, si dhe të përfaqësuesve të pushtetit vendor, prandaj kemi të ftuar në forumin e parë administratorin e njësisë, i cili është dhe veshi i problemeve të komunitetit dhe ngritja e zërit më pas në pushtetin vendor. Të ftuar gjithashtu janë edhe përfaqësues nga Këshilli Bashkiak, duke qenë se ne këtu synojmë që në fund të arrijmë t'u prezantojmë rezultatet për të cilat ata të kenë mundësi të advokojnë në Këshillin Bashkiak, që deri diku ka në dorë të bëjë diçka për ndryshimin e situatës së kopshteve, për mos thënë plotësisht në dorë.

Disa nga problematikat që kemi nxjerrë janë: mbi-kapaciteti në grupe, pra mosrespektimi i numrit maksimal të fëmijëve që duhet të përmbajë grupi, numri i ulët i edukatoreve në raport me numrin e fëmijëve, dhoma e takimit Prind-Edukator nuk ekziston për pjesën më të madhe të kopshteve, 6 kopshte nuk kanë fare tavolinë ushqimi për fëmijët. 1 kopsht nuk ka fare tavolinë didaktike për fëmijët dhe 5 kopshte të tjerë përdorin si tavolina didaktike tavolinat e ngrënies. Gjatë monitorimit fizik të ambienteve të kopshteve u vu re se, 14 kopshte kanë tavolina me cepa dhe kënde të pazmusuara, 15 kopshte kanë karrige aspak të përshtatshme për moshën e fëmijëve, 24% e kopshteve të qytetit të Tiranës kanë vetëm ngrohje për mbajtjen e temperaturës konstante në ambientet e tyre. Fëmijët e 7 prej kopshteve të monitoruara (17%) nuk kanë në ambientet e tyre as ngrohje e as ftohje. 39% e kopshteve nuk kanë stola për fëmijë në hapësirat e jashtme, 36.6% e kopshteve të qytetit të Tiranës nuk kanë sistem ndriçimi emergjence, ndërsa 2 kopshte e kanë sistemin jofunksional. Janë 13 kopshte të monitoruara që dritaret i kanë të mbyllura me kangjella hekuri.

Dritaret nuk duhet të shërbejnë për të izoluar fëmijët, por për të dhënë mundësinë e shpëtimit prej zjarrit. 92.7% e kopshteve i kanë dyert që hapen në drejtimin "brenda - jashtë", duke vështirësuar daljet sa më emergjente në situate zjarri. Presim komentet tuaja për t'i dhënë zë këtyre problemeve, pasi është zëri juaj ai që dëgjohet.

**Eglantina Bardhi, drejtoresha e shoqatës "Together for Life"**

Ne, kur kemi bërë monitorimet, na kanë ardhur standardet të cilat tashmë janë të miratuara nga institucionet tona, pra janë të shkruara në letër, por shikojmë se ato nuk zbatohen. Akoma nuk kanë dalë të gjitha të dhënat për gjendjen e kopshteve, por, nga ato që kanë dalë deri tani, mund të them se 9% e kopshteve nuk e plotësojnë standardin e hapësirës që duhet të ketë çdo fëmijë. Ne po mundohemi të marrim zërat e të gjithëve, sidomos të prindërve, prandaj, çdo shqetësim apo problematikë që mund të keni akumuluar, do na ndihmonit shumë. Ne në përmbyllje të të gjitha forumeve do të kemi një mbledhje në Këshillin Bashkiak.

**Arlinda**

Në forumin e parë patëm të ftuar 3 anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe nga ana e tyre morëm me dashamirësi premtimin se ata do t'i ngrenë këto çështje në Këshill. Gjithsesi, ajo që ne duam, përtej premtimeve, është që anëtarët e Këshillit Bashkiak të jenë të pranishëm dhe të dinë se si është situata në kopshte dhe më pas, në takimin e fundit, ku do jetë dhe raporti përfundimtar me të gjitha të dhënat, ata të kenë mundësi ta shohin me kujdes dhe të ngrenë çështje në Këshill. Secili prej tyre është prind dhe asnjë nuk do ta çojë fëmijën në kopsht me kushte jo të mira. Unë dua t'ju ftoj të gjithëve në diskutim dhe t'ju kërkoj që gjërat që thuhen këtu të mos merren si grindje me palën tjetër. Unë do mbaj shënim të gjitha problematikat, të cilat do të pasqyrohen në Këshillin Bashkiak.

**Prind nga kopshti nr. 34**

Doja të dija, a ka ndonjë përfaqësues nga Këshilli Bashkiak këtu? Unë jam prind i kopshtit nr.

34 dhe doja një përgjigje të sinqertë: A keni qenë ndonjëherë tek kopshti nr .34? Mendoni se ka problematika ai kopsht? Një nga problematikat që ka ai kopsht është, nga ajo që e dimë të gjithë, që 90 % të fëmijëve në Tiranë janë alergjikë. Në momentin që fëmija im është alergjik dhe shkon në të ftohtë në kopsht, dhe ngrohet me sobë druri të mykur, i shton më shumë alergjitë. Edhe mua, si prind, më ndodh që kur futem dhe marr fëmijën tim aty, më zihet fryma.

E dyta që dua të shpreh. E keni vënë re se si janë klasat dhe dhomat ku flenë fëmijët, që duhet të kalosh nga dhoma e mësimit tek e gjumit dhe tek e mësimit përsëri, dhe është një tualet për tre grupe me nga 25 fëmijë. Më saktë, 2 tualete për 75 fëmijë. Jetojmë në vitin 2017. Edhe kushtet në shtëpi ndoshta nuk janë sipas standardeve evropiane, nuk janë perfekte, sepse i dimë shumë mirë kushtet të gjithsecilit, por, të paktën, për fëmijët tanë të përpiqemi të bëjmë më të mirën. Bashkëshorti im para 34 vjetësh ka qenë tek ai kopsht dhe sot në vitin 2017 kushtet nuk janë aq ndryshe. Edhe zyrën e drejtoreshës e kam gjetur me vështirësi, pasi ishte një dhomë që vetëm zyrë nuk mund të quhej.

Nuk duhet anashkaluar dhe puna që bëjnë edukatoret, të cilat kujdesen shumë mirë për fëmijët, por, fëmija im është një javë në spital dhe 1 javë në kopsht, sepse lagështira e bën të sëmuret shumë shpesh me temperaturë. Jam shumë e sigurt që në rolin e prindit, gjithsecili prej jush do të fliste në këtë mënyrë. Nëse sjell kartelën e fëmijës tim, ai është çdo muaj në spital, dhe kujtdo do t'i dridhej trupi ashtu si unë.

**Silvana Stefa, drejtoreshë e kopshtit nr. 34**

Kushtet janë realisht të vështira. Javën e kaluar ka qenë AKU për të mbyllur kopshtin, por kërkesa u shty. Të rregullohet sa më parë dhe të kthehet në gjendje normale, sepse atje qëndrojnë çdo ditë fëmijët tanë.

**Arlinda**

Diçka tjetër që kemi vënë re është se shumë nga kopshtet e përfshira në nismën "Adopto një kopsht" vazhdojnë të mos plotësojnë standardet e duhura.

**Adriatik Merko, administrator i njësisë nr. 6**

"Meqë përfaqësoj zonën e Kombinatit dhe jam vetë prind dhe i ndjeshëm për rastin e zonjës, pasi e kam edhe unë vajzën alergjike, gjëja e parë që kam marrë përsipër është kontrolli i territorit. Këtu përfshihen të gjitha rrugët, institucionet shtetërore, kopshtet, çerdhet i kam parë me syrin tim dhe se në çfarë gjendje janë realisht. Këtu fillon hapi i parë, duke njohur territorin. Në bashkëpunim me drejtoreshën e Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve ( QEZHEF), znj. Zhaneta Beqiri, e cila është për t'u vlerësuar për punën e bërë, kemi parë që realisht këto kopshte dhe çerdhe janë në gjendje të amortizuar dhe me lagështirë, me mungesë të kushteve higjienike dhe sanitare, apo ambientet e tjera shtesë që përdoren nga drejtuesit e këtyre institucioneve.

Lançimi i parë ishte "Merr përsipër një çerdhe", ndërsa lançimi i dytë që ka marrë përsipër kryetari i Bashkisë ka qenë "Merr përsipër një kopsht". Janë rikonstruktuar në Tiranë 23 kopshte. Një nga kopshtet në Kombinat ishte nr. 38. Kuptohet që ajo që kemi gjetur në fillim me situatën tani, duke u nisur nga baza materiale, tavolina, karrige të vogla, kuzhina që është parësore, si edhe edukimin që futet në aspektin akademik, nuk kemi pasur asnjë ankesë deri më sot. Por, për sa i përket kushteve fizike, kemi pasur shumë ankesa, që ne si anëtarë të Këshillit Bashkiak i kemi përcjellë si shqetësime, së bashku edhe me prindërit.

Shqetësimi më i madh në zonë e Kombinatit është kopshti nr. 34. Ky kopsht është i viteve '57-60, shumë i vjetër. Pas viteve të tranzicionit ky kopsht u uzurpua nga familjarë të cilët nuk kishin një

vendstrehim. Prandaj 4 familje po jetojnë aktualisht brenda ambienteve të këtij kopshti. Projekti për rindërtimin e kopshtit është gati në momentin që do të strehohen këto familje, pra është një kosto akoma më e madhe për Bashkinë që të sigurojë edhe strehimin e këtyre familjeve. Shpresoj që shumë shpejt makthi i prindërve që kanë sjellë fëmijët në këtë kopsht, të marrë fund.

**Fatmir Heti, përfaqësuesi i Këshillit Bashkiak (PS)**

Të gjithë jemi prindër dhe duam kushtet më të mira për fëmijët apo nipërit dhe mbesat tanë. Kombinatin e ndan vetëm një rrugë nga zona e Sharrës, dhe mund të them se situata këtu është shumë më e mirë se sa në Sharrë, ku edhe ato 2 kopshte ekzistente janë në kushte të këqija. Prandaj vitin tjetër do të ketë më shumë buxhet për rregullimin e kopshteve. Bashkia ka pasur mbështetjen maksimale edhe të Këshillit Bashkiak, pa mbajtur krah politik, por sigurisht kemi nevojë dhe për kohë, pasi nuk mund të rregullohet çdo gjë për një vit. Bashkia ka mbështetje shumë të madhe nga Këshilli Bashkiak, pavarësisht nga krahu politik, për të zgjidhur këto probleme, në mënyrë që t'u shërbejmë sa më mirë fëmijëve.

**Eneida Sinani, drejtoresha e kopshtit nr. 38**

Ky kopsht është i rikonstruktuar, por, nëse flasim për standardet, atëherë duhet të jenë ashtu siç kërkohen në rregullore. Ne, sot që flasim, kemi të regjistruar në kopsht 125 fëmijë, kështu që mbi-kapaciteti ekziston. Grupi i parë ka të regjistruar 34 fëmijë, ndërkohë që standardi është 25 fëmijë.

**Arlinda**

Sa nga prindërit i dinë standardet e kopshteve? Ne nuk jemi këtu për të sulmuar drejtuesit e kopshteve, por për të diskutuar për problemet që na shqetësojnë të gjithëve, prandaj dhe nuk i kuptojmë prindërit të cilët janë gjatë gjithë kohës në atë mëdyshjen ta them apo mos ta them, duke parë drejtueset në sy. Nga rezultatet e nxjerra nga monitorimet, rezulton se prindërit janë shumë të kënaqur me punën e drejtoreshave dhe edukatoreve. I vetmi feedback që është marrë, është pozitiv.

**Prind i kopshtit nr. 27/K**

Ne mundohemi të informohemi, megjithatë nuk jemi shumë të informuar.

**Almida Hoxhaj, drejtoresha e kopshtit nr. 27K**

Disa janë të informuar dhe disa jo. Nëse kanë pyetje apo nevojë për t'u qartësuar, mund të vijnë për të na takuar, kështu bisedojmë dhe i sqarojmë të gjitha paqartësitë.

Një problem që kemi është dhe ndarja e drejtorive. Nëse mungon një edukatore, drejtoresha detyrohet ta zëvendësojë, ndërkohë që kjo është punë e edukatores zëvendësuese. Janë 2 edukatore, njëherë i ndodh diçka njërës, herë tjetrës, prandaj duhet me patjetër zëvendësuesja. Edhe pse të dyja punët nuk mund të bëhen, ne sërish i kemi bërë. Kjo situatë duhet të zgjidhet me patjetër, pasi nuk kemi më mundësi fizike për ta përballuar.

**Behare Titi, drejtoresha e kopshtit nr. 24**

Dua të bëj një falënderim për Bashkinë e Tiranës për punën e deritanishme që ka bërë me kopshtet. Kopshti im është shumë më i mirë se sa ka qenë dhe jam e kënaqur. Unë në fakt do flas për pjesën jashtë kopshtit. Kopshti im ndodhet në afërsi të kryqëzimit "Llambi Bonata" dhe "Haki Stërmilli", i cili është kthyer në burim të vazhdueshëm aksidentesh pasi ka mungesë sinjalistike. Mendoj se duhet bërë diçka, pasi kalojnë fëmijë nga mosha 3 deri në 16 vjeç dhe janë

shumë të rrezikuar. Nëse mundet z. Adriatik t'i drejtojë një shkresë zyrtare Bashkisë dhe të bëhet diçka, sepse e kam shqetësim tepër serioz. As vijat e bardha nuk i shoh gjëkundi. Edhe pjesa e oborrit duhet t'i kushtohet vëmendje. Të ketë sa më shumë gjelbërim dhe të ketë lodra të mira dhe të sigurta për fëmijët.

**Ardit Çela, përfaqësuesi i Këshillit Bashkiak**

Unë jetoj 50 m larg kryqëzimit dhe jam njëlloj i prekur si të gjithë ju, kur bëhet fjalë për të zgjidhur problemet e të gjithëve, unë jam gjithmonë i gatshëm të bëj ç'të jetë e mundur për të përmirësuar situatën. Lidhur me problemin në fjalë, i kam drejtuar një kërkesë Bashkisë Tiranë, të cilën po e bëj për herë të parë publike në këtë forum lidhur me vendosjen e sinjalistikës të nevojshme për sigurinë e fëmijëve dhe të gjithë qytetarëve që kalojën në atë rrugë. Brenda javës tjetër kjo situatë do të sistemohet. Pikë së pari do të vendosen mbrojtëset nga ana e trotuarit, e dyta semafori , e treta vijat e bardha. Kaq për sa i përket këtij problemi, e megjithatë, dua të përmend faktin se janë bërë edhe gjëra shumë të mira nga ana e Bashkisë. Sigurisht që popullsia është rritur dhe ndërtimi i kopshteve të reja është gjithmonë i nevojshëm, kështu që ne do të vazhdojmë me ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve të reja.

**Arlinda**

Siguria në kopshte: Sa janë të sigurt fëmijët? Këtë pyetje e bëj sepse na rezulton se disa nga kopshtet e rikonstruktuara brenda vitit të kaluar nuk e plotësojnë këtë standard. Janë rikonstruktuar 27 kopshte dhe përsëri shumë standarde nuk janë. Është mirë të bëhen me të gjitha standardet, edhe pse ne vazhdojmë të themi shumë mirë që janë bërë sigurisht.

**Prind i kopshtit nr. 21/K**

Nuk ka shkallë emergjence, as dyer emergjence. Pastaj një problem tjetër është dhe pjesa jashtë e kopshteve. Duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje.

**Prind i kopshtit nr. 27 K**

Unë jam shumë e kënaqur me edukatoret në kopsht. Në atë ambient vajza ime ka mësuar të hajë vetë, gjë që nuk e bënte me parë. Ka mësuar të rregullojë rrobat, krevatin, të veshë shapkat. Gjëra shumë të mira, dhe jam shumë e kënaqur që kam zgjedhur kopshtin shtetëror, pasi çdo shërbim bëhet shumë mirë nga ana e mësuesve. Mirë do ishte të kishte dyshekë më të mirë. Mbase duhet edhe kohë që të rregullohen të gjitha, nuk mund të pretendojmë t'i rregullojmë për dy vjet.

**Drejtoresha e kopshtit nr. 45**

Në përgjithësi kushtet në kopshtin tim janë të mira, një mangësi është mungesa e mësueseve zëvendësuese. Duhet të bëhet diçka sepse është e njëjta gjë për të gjitha kopshtet. Një problem tjetër është dhe mungesa e psikologes dhe mjekes. Ose nuk vijnë fare, ose janë shumë pak të pranishme. Të dyja këto alternativa janë shumë larg standardeve.

**Psikologja e kopshteve të njësisë nr. 6**

Psikologu duhet të ketë kushte te mira për të punuar me fëmijët. Minimumi i duhet një zyre komode ku të punojë me fëmijët që kanë nevojë për ndihmën e tij. Një herë në javë nuk është e mjaftueshme, sepse ka fëmijë që kanë probleme në familje dhe kanë nevojë për më shumë mbështetje. Kjo është situata në të gjitha kopshtet, nuk flas vetëm për veten.

**Arlinda**

Shpresoj që në shtator ,kur të kemi takimin e fundit, të jemi të gjithë dhe t'i adresojmë këto probleme në pushtetin tonë vendor, që të ndryshojë situata akoma më mirë.



Foto: Pamje nga zhvillimi i forumit të dytë komunitar.



Foto: Pamje nga zhvillimi i forumit të dytë komunitar.



Foto: Pamje nga zhvillimi i forumit të dytë komunitar.

## 3.3 Forumi i tretë komunitar

***"Lëviz për kopshtin tim", njësia bashkiake nr.7***

***Kopshtet e njësisë 7***

- *Kopshti nr.2 ''Peter Pan''*
- *Kopshti nr.64 ''Xixëllonjat''*
- *Kopshti nr.26 ''Dielli''*
- *Kopshti nr. 17*
- *Kopshti nr.43*

***Pjesëmarrës:***

- Gjinovefa Kadria, administratore e njësisë nr. 7
- Albina Nanaj, përfaqësuese e Këshillit Bashkiak
- Edmond Dyrmishi, kandidat për njësinë nr. 7, LIBRA
- Blerina Hamzaj, psikologe
- Tefta Haxhiaj, drejtoreshë e kopshtit nr. 64
- Alketa Dudushi, drejtoreshë e kopshtit nr. 2
- Afërdita Hallulla, drejtoreshë e kopshtit nr. 26
- Arjeta Tashi, drejtoreshë e kopshtit nr. 17
- Leonora Deda, drejtoreshë e kopshtit nr. 43
- Prindër të fëmijëve dhe të interesuar të tjerë

**Diskutime:**

**Prind në kopshtin nr. 26:**
Problemi i parë është mbipopullimi i kopshtit. E dyta, roja duhet të jetë nga mëngjesi deri pasdite, duhet tek porta, sepse ka rrezikshmëri, por nuk rri gjatë gjithë kohës. Paguhet nga ne, edhe pse në fakt duhet ta paguajë shteti. Drejtoresha punon në grup, megjithëse nuk duhet të bëjë punën e edukatores.

**Afërdita Hallulla, drejtoreshë e kopshtit nr. 26**

Ajo që thotë prindi është e drejta e tij ta thotë. Nuk mund ta mohojmë. Tek pjesa e rojës, ne vërtet e paguajmë rojën, por nuk është problem 100%. Ai është prezent, pavarësisht se ka një moshë të thyer. Në orarin kur jemi ne nuk është aty, ndërsa gjatë kohës kur nuk jemi është. Domethënë vjen vetëm kur nuk është stafi në kopsht.

**Tefta Haxhiaj, drejtoreshë e kopshtit ''Xixëllonja''**
Kam 16 vite që punoj me kopshtet. Unë mendoj që këto standarde që ju kërkoni janë folur, janë shkruar e stër-shkruar, por unë nuk i shoh të zbatohen. Unë jam qytetare, nuk jam as në politikë e askund, jam shërbyesja e këtij apo atij kopshti. Ne në kopsht kemi gjënë më të shtrenjtë që ka një vend, fëmijët. Institucioni drejtohet me ligje dhe ne duhet të bëjmë të pamundurën që të vëmë në akordancë me njëri-tjetrin, por jemi të frustruara. Ne nuk mund të ngrihemi të gjitha dhe të themi: Përse më shkel të drejtën ligjore që unë në grup duhet të kem të regjistruar jo më

shumë se 25 fëmijë. Ky të jetë ligj që askush të mos guxoj ta prekë.
Duhet të vendosen standarde për regjistrimin, sepse aty fillon e gjitha, tek regjistrimi në shtator. Duhet të respektohen standardet. Unë nuk marr përsipër të krijoj standarde, këto i vendosin ata që e kanë për detyrë t'i vendosin, madje regjistrimet a ka mundësi të bëhen online. Të heqim dorë nga këto komisionet, nga këto gjërat që, siç i themi ne shqiptarët, muhabete kafenesh "ajo drejtoresha donte lekun". Është e turpshme. Dhe unë ia kam paraqitur këtë edhe kryetarit të Bashkisë para disa ditësh dhe i thashë: Ju lutem vini dorën tek ky që është problemi kryesor.
Ne nisemi nga disa standarde që i kemi quajtur të mira. Aktualisht u japim përparësi fëmijëve që kanë prindër në punë shteti, fëmijëve me aftësi të kufizuara apo jetimëve. Ndërkohë, ç'mund të themi për ata prindër që punojnë në privat dhe marrin vetëm 20 mijë lekë të reja rrogë? A nuk e kanë të drejtën edhe këta prindër t'i sjellin fëmijët në kopsht? Që këtu më duket se bëjmë njëfarë dallimi dhe u mohojmë të drejtën për diskriminim pa dashje, sepse unë kam mundësi të regjistroj vetëm 20 fëmijë.
Kryetari i Njësisë sonë e di mirë, 130 fëmijë janë në listë pritje, dhe me keqardhje e them, ata nuk kanë shpresë për t'u regjistruar sivjet, sepse nga vjet fëmijët janë rritur një vit, kështu që grupi i parë vazhdon i dyti.
Ky është problemi i parë, për mua roja është problemi i fundit. Ta dini ju sa probleme kam unë për rojën, se jam kopsht dhe çerdhe e integruar.
Tjetër gjë hapësira. Unë i kam shëtitur të gjithë kopshtet, ndërsa kopshti ku jam unë, është gjysma e hapësirës që keni ju. Një grup e kam me 48 fëmijë në grup. Sepse duke qenë kopsht dhe çerdhe e integruar, ata prindër mendojnë se që nga çerdhja do kalojnë direkt tek kopshti.
Lexoni atë çka kanë bërë dispozitat normative, ku ne mbështetemi, është e drejtë për të ndjekur kopshtin, por nuk është arsim i detyruar parashkollori.
Është diskriminuese që drejtuesja të jetë në grup edhe mësuese edhe drejtoreshë. Sepse është e pamundur. Thjesht të vini ju zonjë, të vijë kryetari i Bashkisë, të vijë këshilltari, të vijë një prind, unë do dal nga grupi, do shkoj në zyrë. Në këtë moment unë kam lënë fëmijët vetëm, abuzova me fëmijët, i lashë vetëm. Por ne shqiptarët kujtohemi pasi na ndodhin gjërat, nuk i paraprijmë.
Ne nuk bëjmë studim demografik të lagjes se sa do kem vitin që vjen, që kryetari i Bashkisë ta dijë që kërkesat për kopsht janë kaq, që drejtori i shkollës ta dijë një vit përpara, po ne nuk i bëjmë këto gjëra.
Përpos kësaj, është e turpshme që një psikologe ka dy shkolla me minimalisht 500 fëmijë dhe një ose dy kopshte. Kjo është thjesht "më ka çuar nëna me larë gojën".
Kam punuar 20 vjet në shkollë të mesme dhe e di sa nevojë kanë shkollat për psikologun.
Dhe e dyta, bravo çerdhet që kanë punonjëse sociale dhe turp ne kopshtet që s'kemi. Janë dy profesione të ndryshme, psikologja është tjetër gjë, punonjësja sociale është tjetër gjë. Dhe kjo është mangësia jonë.
Thuhet kudo që kopshtet kanë mjekë. Nëse quhet të pasurit mjek një herë në javë, që ndonjëherë këto mjeket tona nuk mbushin dot as kartelat e gjatësisë së fëmijëve, gjerësinë e shpatullave etj. Le të ma hedhin poshtë, po këtë e bëjnë edukatoret nëpër grupe, pjesën më të madhe të kësaj pune e bëjnë ato.
Unë nuk kam infermiere fare, nuk e kam as mjeke dhe vjen një herë në javë. Por ajo, atë ditë që vjen, do depistojë fëmijët, do ndjekë ecurinë e shëndetit të një sëmundje, do shikojë sa është dendësia, ra variçela, sa ta marrë vesh prindi, gjysma e fëmijëve e morën infeksionin.
Varësia e kopshteve: Tashmë kopshtet janë në varësi të pushteti vendor.
Na kanë lënë si nusja me dy vjehrra, një këmbë e kemi në DAR, një këmbë e kemi në Bashki, një në QEZHEF, kur të na dalë dhe një këmbë e katërt kushedi ku do na çojnë.
Absolutisht DAR-i na ka hequr qafe, por kur vjen puna për të bërë emërimet, janë të parët.

QEZHEF na ka xhan, por s'na ka në varësi të na emërojë.
Si është e mundur që brenda një shteti të ketë dy mënyra të të sjellët ndaj ligjit?! Prandaj unë them se ne me ligjin jemi shokë, bëhemi miq, ndërsa me anën sociale nuk dimë të jemi socialë.

**Albina Nanaj, përfaqësuese e Këshillit Bashkiak**

Ne e dimë që numri i kopshteve dhe çerdheve duhet të shtohen në Tiranë, duke qenë se tashmë kemi dhe zona me dendësi të madhe, që deri dje kanë qenë pjesë e njësive administrative rurale dhe tani i janë bashkuar Bashkisë së madhe, siç mund të jetë zona e Freskut, zona e Yzberishtit dhe njësitë e tjera administrative që janë në kufij dhe kanë dendësi shumë të madhe.
Problematikat kryesore që ne kemi ngritur kanë qenë ato të standardeve dhe mbipopullimi i çerdheve, duke qenë se pjesa më e madhe e jona janë prindër dhe jemi në kontakt të drejtpërdrejtë me problematikat, si mbipopullimi. Im bir p.sh., është në listë pritje në një prej njësive administrative.
Duke qenë se Bashkia menaxhon infrastrukturën, por nuk ka në dorë stafin dhe emërimet, kontrolli mbi stafin është një lloj handikapi që ndikon si në funksionimin, ashtu edhe në vendosjen e numrit të fëmijëve që do pranohen. Por, shumë shumë shpejt, edhe kjo pjesë e decentralizimit do të ndodhë dhe ndoshta do të jetë një moment i mirë për të rivendosur këto standarde. Tani nuk mund të them që këto gjëra mund të ndodhin brenda ditës, por ne jemi duke lobuar që të bëhen investime në kopshte dhe çerdhe, sepse mbingarkesën ne nuk mund ta heqim brenda ditës thjesht duke mos pranuar fëmijë që dhe ana njerëzore, qoftë e drejtoreshave, qoftë edhe e drejtuesve politikë, nuk i lejon që të tregohen kaq të rreptë me fëmijët dhe t'i nxjerrin ata nga kopshtet dhe çerdhet, aq më tepër kur synohet që këto fëmijë të afrohen dhe integrohen në kopshte dhe çerdhe ndaj të cilave duhet të kenë akses.
Mendoj që për momentin e vetmja mënyrë është që të ndërtohen kopshte dhe çerdhe të reja, dhe kjo nuk është një ambicie e jashtëzakonshme dhe e paarritshme, e parealizueshme për Bashkinë. Nisma "Adopto një kopsht" ishte shumë e mirë, por nuk mund të mjaftojë për të gjithë fëmijët e Tiranës.
Në dijeninë time, numri i kopshteve dhe çerdheve në periudhën e tranzicionit/demokracisë është zvogëluar dhe ky është një paradoks i jashtëzakonshëm, ndërkohë që popullsia është shumëfishuar, numri i kopshteve dhe çerdheve është reduktuar. Kjo automatikisht ka sjellë edhe cenimin e standardeve.
Personalisht ndaj një përvojë pozitive sa i takon nivelit të mësimdhënies që ofrojnë edukatoret në kopshte dhe çerdhe shtetërore, krahasuar me ato private.
Mendoj se duhet ushtruar kontroll edhe në kopshtet private, për të arritur standardet, sepse nuk mund të shohim me dy standarde mes kopshteve shtetërore dhe private. Nga njëra anë privati ofron infrastrukturë më të mirë por jo mësimdhënie po aq efektive sa shtetërori, dhe nga ana tjetër në shtet infrastruktura nuk është aq e arrirë sa privati.
Unë do ju sugjeroja që të bënit një studim edhe për kopshtet dhe çerdhet private, se fundja është një shërbim publik, pavarësisht se paguhet kundrejt një private.

**Gjinovefa Kadria, administratore e njësisë nr.7:**

Njësia jonë është e vetmja që ka 5 kopshte, por jo të mjaftueshme. Para disa ditësh Tefta më thotë: "Unë javën që do regjistroj fëmijët do marr raport, ta dish që sot".
Nga njëra anë ndihem mirë që kërkesa për t'u regjistruar në kopshtet shtetëore është në rritje dhe ka një radhë të gjatë, dhe nga ana tjetër përsëri biem në siklet se çfarë mund të bëjmë me këto prindër që vijnë dhe trokasin në derë, pasi mendojnë se ai që duhet t'i ndihmojë është administratori i njësisë.

Kopshtet, për hir të së vërtetës, kanë një ndryshim kolosal, në të 5 kopshtet. Këto ditë përurojmë dhe kopshtin nr. 17, që në shtator fillon me efiçencë të plotë, se për momentin ka qenë sa për të mbajtur 'frymën'. Në shtator fillon procesin e regjistrimit dhe do ketë një zbutje nga regjistrimi që mund të bëhet tek ai kopsht. Të paktën 120 fëmijë do të mund të strehohen në këtë kopsht.
Ka një gjë tjetër, kopshtet private. Unë jam dakord me Albinën, krahas këtij studimi që bëni, duhet të shihni edhe kopshtet private që në fasadë ngjajnë bukur shumë, por nga prindër kanë ardhur dhe më janë ankuar se çfarë nuk kanë parë në ata kopshte.
Në kopshtin tonë janë rikonstruktuar 3 kopshte dhe flas më garanci të plotë që punimet aty janë bërë me cilësi dhe standarde. Drejtuset e kopshteve aty, që janë drejtuese të vjetra, e dinë mirë se si ka qenë gjendja aty dhe mund ta flasin vetë.

**Albina Nanaj, përfaqësuese e Këshillit Bashkiak**

Kur flasim për standarde, duhet të kemi parasysh edhe në ç'gjendje ka qenë godina.
Për momentin rikonstruksionet janë mirë, por nuk janë zgjidhja finale. Zgjidhja finale për Tiranën, duke qenë se pjesa më e madhe e kopshteve janë ndërtuar 4-5 dekada më para dhe kanë bërë një rrugë të amortizimit të pakthyeshëm, janë kopshtet e reja. Mesa di unë, në Tiranë do ndërtohen disa komplekse, 20 shkolla të reja dhe në këto shkolla do ketë hapësira për kopshte dhe për çerdhe.
Ne, si Këshill Bashkiak, do na keni mbështetje, për ta forcuar këtë lloj zëri, këtë lloj alternative që edhe ju të sugjeroni ndërtimin e kopshteve dhe çerdheve të reja, sepse rikonstruksioni është një zgjidhje afatshkurtër, por nuk është përfundimtare.

**Tefta Haxhiaj, drejtoreshë e kopshtit ''Xixëllonja''**
Mësueset për mua janë heroina që mbajnë nga 50-60 fëmijë në ditë, dyfishin e normës. Është shkelje me të dyja këmbët dhe vijnë e kërkojnë llogari për çdo gjë.
Mua më duket arkaike mbledhja e kontributeve nga prindi. Prindi paguan taksë në Bashki dhe është e turpshme, më turpërojnë figurën, personalitetin tim duke mbledhur kontribut nga prindërit. A e dini që na mungon baza materiale në kopshte? A e dini që unë s'kam lodra për fëmijët, që ata të luajnë, të vizitojnë apo mësojnë?
Unë jam kundra kontributeve në kopshte dhe në shkolla, nëse më duhet një investim do mbledh gjithë prindërit dhe të gjithë së bashku hajde ta bëjmë. Ç'është kjo?!
Përderisa prindi paguan taksën mujore në faturën e ujit, për mua ka mbaruar çdo gjë.

**Albina Nanaj:**
Kjo pjesa e taksës është e rëndësishme dhe vlen për tu' sqaruar. Pjesa e taksës për infrastrukturën arsimore është për ndërtimin e shkollave. Ndërkohë që prindërit paguajnë tarifën e kopshtit dhe çerdhes çdo muaj. Në qoftë se kjo paguhet vetëm për ushqimin, le të përfshihet në tarifë edhe pjesa e kontributit, që mos të ndihet invazive.

**Blerina Hamzaj, psikologe**
Unë përfaqësoj psikologen dhe mesa shoh jam e vetmja, pasi mbuloj pothuajse të gjithë kopshtet e Njësisë nr. 7. Kam mbuluar tre vjet një grup që ka pasur fëmijë hiperaktiv që cenonin jetën e të gjithë fëmijëve të tjerë. Unë dhe edukatoret kemi qenë në funksionin e një dadoje, e kisha harruar profesionin tim për tre vjet, sepse përveç këtyre, kishim në grup edhe 50 fëmijë të tjerë. Imagjinojeni tani çfarë ndodh në atë grup. Aty nuk kishte as edukim, as mësim, përkundrazi,

rrezik për jetën.
Për shkak dhe të ambientit të ngushtë, ajri i ndotur i kalonte nivelet e normales, që për mua është shumë shqetësuese. Çdo herë në punë shkojmë pa dëshirë, sepse mbajmë brenda vetes një ndjenjë faji.
E dyta për shkak se unë mbuloj në një ditë, p.sh kopshti 23 ka katër fëmijë autikë, ka fëmijë me probleme divorci, me dhunë në familje.

**Prind:**
Fëmijët kanë nevojë dhe për pak ajër. Ata rrinë gjithë ditën brenda. Gjatë dimrit ka qenë problem dhe ngrohja, ndonjëherë me kalorifer e ndonjëherë me batanije. Kjo nuk është aspak normale sepse fëmijët duhet të mësojnë.

**Alketa Dudushi, drejtoreshë e kopshtit 2**
Kopshti ynë është pjesë e nismës 'Adopto një kopësht'. Të jeni të bindur që nëse do ta kishit bërë monitorimin para dy vitesh, nuk do të nxirrnit vetëm një fletë në raportin tuaj, por një libër.
Kopshti nr. 2 është kopsht historik. 50 m larg qendrës së Tiranës dhe që funksionon non stop që nga viti 1954. Në nëntor vjet u bë rikonstruksioni i pjesshëm.
U ndërhy vetëm brenda, nuk u ndërhy as në hapësirat e jashtme, as në hapësirat e brendshme. Pra u përmirësua cilësia që aty brenda. Kopshti ka dy vjet që ngrohet me kaldaja. Tirana e viteve 2000 po mbipopullohet çdo ditë e më shumë, çka shton sasinë. Normal që sasia do humbasë cilësi.
Flasim për standardet. Në dispozitat normative standardet janë. Ne nuk duam të ndryshohen standartet, por të zbatohen.
Nuk mundet një mjek familje të mbaj nga X familje, në X, Y tani. Kopshti nr. 17 mua më erdhi shumë mirë që do rrisë efiçencën këtë vit, gjë që do të lehtësojë edhe kopshtet e tjera.
Po kopshti duhet të ketë edhe kënd lojërash jashtë. Kënd të jashtëm nuk do të thotë një shilarëse, por të jetë kompleks sepse fëmijët presin radhën. Në çdo kopsht unë do doja kënde funksionale edukimi, argëtimi.
Neve na dridhet zemra kur dalim jashtë, se nga momenti në moment mund të ndodhë diçka. Nuk e di sa mirë janë të llogaritura, mund të jenë shumë të mira për poshtë pallatit, por jo në një kopsht me një frekuentim minimumi 140 fëmijë.
Fëmijës mësoi çfarë të duash brenda, gjëja e parë që thotë është më nxorën jashtë, luajta.

**Leonora Deda, drejtoreshë e kopshtit nr. 43**
Ajo që më shqetëson mua janë fëmijët autikë, mosha e të cilëve arrin në 9 vjeç. Unë në kopshtin tim kam 5 fëmijë autikë, 4 e kanë pranuar dhe janë me raport mjekësor, ndërsa një prind nuk e ka pranuar. Mua më shqetëson sepse ky fëmijë i kalon të tre etapat, grupin e parë, të dytë dhe të tretë. Tani ata fëmijë që vijnë në grupin e parë, ku do shkojë ky fëmijë, se është 7 vjeç, prindi nuk e heq, ne nuk e dimë si të veprojmë, me dispozita thotë se duhet të jetë 8 vjeç. Si duhet të veprojmë, si mund të lihet ky fëmijë 8 vjeç me një trevjeçar?!
Mungesa të tjera, krevate, lodra të gjithë kanë. Ne kemi mungesë 20 shtretër. Vetë prindërit kanë pranuar t'i vendosin përtokë, por nuk është ky problemi. Problemi jonë është pjesa e madhe e autikëve. Neve na shqetëson shumë mosha dhe nuk e di se si do zgjidhet.
Janë të gjithë të moshës 6-7 vjeçare. Sivjet presim edhe grupin e vogël. Kemi pasur kërkesa me fëmijë me sindromën down, kemi pas kërkesa me aftësi të veçanta. Në total do na bëhen 7-8 fëmijë.
Aktualisht kopshti nr. 43 ka 163 fëmijë të regjistruar, pra mbi kapacitet. Problemi është që në një

grup kemi 2 autikë dhe nuk i përkushtohemi dot fëmijëve të tjerë.

**Tefta Haxhiaj, drejtoreshë e kopshtit "Xixëllonja''**

Dispozitat normative për arsimin parashkollor nuk e kanë të përcaktuar moshën për fëmijët me aftësi të kufizuara. Edhe shërbimin që duhet të ketë mësues ndihmës.

Unë jam për këtë, integrimi i fëmijëve duhet të jetë e drejta e çdokujt, deri atëherë kur nuk cenohet interesi i fëmijës tjetër. Ne abuzojmë, për të përcaktuar sa e rënda është diagnoza e një fëmije, është grupi i mjekëve që e përcakton, dhe jo çdo fëmijë me aftësi të kufizuara mund të rrijë pranë fëmijëve të tjerë. Ka disa lloje sindromash, që, në vend që ta rregullojmë, i bëjmë dëm.

Unë do loboj shumë bashkë me shoqet, e kam marrë në mendje dhe sivjet do ia paraqes kryetarit të Bashkisë, që të ndryshojë totalisht mentaliteti për mbylljen e kopshteve në muajin gusht.

Është shpenzim energjish të kotë, është shpenzim lekësh të kota. Në gusht ngelen 5 fëmijë në kopshtin tim, po aq edhe në kopshtet e tjera. Si e bën bota. Të vihet një fugon dhe t›i mbledhë të gjithë në një kopsht. Bota e ka gjithë muajin gusht pushim.

E di ça bëjmë ne gjithë vitin? Një javë dezinfektohet kopshti, lahen depozitat e ujit, ok janë shumë të mira që ndodhin, por pse të mos bëhen në muajin gusht, ku edhe ne marrim lejen të qeta, edhe fëmija shkëputet nga një stad i moshës në një tjetër. Ne e harrojmë qëllimin për të cilin është kopshti. Kopshti është për të përgatitur fëmijë qytetar, detyra jonë është shndërruar t'i bëjmë Ajnshtajn.

Ne duhet të edukojmë qytetarë. Ne duhet t'i bëjmë një memo Këshillit Bashkiak, se dhe kjo demokraci është që hajt të ndryshojmë një mendësi në drejtimin e kopshteve.

**Albina Nanaj, përfaqësuese e Këshillit Bashkiak**

Gjithë këto ide kaq të mira që ju jepni, me gjithë përvojën që unë e çmoj shumë, patjetër që do gjejnë mbështetje.

Dhe mendoj se keni të gjitha argumentet për ta mbështetur propozimin tuaj, dhe ne si politik-bërës nuk mund të kemi idenë e çështjeve teknike, të gjitha fushave, prandaj tryeza të tilla janë shumë të mira, që ne të biem në kontakt me problematika, me propozime, dhe patjetër vullneti jonë është t'ju mbështesim për ta bërë konkrete.

Qoftë ky propozim, qoftë tjetri lidhur me dietën dhe tarifën e përcaktuar.

**Edmond Dyrmishi, kandidat për njësinë nr. 7, LIBRA**

Përderisa është rritur numri i popullatës, duhet të ishte rritur edhe numri i kopshteve dhe i shkollave. Në qoftë se ne fokusohemi tek luksi para gjërave që janë domosdoshmëri, nuk është mirë.

Unë u drithërova kur mora vesh këtë dimër që nuk përballohej ngrohja e fëmijëve në kopshte. Si ka mundësi të mos ketë?!

Ne dhe në shtëpi mbajmë rezerva për ditë të vështira. Kopshtet kaq shumë menaxhim të fortë dashkan?! Kaq frikë kemi ne të kërkojmë për këtë brez që na rrëshqet dita ditës duke ikur, duke marrë problemet e të mëdhenjve?!

Ne duhet ta kërkojmë me forcë në Bashki, fëmijët duhet të jenë prioritet. Jo nuk ka mundësi, ka shumë mundësi. Të bëjmë një llogari të thjeshtë.

Në Tiranë janë hapur parkime publike. A e dini sa para mbledh Bashkia?! 170 mijë makina qarkullojnë në Tiranë. Po hapen ditë për ditë parkingje me pagesë dhe shifra është marramendëse, 300 milionë lekë mblidhen, shumëzojeni për muaj, për vit, sa del.

Një Bashki grumbullon shumë lekë, por si ka mundësi të mos jetë prioritet kopshti?! Si ka mundësi

mos jetë prioritet embrioni për të cilin neve jemi të ndërgjegjshëm që e kemi sjellë në jetë?! Kanë qenë 68 kopshte, janë bërë 43, taksat janë dyfishuar, ku po vemë kështu?!

**Sonila, lider global për fëmijërinë e hershme në Shqipëri**
Unë doja të pyesja Këshillin Bashkiak: A bëjmë ne buxhetim me pjesëmarrje në Bashki?
Është koha si qytetar ta ngremë zërin, është e drejta jonë të shkojmë dhe ta ngremë zërin kur buxhetohet. Janë lekët tona. *Nuk është e drejtë që ata që kanë rrogën më të lartë të paguajnë më shumë. Personalisht mua më është ulur rroga.* Besoj të gjithëve iu ka ndodhur, për shkak se po rritet rroga për një target-grup tjetër.

**Albina Nanaj, përfaqësuese e Këshillit Bashkiak**
Pjesërisht, në çdo njësi bashkiake janë organizuar dëgjesa para hartimit të buxhetit afatmesëm dhe bashkë me komunitetin janë vendosur prioritete për secilën njësi.
Përpara se të miratojmë buxhetin e 2018-s, besoj se në shtator-nëntor do të bëhen dëgjesa në secilën Njësi, ku do të jenë prezent edhe anëtarët e këshillit. Gjatë kësaj kohe do të kemi bërë edhe sugjerime për ndryshme në buxhet. Sepse buxheti që miratojmë ne në Bashkinë e Tiranës është relativisht shumë i madh.
Buxhetimi me pjesëmarrje bëhet për një komunitet shumë të gjerë, por që të merret specifikisht, jo me target-grupe të caktuara.
Nëse doni të realizoni një për kopshtet, edhe mund ta propozoni e patjetër që mund të merret parasysh.



Foto: Pamje nga zhvillimi i forumit të tretë komunitar.



Foto: Pamje nga zhvillimi i forumit të tretë komunitar.



Foto: Pamje nga zhvillimi i forumit të tretë komunitar.

## 3.4 Forumi i katërt komunitar

***"Lëviz për kopshtin tim" njësia bashkiake nr. 2***

***Ko***pshtet e njësisë 2 dhe kopshte të tjera

- Kopshti Bregu i Lumit
- Kopshti nr. 25/1
- Kopshti Sauk
- Kopshti Ylberi
- Kopshti Kodër Kamëz
- Kopshti nr. 39
- Kopshti nr. 24

Pjesëmarrës:

- Anila Xhaferraj, drejtoresha e kopshtit "Bregu i Lumit"
- Vitori Tarka, drejtoresha e kopshtit nr. 25/1
- Loreta Dokaj, drejtoresha e kopshtit Sauk
- Loreta Dervishi, drejtoresha e kopshtit nr. 40
- Flora Novosela, drejtoresha e kopshtit "Ylberi"
- Desantila Ferhati, drejtoresha e kopshtit "Kodër Kamëz"
- Eljona Kryemadhi, drejtoresha e kopshtit nr. 41
- Behare Titi, drejtoresha e kopshtit nr. 24
- Përfaqësuese e "Lëviz Albania"
- Prindër të fëmijëve dhe të interesuar të tjerë

Diskutime:

Tematika që ne do të trajtojmë është shumë problematike dhe besoj se secili nga ne preket nga fenomeni i respektimit të standardeve të kopshteve. Shoqata "Together for Life", në bashkëpunim me "Lëviz Albania", ka monitoruar infrastrukturën dhe investimet e 43 kopshteve publike të Tiranës, me qëllim informimin e qytetarëve dhe medias për të nxitur përgjegjshmërinë dhe transparencën e pushtetit vendor për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në kopshtet e Bashkisë së Tiranës. Unë do t'ju prezantoj disa nga rezultatet që kanë dalë deri tani, sigurisht që të dhënat përfundimtare nuk kanë dalë plotësisht.

Ajo që është vënë re është se:

Vihet re fenomeni i mbi-kapaciteteve të hapësirave. Në 89% të kopshteve të monitoruara (nga të cilat 24 janë të nismës "Adopto një kopsht"), prej të cilave u morën informacione të sakta dhe të plota, vihet re një numër fëmijësh për grup përtej normave të këshilluara për mirërritjen e tyre.

Ka numër të ulët të edukatoreve në raport me numrin e fëmijëve.

Kopshte të cilëve u mungon kuzhina kryesore janë 19% dhe janë vetëm 15 kopshte që kanë aneks ku mund të përgatitet shpërndarja e ushqimit, nga të cilat 13 janë të nismës "Adopto një kopsht".

24% e kopshteve të qytetit të Tiranës (nga të cilat 9 kopshte janë të nismës "Adopto një kop-

sht") kanë vetëm ngrohje për mbajtjen e temperaturës konstante në ambientet e tyre.

Fëmijët e 7 prej kopshteve të monitoruara (nga të cilat nuk ka të nismës Adopto një kopsht), nuk kanë në ambientet e tyre as ngrohje e as ftohje.

15% e kopshteve të qytetit të Tiranës (nga të cilat 2 kopshte janë të nismës "Adopto një kopsht") nuk kanë ujë të ngrohtë dhe të ftohtë pa ndërprerje. Vlen të theksohet se kopshti nr. 34 nuk ka ujë të ngrohtë.

13 nga 41 kopshtet e monitoruara (nga të cilat 3 kopshte janë të nismës Adopto një kopsht) nuk kanë lodra në ambientet e tyre të jashtme për fëmijët. 4 kopshte të tjera (nga të cilat 2 kopshte janë të nismës Adopto një kopsht) kanë lodra të pamjaftueshme për numrin e fëmijëve të pranishëm në institucion. Është e rëndësishme të theksohet se, kopshti nr. 64 "Xixëllonjat" , kopshti "Bregu i Lumit" (pjesë e nismës Adopto një kopsht) kanë lodra që nuk janë të përshtatshme për fëmijët në këto grupmosha, duke cenuar sigurinë e tyre.

92.7% e kopshteve i kanë dyert që hapen në drejtimin "brenda - jashtë", duke vështirësuar daljet sa më emergjente në situate zjarri.

Lidhur me kopshtet e njësisë numër 2, si dhe kopshtet e tjera si kopshti i Saukut, kopshti "Shkozë", kopshti "Kodër Kamëz", kopshti nr. 24 dhe kopshti "Ylberi" vihen re:

- Numër i lartë fëmijësh (mbi-kapacitet)
- Numër i ulët i edukatoreve
- Krevatet ngjitur
- Ka mungesë kondicioneri/ Problem temperaturat e larta
- Ka mungesë të mjekëve dhe psikologëve
- Drejtoreshat duhet të bëjnë edhe edukatoren
- Kontributet shkojnë për rojën, ndërkohë që mund të përdoreshin për të shtuar detergjentet dhe pecetat për fëmijët
- Kopshti "Kodër-Kamëz" ndodhet në ambientet brenda shkollës (banjë e përbashkët me nxënësit e shkollës).

Kjo situatë është e pasqyruar edhe tek fotot e shfaqura në ekran. Disa prej tyre mund të jenë kopshtet të cilat ndodhen sot këtu.

Sot të pranishëm këtu kemi drejtueset e këtyre kopshteve, prindërit dhe personelin, të cilët mund të shprehin mendimet e tyre si dhe të diskutojnë lidhur me problematika të tjera, të cilat mund të hasin gjatë ditëve të tyre. Për fat të mirë kemi patur bashkëpunim të shkëlqyer me të gjithë aktorët dhe për këtë i falënderoj shumë.

Prind nga kopshti nr. 40

Unë jam prind në kopshtin nr. 40. Në fakt kopshti ka pasur rikonstruksion dhe, në syrin tim si prind, gjithçka shkon mirë. Ajo që përbën shqetësim është fakti se ka mungesë të kondicionerit. Për fëmijët është e nevojshme të jetë, sidomos në këto ditë të nxehta. Për sa i përket kujdesit nga ana e stafit, mënyrës si zhvillohet mësimi, si komunikohet me fëmijët, jam e kënaqur. Ky shqetësim është evident dhe e kam diskutuar dhe me drejtoreshën apo mësueset.

Loreta Dervishi, drejtoresha e kopshtit nr. 40

Standardet janë bashkëkohore, i kemi kushtet dhe mund të them se është komod për komunitetin. Sa për raportin fëmijë-hapësirë, edhe këtë mund ta konsideroj problem, pasi po rikonstruktohen kopshte pranë kopshtit që unë drejtoj, dhe prurjet vijnë tek ne, ndërkohë qe kopshti nuk ka kapacitetin fizik për ta përballuar këtë gjë. Kopshti mbingarkohet shumë. Megjithatë, shpresoj që këtë vit të përfundojë rikonstruksioni në kopshtin nr. 18 dhe situata të mund të lehtësohet.

Anila Xhaferraj, drejtoresha e kopshtit “Bregu i Lumit”

Në përgjithësi mungojnë tavolina dhe karrige në ambientet e kopshtit . Edhe ato që janë, janë të dëmtuara, të konsumuara. 2 klasat në parashkollor janë në ambientet e kopshtit dhe nuk ka kushte. Është i vetmi kopsht shtetëror në atë zonë, kjo e bën të vështirë situatën. Ka mungesë hapësire. Në ambientet brenda kopshtit kam dhe kaldajat dhe depozitat e ujit, të cilat nuk duhet të jenë. Ne i kemi raportuar dhe shpresojmë që në një të ardhme të mund të rregullohen. Në ambientet e kopshtit ka mungesë të theksuar të ujit gjithashtu, gjë që duhet të rregullohet sa më shpejt të jetë e mundur. U bënë 4 vite qe bëj luftë me institucionet dhe nuk është bërë asgjë. Tani e gjeta zgjidhjen nëpërmjet një linje që e marr nga një pus i shkollës. Nuk kam futur depozita sepse uji doli me ndotje dhe nuk mund të bashkoj të dyja, edhe linjën edhe pusin, pasi pusi ka ndotje të madhe. Për 220 fëmijë kjo situata është skandaloze. Deri në këto momente mundohemi të mbajmë pastërtinë në ambientet e kopshtit me mënyrat tona, kemi gjetur mënyra alternative për të zgjidhur situatën, u themi komshinjve na jepni pompën, sepse nuk kemi rrugë tjetër. Edhe diçka tjetër. Ne ngushticë të rrugës, pa u futur tek ambienti i kopshtit, nuk mund te futet asnjë makinë e madhe. Imagjino sikur te ndodhë ndonjë fatkeqësi, çfarë mund të bëhet? Kam kërkuar zgjerim rrugë, kam shkuar në ndërmarrje, tek Njësia Bashkiake, i kam bashkë me foto dhe pres të më kthehet një përgjigje zyrtare se çfarë mund të bëhet me këtë situatë. Kopshti u rikonstruktua dhe lagështira është eliminuar, por janë këto probleme të tjera që na pengojnë në punën tonë të përditshme.

Desantila Ferhati, drejtoresha e kopshtit “Kodër Kamëz”

U bë viti i dytë që godina është në rikonstruksion dhe ne jemi transferuar në shkollën “Isa Boletini”. Kemi 60 veta në grup. Sipas informacionit që unë kam, arsyeja përse ne akoma nuk po hyjmë në kopshtin ku na takon lidhet me një problem pronësie. Para 2 javësh u diskutua që do fillonin punimet. Kjo situatë kështu po shkon, kalojnë 2 javë harrohet dhe nuk bëhet asnjë lloj gjëje.  Ne nuk kemi asnjë kusht dhe numri i regjistrimeve është sërish në rritje, kjo për faktin se është i vetmi institucion në atë zonë. Është vetëm ai kopsht. Kjo gjë është nën varësi të Bashkisë së Tiranës.

Eljona Kryemadhi, drejtoresha e kopshtit nr. 41

Të gjitha këto problematika që në po diskutojmë këtu do të mbeten thjesht në letër, apo do t’u jepet zgjidhje? Do doja të dija përgjigjen e kësaj pyetjeje. Sa mund të marrin zgjidhje këto problematika nga 1 tek 10?

Eglantina Bardhi, drojetoresha e shoqatës “Together for Life”

Kjo është pyetje me shumë vend, faleminderit që ma bëni. Ne, përveçse mund të shtyjmë organet kompetente të zbatojnë këto standarde, nuk mund të bëjmë dot më shumë. Ne përpiqemi që fëmijët të marrin atë që u takon me ligj. E gjithë kjo situatë duhet të shkojë deri tek kryetari i Bashkisë. Ne si organizatë kemi pasur histori suksesi, siç është kopshti numër 34, ku pas botimit në media të artikullit lidhur me gjendjen e kopshtit, AKU shkoi për ta mbyllur kopshtin . Një tjetër histori suksesi është vendosja e sinjalistikës në kryqëzimin që përshin kopshtet e zonës së Kombinatit.

Behare Titi, drejtoresha e kopshtit nr. 24

Gjërat më problematike në ambientet e kopshteve tona janë numri i madh i fëmijëve dhe mungesa e tavolinave dhe karrigeve. Gjithashtu edhe gjatë verës, temperaturat e larta dhe

mungesa e një kondicioneri na e vështirësojnë qëndrimin në kopsht. Mirë që Bashkia ka menduar për ngrohje, po për ftohjen kush mendon? Edhe numri i lartë i fëmijëve. Kjo gjë vihet re tek të gjithë, jo vetëm tek kopshti im. Kriter për regjistrim të fëmijëve në kopsht është që duhet të jetë banor i lagjes, gjë e cila nuk respektohet, pasi pavarësisht se nuk janë banorë të lagjes, i regjistrojmë se nuk mund t'i lëmë rrugëve. Kjo është dhe thyerje e ligjit, por nuk kemi çfarë të bëjmë. Ne e kemi raportuar këtë si situatë, por siç duket është ende pa zgjidhje.

Loreta Dervishi, drejtoresha e kopshtit nr. 40

Kopshti im ndodhet tek Tregu Elektrik dhe mua me vijnë banorët edhe nga sheshi "Avni Rustemi". Atyre u takon të shkojnë tek kopshti nr. 19, që ndodhet tek Njësia nr. 3. Neve na është thënë kështu: nga data 4 deri në 5 do të regjistrosh të gjithë banorët e zonës që të përkasin me rrugë të përcaktuara, disa rrugë i kam unë, disa i ka nr. 18, disa kopshti nr. 41, në mënyrë që të kemi një ndarje korrekte mes njëra-tjetrës. Dhe nëse ke vende bosh, nga data 5 deri në datën 9 regjistrohen kopshtet jashtë zone. Mbingarkesa është e madhe sepse shtrirja e njësisë është shumë e madhe. Është gjithashtu zonë që frekuentohet nga prindër që rrinë me qira. Nuk mund t'ia privojmë prindërve regjistrimin e fëmijës. Ja e çoj numrin 35, 40 të grupit, kjo për shkak se prindi më sjell dokumente të rregullta, shkresë nga kryeplaku si dhe të dy prindërit janë në punë. Si ta lë në listë pritje? Për mendimin tim, çalimi i punës nuk qëndron tek vapa, edhe kondicioneri është i domosdoshëm, megjithatë përballohet, por numri i madh dhe mungesa e bazës didaktike për mësim janë ajo që nuk shkon. Ne jemi heroina!

Flora Novosela, drejtoresha e kopshtit Shkozë Ylber

Infrastruktura dhe baza didaktike qëndrojnë. Nuk mund të privojmë prindërit nga regjistrimi i fëmijëve në kopsht. Nuk bëjmë diskriminim, regjistrojmë fëmijët e gjithëve. Për kopshtet asnjë gjë nuk mund të thuhet plotësisht, sepse s'ka fund. Kopshti është si një shtëpi e madhe, ku fëmijët bëjnë vetëm gjumin e natës në shtëpi, asgjë tjetër. Nga mëngjesi deri në darkë fëmijët në ambientet e kopshtit, hanë pinë.

Margelina Kokalari, drejtoresha e kopshtit nr. 18

Do të donim të mbaronte sa më shpejt rikonstruksioni dhe fëmijët të ishin më komodë në kopshtin e ri. Të shpresojmë që kjo problematikë do të rregullohet së shpejti.

Edukatore në kopshtin Shkozë

Edhe për ne do të ishte mirë të kishim një kopsht me ushqim. Në këtë mënyrë do të parandalojmë ikjen e fëmijëve në kopshtet e tjera. Komuniteti atje është shumë i madh dhe është nevoja shumë për kopsht me ushqim. Tavolinat dhe karriget nuk janë fare në gjendje të mirë. Kemi gjithashtu nevojë për kënd lojërash që të luajnë fëmijët.

Stafi është i vogël për numrin e fëmijëve, plus dhe 2 fëmijë me autizëm, nuk ia dalim dot. Drejtoresha ka dhe grupin me 37 fëmijë. Kemi vetëm një sanitare, e cila nuk mund të na ndihmojë. Na mungon një psikologe apo një mësuese mbështetëse që të na ndihmojë. Vështirësia është e madhe tek kjo pjesë. Ka qenë një psikologe, por më shumë punonte në shkollë.

Orjada Tare/ LëvizAlbania

Unë do i sugjeroja shoqatës "Together for Life" që në takimin e radhës të mbledhë të gjitha këto problematika dhe të shkojë në Bashki për t'i paraqitur, në mënyrë që të dëgjohet zëri i të gjitha drejtueseve apo prindërve.



Foto: Pamje nga zhvillimi i forumit të katërt komunitar.



Foto: Pamje nga zhvillimi i forumit të katërt komunitar.



Foto: Pamje në aktivitetin e organizuar në Bashkinë e Tiranës.



Foto: Pamje në aktivitetin e organizuar në Bashkinë e Tiranës.



Foto: Pamje në aktivitetin e organizuar në Bashkinë e Tiranës.




Foto: Pamje në aktivitetin e organizuar në Bashkinë e Tiranës.



Foto: Pamje në aktivitetin e organizuar në Bashkinë e Tiranës.

# *Lëviz për Kopshtin tim, prezantimi i studimit të standarteve të infrastukturës fizike të kopshteve publike në Këshillin Bashkiak Tiranë*

Shoqata "Together for Life" mbështetur nga Lëviz Albania, zhvilloi me 17.10.2017 aktivitetin përmbyllës të projektit "Lëviz për Kopshtin Tim".

Projekti është një inisiativë për monitorimin e infrastrukturës dhe investimeve të 44 kopshteve të Tiranës, me qëllim informimin e qytetarëve dhe medias për të nxitur përgjegjshmërinë dhe transparencën e pushtetit vendor për përmirësimin e cilësisë së shërbimit në kopshtet e Bashkisë Tiranë.

Aktiviteti përmbyllës "Lëviz për Kopshtin Tim" kishte për qëllim prezantimin e raportit mbi rezultatet e nxjerra nga procesi i monitorimit, si dhe lobimin për përfshirjen e rekomandimeve në agjendën e Këshillit Bashkiak.

Në aktivitet morën pjesë prindër, përfaqësues të Bordeve të Prindërve, përfaqësues të Bashkisë Tiranë, Këshillit Bashkiak, mjekë, psikologë, drejtues të kopshteve, përfaqësues nga institucionet që punojnë për arsimin parashkollor, si dhe deputetë të Tiranës.

Në aktivitetin përmbyllës të gjithë aktorët e sistemit të kopshteve morën fjalën dhe diskutuan mbi rezultatet e studimit me qëllim nxitjen e pushtetit vendor për ti zgjidhur këto problematika.

